



"FUNDJAVA" ▶ Faqe 13-19

**Enada Hoxha: Pa baletin s'ka lumturi • Rafting, adrenalinë në lum**



**Takimet në Tiranë**  
BE, Stefan Fyle: Pesë kushtet për Shqipërinë

▶ Faqe 6



**Skifter Këllici**  
Mediat franceze për vrasjen e Esad Pashës

▶ Faqe 20-21

# [SHQIPTARJA.com]

**Na ndiqni edhe online**  
[www.shqiptarja.com](http://www.shqiptarja.com)

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi FUNDJAVA

VITI II - NR. 104 E premte, 04-05-2012

Zbulohet diploma e djalit të ish-drejtnesit të Lega Nord. E mori te universiteti Kristal

# PAZAR ME DIPLOMEN

## Ambasada: Bossi, asnjëherë në Tiranë

Renzo Bossi mbaroi shkollën e mesme në Itali në 2009, të lartën në Shqipëri në 2010. Drejtuesit e Kristal: U rregjistrua në 2007. Ish-rektori, Mareglen Spiro: Nuk kam patur kurrë studentë italianë. Prokuroria italiane dyshon se është blerë në Tiranë

VKM E FSHEHTE ▶ Faqe 8



**Qeveria merr sekretet e SHISH, transferon Shifrën te Ministria e Mbrojtjes**

TROPOJE ▶ Faqe 11

**Vrau burrin dhe dashnorin, gruaja në polici: Ishte grabitje**

PROKURORIA ▶ Faqe 9

**Gjobiti Leonard Bombajn, tre vite burg për "Stresin"**

KUVENDI ▶ Faqe 6

**Berisha dhe Alibeaj nuk votojnë për Gjykatën Administrative**

### Lajmi

Renzo Bossi, djali i ish-liderit të Lega Nord, Umberto Bossi, është diplomuar në Shqipëri. Dokumentet e gjetura nga prokuroritë e Napolit dhe Milanos dhe të publikuara në mediat italiane dëshmojnë se Renzo Bossi në shtator të vitit 2010 ka marrë diplomën për Menaxhim Biznesi, me vulën e Universitetit privat "Kristal" në Tiranë, edhe pse sipas italianëve ai mezi kishte mbaruar shkollën e mesme në 2009.

### TIRANE

#### ESMERALDA KETA

Renzo Bossi, djali i ish-drejtnesit të "Lega Nord", Umberto Bossi, është pajisur me... ▶ vijon në faqen 2-3



Diploma e lëshuar nga universiteti "Kristal" më 2010 për djalin e Umberto Bossit, Renzo Bossi (në të majtë)

### Koment



NGA PREÇ ZOGAJ

## Presidencialet, një garë për tu shpikur

Mbrëmë në Francë kandidatët e turit të dytë, Sarkozy dhe Hollande, u përballën për rreth dy orë e gjysëm në debatin e madh televiziv në prag të votimeve të së dielës. Debate të tilla janë një festë e demokracisë. Kandidatët "zhvishen" para publikut me duart e tyre dhe të njëri-tjetrit. Zgjedhësit e dinë se beteja bëhet për të fituar zemrat dhe mendjet e tyre. Kjo i bën ndihën sovranë dhe të gjykojnë më mirë se kush duhet t'i përfaqësojë. Shqipëria është e privuar nga kjo mrekulli. Shqipëria e zgjedh presidentin pa garë, pa presidenciale. Arsyet aktuale janë dy: kufizimet e sistemit dhe kufizimet e zakoneve. Te ne Presidentin e zgjedh Kuvendi. Shansi numër një i kandidatëve për t'u zgjedhur është të merren vesh me Berishën dhe Ramën, pra të bëjnë "fushatë" për dy njerëz. Kuptohet se kjo nuk mund të jetë fushatë, por një bisedë e vështirë, një bisedë në fije të perit. Me termat që kandidati do të përdorë për ta rregulluar me Ramën, mund ta prishë me Berishën dhe anasjelltas. Ky i fundit ka gjithnjë një kusht-shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, përshembull - që shpartallon që në nisje mëvetësinë dhe dinjitetin e kandidatit për President. Në këto rrethana kandidati nuk rivalizon, rivalitet nuk ekziston në këtë skemë-por thjesht përshatatet e pwrshatatet, sa në një krah në tjetrin, duke renoncuar nga vetvetja. Zgjedhja eventuale me këtë skemë prodhon një President pehlivan, të dobët po se po, që s'do të jetë kurrë dhe s'do ta ndejë për deyrë të jetë në lartësinë e... ▶ vijon në faqe 7

### TAKIMI NE PROKURORI

## UEFA: Drejtuesit e ekipeve të futbollit pastrojnë paratë

Zbardhet takimi me Pierre Cornu: Kontigjentë kriminalë, trukojnë ndeshjet

### TIRANE

#### ELTON QYNO

Zyrtarë të UEFA-s kanë zënë alarmin se futboli shqiptar menaxhohet nga kontigjentë kriminalë që janë të implikuar në grupe kriminale. Ekipet e futbollit... ▶ Faqe 9



**NERANXI**  
... gjithmonë një hap përpara...  
Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.



POLITIKE

Edlira Mamutaj, vajza shqiptare zëdhënese e Bossit



I ati kishte ardhur në Itali në klandestinët: u përzu pastaj erdhi sërish me një leje të rregullt qëndrimi. Edlira Mamutaj, 23 vjeçe, sipas një shkrimi të botuar për të në Itali në 2010, pas mbaroi për gazetari, nuk e pengoi "biografia" e saj, për të bërë zëdhënese e partisë së Bossit, që ishte kundër emigrantëve

klandestinë dhe për ndarjen federale të Italisë. Për Edlirën Nuk ka asgjë për tu çuditur, sepse Bossi nuk është kundër emigrantëve, por kundër klandestinëve, ndërsa i ati do të largohej nga Italia, nëse nuk i jepnin lejen e qëndrimit. Edlira, që flet një italishte perfekte, me theks florentin, thotë se: "Dua të jem

zëdhënese e atyre njerëzve, që vijnë në Itali për tu integruar dhe që flasin gjuhën tonë. Këtë do Lega, në interes të emigrantëve dhe të italianëve. Punoj që të rritet Lega dhe bashkë me të rriten dhe pritshmëritë e të gjithë personave si unë"-thoshte gati dy vite më parë, Edlira Mamutaj, e investuar nga agjencia ANSA.

Më 2011 diplomohet në Tiranë edhe partneri i senatores legiste

Djali i Umberto Bossit diplomë e blerë te "Kristal"?

Të mesmen e mbaroi më 2009, të lartën më 2010



PRECEDENTI

Diploma false nga Shqipëria në Maqedoni

Në fillim të vitit 2012, media maqedonase shkroi se universitetet shqiptare deri dhe zyrtarë të korruptuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ishin përfshirë në një "biznes" fitimprurës diplomash. Diploma të rreme me titujt, "i diplomuar", "magjistër", ose "doktorshkenesh" vijnë nga Bullgaria dhe Shqipëria, shkruante në numrin e 30 dhjetorit gazeta maqedonase "Veçer" e Shkupit në shkrimin me titull "Nëpërmjet Bullgarisë dhe Shqipërisë vijnë "M.Sc." dhe "Dr." Sipas Gazeta "Veçer" rritja e krimit të falsifikimit të diplomave universitare dhe pas-universitare është favorizuar dhe për shkak se këto dy vende (Shqipëria dhe Bullgaria) kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe (me Maqedoninë) për njohjen reciproke të diplomave. Ky fakt ka tërhequr dhe vëmendjen e autoriteteve të larta bullgare, pas njoftimit të agjencisë së lajmeve "Focus" të Sofjes, që i referohet gazetës "Veçer". Me pak para në xhep, me pak përpjekje, por me shumë vullnet për statusin e akademikut filloi afëra e diplomave të falsifikuara, që u bë publike në vitin 2002, kur u zbuluan diploma të rreme nga Fakulteti Ekonomik, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi".


TIRANE

ESMERALDA KETA

vijon nga faqja 1

...një diplomë nga një universitet në Tiranë, gati dy vite më parë. Diploma, për të cilën ka hije dyshime se mund të jetë blerë me para, është gjetur nga "Guardia di Finanza" në një kasafortë të ish-kancelarit të Lega Nord, Francesco Belsito, në të cilën gjendej edhe një dosje me emrin "The Family". Diploma mban datën 8 tetor 2010 dhe në të është shënuar se Bossi Jr ka ndjekur sistemin 3-vjeçar (bachelor) për Menaxhim Biznesi, pranë fakultetit të Administrimit Biznesit të universitet "Kristal"

Përveç diplomës së marrë nga "Trofta", siç e quan media italiane të birin e Bossi-t për shkak të rezultateve të dobëta në arsimin italian, në dokumentet e Belsito-s ndodhet edhe një kopje e diplomës së marrë nga Pierangelo Moscajiuro (njohet ndryshe si Pier Mosca, partneri i senatores legiste Rosy Mauro) në Shkencë Politike me drejtim Sociologji, po te universiteti "Kristal". Edhe ai, sipas dokumenteve, ka marrë diplomën në Tiranë më 29 qershor 2011. Prokurorët italianë dyshojnë se të dy titujt janë marrë kundrejt pagesave të lëvruara nga "Lega Nord". Madje ata dyshojnë se diploma e Renzo Bossit mund të jetë marrë brenda një viti. Bossi rezultoi të jetë i regjistruar me numrin e matriculimit 482 dhe diploma është e shoqëruar edhe me një listë të 29 lëndëve të ndryshme që përmban ciklin e parë të studimeve që ai supozohet të ketë ndjekur. Nga lista e notave kuptohet se Bossi i ri, ndryshe nga sa raportojnë mediat italiane, ka qenë një student mjaft i mirë, madje ai ka arritur të marrë kreditet maksimale në lëndë të tilla të vështira si kontabiliteti, matematikë e statistikë në përfundim të të cilave ai është vlerësuar me notën 10-të që për hir të së vërtetës janë të shumta në listën e tij të notave. Ndërsa nota më e ulët që ai ka marrë është 8-ta, ndryshe nga ata të marta në vendin e tij të lindjes. Kursi, siç rezultoi edhe nga faqja e internetit



Faksimile e notave (lart djathtas) Diploma e Renzo Bossit e marrë në Universitetin "Kristal"

të universitetit, ka një kohëzgjatje tre-vjeçare. Por, duket se djali i senatorit, të paktën siç rezultoi nga analizat që kanë bërë ekspertët, mund ta ketë marrë diplomën e shkollës së lartë vetëm për një vit. Mediat italiane raportojnë se logjika që i ka cuar ekspertët në këtë përfundim është

fakti se "Trofta" e ka marrë diplomën e shkollës së mesme në korrik të vitit 2009, pasi ka dhënë për të tretën herë provimin e shtetit. Ndërsa diploma e universitetit të lëshuar në Shqipëri mban datën 29 shtator 2010 si datë e mbrojtjes së diplomës dhe datën 8 tetor 2010, si datën, kur është



ITALIANET

Bossi në Shqipëri? Asnjëherë

Kur ka qenë Renzo Bossi në Shqipëri? Asnjëherë. Të paktën jo vitet e fundit, siç pretendohet, se ai ka ndjekur studimet në një universitet në Tiranë. Në ambasadën italiane në Tiranë asnjë nuk e kujton, të paktën një ditë të pranisë së Renzo Bossit në Shqipëri në vitet 2009 ose 2010. Aq më tepër kur në mars 2010 ai u zgjodh si anëtar i krahinës së Lombardisë, duke u bërë një politikan zyrtar dhe sipas protokollit, në rast ai kishte ardhur në Shqipëri, ambasada italiane në Tiranë duhej ta dinte patjetër. Por sipas burimeve të shqiptarja.com nga diplomatët që ishin në Shqipëri në atë kohë, asnjë nuk e kujton ndonjë vizitë të Renzo Bossi. I vetmi përfaqësues i "Lega Nord" që ka vizituar Shqipërinë ka qenë Roberto Maroni, ish-ministri i Brendshëm, në 18 nëntor 2008.

lëshuar kjo certifikatë e përfundimit të studimeve të larta pranë fakultetit të Ekonomisë të "Kristal". Diploma e Renzo Bossi-t mban firmat e dekaniit Skënder Kërçuku dhe atë të rektorit Maringlen Spiro. Ndërsa diploma e Pierangelo Moscajiuro, e lëshuar një vit më vonë, pra në 2011-ën, është firmosur nga dekani Vaso Kureta dhe rektori Hektor Çoçoli.

Dyshimet se me paratë e partisë "Lega Nord" financoheshin bizneset privatë të shefit të saj janë shumë të hershme. Kështu pak kohë më parë, shefa e administratës së Lega Nord, Nadia Dagrada, deklaroi në prokurori se në listën e shpenzimeve të partisë rezultonte edhe shkollimi i djalit të Umberto Bossit, i cili sipas saj, po studioje në një universitet në Londër. Nadia Dagrada shpjegoi se shkollimi i Renzo do të kushtonte rreth 130 mijë euro, por jo të gjitha shpenzimet do të mbulohejshin nga fondet e partisë. Shkollimi i trashëgimtarit të Bossit, u bë në objektin investigimor edhe të emisionit televiziv "Striscia la Notizia", i cili u përpoq të zbulonte diçka më shumë nga i biri i Bossit në lidhje me shkollimin e tij, po ky i fundit nuk pranoi të jepte detaje. Por duket se tashmë një pjesë e enigmës është zgjidhur, pasi Bossi i ri nuk po studioje në Londër, por në Tiranë. Partia Lega Nord karakterizohet për frymën e saj shumë të ashpër ndaj të huajve, sidomos emigrantëve ekstracomunitarë në Itali. Një nga ëndrrat e saj të hershme mbetet pavarësia e një rajoni që ajo quan Padania.

RAMA NGA FIRENCE

Diploma e "Troftës" në universitetin ku paguhet

Diploma e Renzo Bossi-t në Menaxhim-Biznes nuk është marrë në universitet ku shkohet për të studiuar, por në një ku paguhet për të pasur një diplomë. Kështu u shpreh djehëri i Partisë Socialiste, Edi Rama, gjatë një takimi me studentët shqiptarë në Firence. Në Shqipëri, shpjegoi Rama, pas reformës së vitit 2005 që liberalizoi sistemin, mbinë "shumë universitete private: disa të mira ndërsa disa janë fabrika diplomash me pagesë". "Problemi i atyre që paguan për të u diplomuar, me çështjen e Renzo Bossi-t, mbërriti edhe në Itali", tha kryesocialisti Rama duke shkaktuar të qeshura mes platesë së studentëve shqiptarë që studiojnë në Firence.



## Korrupsioni, Umberto Bossi dha dorëheqjen në prill



Figura populiste e Ligës së Veriut, Umberto Bossi dha dorëheqjen nga kreu i partisë separatiste italiane, në 5 prill, pas një skandali financiar korrupsioni. Sipas burimeve të kësaj partie, një ish-financier i partisë dyshohet për keqpërdorim të fondëve. Francesco Belsito dha

dorëheqjen, pasi prokurorët e akzuan se kishte përdorur fondet e partisë për të paguar, mes të tjerash, edhe për rimodelimin e vilës së Bossit dhe për pushimet e fëmijëve të tij. Skandali duket i sikletshëm për të, për shkak të qëndrimeve të ashpra që Bossi ka mbajtur në vite në lidhje me

korruptionin, të cilin e konsideronte një epidemi të jetës publike në Itali. Bossi, siç komentojnë mediat, është një nga figurat më komplekse në skenën politike italiane, i cili u bë mjaft i njohur për shkak të platformës së tij separatiste që parashihet ndarjen e Veriut të Italisë.



Në foto: Renzo Bossi (majtas) Universiteti "Kristal" në Tiranë

## Olsi Baze: Është verifikim paraprak, çështja do të ndiqet

# Universiteti: Bossi student më 2007

### Reagimi: Është regjistruar me dokumente të rregullta

■ ■ ■ TIRANE  
ESMERALDA KETA

Thellohet skandali për diplomimin e djalit të senatorit, Umberto Bossi pranë universitetit "Kristal".

Kjo pasi, sipas reagimit zyrtar të këtij universiteti, Renzo Bossi është regjistruar me dokumente të rregullta pranë këtij universiteti në vitin akademik 2007-2008, ndërkohë që mediat italiane raportojnë se Bossi i ri e ka mbaruar shkollën e mesme në vitin 2009-ën. "Në



Olsi Baze

lidhje me informacionet që janë transmetuar në mediat shqiptare mbi diplomimin e shtetasve italianë Pierangelo Moscajuro dhe Renzo Bossi, universiteti "Kristal" dëshiron të sqarojë opinionin publik si më poshtë vijon: "shtetasi italian Pierangelo Moscajuro është regjistruar në bazë të dokumentacionit të paraqitur në administratën e universitetit në vitin akademik 2008-2009, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shtetasi italian Renzo Bossi është regjistruar në bazë të dokumentacionit të paraqitur në administratën e universitetit në vitin akademik 2007-2008, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në universitetin "Kristal" aktualisht janë të regjistruar përveç shtetasve italianë edhe shtetas të huaj të tjerë. Universiteti jonë është i hapur për çdo informacion në lidhje me këtë çështje", - është ky qëndrimi zyrtar i Universitetit "Kristal". Ndërkohë, Olsi Baze, drejtor i marrëdhënieve me jashtë në këtë universitet, i kontaktuar nga "Shqiptarja.com" se si ka mundësi që Bossi është regjistruar në universitet në vitin akademik 2007-2008, kur mediat italiane raportojnë se ai e ka marrë diplomën e shkollës së mesme në 2009-ën, përgjigjet se ky është për momentin qëndrimi zyrtar. "Ky është për momentin qëndrimi zyrtar i universitetit "Kristal". Megjithatë dua t'ju them se verifikimi do të vazhdojë. Ky është vetëm një qëndrim paraprak, pasi mund të ketë zhvillime të tjera", - na thotë Baze. Ndërsa sa i përket faktit nëse djali i Bossit, i ka ndjekur personalisht leksionet e seminarit, pra ka qenë i pranishëm, Baze thotë se këto janë të dhëna që po verifikohen. "Të gjitha këto gjëra po verifikohen, aktualisht ne po kërkojmë në regjistrat përkatës për të parë se si është e vërteta, ndaj s'mund të themi asgjë më tepër se sa njoftimi zyrtar që iu dërguam. Por shpresoj që gjatë ditës së shtunë ose maksimumi të dielën të kemi një qëndrim përfundimtar, pasi kjo është një procedurë që do kohë", - na shpjegon Baze.

## Intervista

# "S'kemi patur studentë italianë, do ta mbaja mend"

Ish-rektori, Maringlen Spiro që firmosi diplomën e studentit Renzo Bossi më 2010

■ ■ ■ TIRANE

Ish-rektori i universitetit "Kristal", Maringlen Spiro, firmën e të cilit mban edhe diploma e lëshuar në 2010-ën për djalin e Umberto Bossit, mohon që Renzo Bossi të ketë qenë student i tij. Në një intervistë për "Shqiptarja.com" ai shprehet se në menaxhim biznesi, nuk kanë pasur studentë italianë dhe ai është i bindur se po të kish të pasur do ta mbante mirë mend, për shkak të procedurave të shumta që kanë studentët e huaj.

### Është e vërtetë apo jo?

Sigurisht që po, pasi duhet të jetë gjithë dokumentacioni në universitet: që ka dhënë provimet, që është paraqitur para komisionit, etj. Çdo student ka numrat e veta, numrat e serisë.

### Po diploma ishte e shoqëruar edhe me listën e notave, me numrin e amzës...?

Nuk di se çfarë t'ju them në këtë moment. Por unë mund t'ju them

vetëm që nuk mbaj mend të ketë pasur italianë në menaxhim biznesi. Në stomatologji dhe në farmaci ka qenë një grup në vitin e parë, sepse unë kam dhënë mësim, ndaj do e mbaja mend. Pra ka pasur para një tre-katër vjetësh, tani unë po flas me atë që mbaj mend. Megjithatë çdo diplomë shoqërohet me dokumentacionin shkollor përkatës dhe dallohen nga ata që mund të shkruhen diku tjetër (falsifikohen).



Maringlen Spiro

## Zv.ministria e Arsimit

# Nora Malaj: Shkeljet çohen në gjykatë

■ ■ ■ TIRANE

Nora Malaj zëvendësministre e Arsimit, na shpjegon se ministria e Arsimit ka strukturat e saj që monitoron cilësinë e universiteteve dhe në rastet kur verifikohen shkelje, në varësi të saj ose dërgohen në gjykatë ose merren masa administrative.

### Zonja zëvendësministre si kontrollohen universitetet për diplomat që lëshojnë?

Ministria e Arsimit, në bazë të procedurave që përcaktohen në ligjin e arsimit të lartë jep licencën për ushtrimin e aktivitetit, por përgjegjësitë i merr subjekti që merr përsipër të ushtrojë aktivitetin. Institucioni politikbërës dhe institucionet që menax-



Nora Malaj

hojnë aktivitetin shikojnë sa hyjnë, sa dalin dhe ku është aktiviteti që realizohet në bazë të standardeve ligjore. Pra në bazë të këtyre unë them që ky aktivitet ekziston sepse është regjistruar në QKR, ka niptin, ka licencën, por nëse brenda ata mund të bëjnë çfarëdolloj gjëje atëherë kjo është përgjegjësi e tyre.

### Mediat italiane flasin për një diplomë që mund të jetë blerë?

Natyrisht nëse ka një numër matricullimi për çdo individ që është i vendosur në çdo sekretariat, mund të gjendet gjithçka. Pra çdo institucion ka amzën e tij dhe përgjigjet për këtë gjë.

### Nëse ju (MASH) merrni vesh një shkelje, nga burime të ndryshme a ndërhyjni?

Jo, ne jemi institucion politikbërës. Kur verifikohet shkelja çohet në gjyq,

bëhet proces gjyqësor dhe gjyqi është ai që jep vendimin. Në rastin konkret bëhet padi penale. Institucioni që bën politikën nuk mund të dënojë një njeri që nuk është në varësi të tij. Në rast se Ministrisë së Arsimit i vjen një subjekt dhe i thotë se ky aktivitet nuk është i drejtë sepse janë shkelur 1,2,3,4 atëherë ministria e Arsimit i thotë subjektit ta çojë në gjykatë dhe nga ana tjetër i kërkon llogari subjektit si është zbatuar ligji. Në momentin kur nuk zbatohet atëherë mbështetet te ligji i arsimit të lartë dhe i thotë për këto e këto arsye ju do procedoheni në këtë format. Prandaj ne kemi këmbëngulur me të madhe për numrin e matricullimit. Kemi thënë që çdo student të ketë ueb-siten e tij, të shikohet kur ka filluar dhe kur ka mbaruar studimet, në mënyrë që shqiptarët që rrinë gjithë ditën në kafene të kenë mundësi të gjejnë jo vetëm djalin e Bossit, por edhe djemtë e bosave të tjerë.

Mediat italiane kanë publikuar një diplomë të djalit të Umberto Bossit të lëshuar nga "Kristal" më 2010-ën, a ka qenë student djali i senatorit tek ju?

Unë nuk jam në dijeni për këtë gjë, por unë nuk mbaj mend të ketë pasur ndonjë kandidat italian, të paktën nga reaksioni i parë që më vjen tani që po më pyesni, në menaxhim biznesi. Ka qenë një grup italianësh para një dy tre vjetësh, pra në kursin e parë që i kemi futur në kursin e gjuhës, kanë qenë nja 4-5 veta në respektim të rregullave që ka formuluar Ministria e Arsimit dhe nuk mbaj mend të ketë pasur të tjerë në fusha të tjera.

Sipas lajmit që ka publikuar media italiane ai është diplomuar në 2010-ën, ju nuk e mban mend fare?

Nuk mbaj mend të ketë pasur, sepse studentët e huaj kanë një mënyrë të veçantë të regjistrimit, pasi kanë një sërë procedurash siç janë dokumentacioni, ekuivalencimi, përkthimi, etj, etj. Unë nuk e mbaj mend.

A mund të verifikohet nëse



## Edi Rama në Firenze takim me degën e PS dhe kryebashkiakun

Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama filloi dje pasdite një vizitë në Itali ku do të zhvillojë takime me përfaqësues të emigrantëve shqiptarë atje. I shoqëruar nga sekretari socialist për Rininë dhe Emigracionin, Erjon Veliaj dhe disa deputetë socialistë, kryetari i PS Rama ka marrë pjesë pasdite në një takim me degën e PS në Firenze. Në këtë takim është diskutuar për programin socialist për një

Rilindje Shqiptare dhe tërë përpjekjet e të majtës dhe opozitës së bashkuar për të ardhur në pushtet, përmes një platforme të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë shqiptarët, që sipas Ramës do të ndryshojë mënyrën e qeverisjes në Shqipëri, duke i dhënë fund njëherë e mirë tranzicionit të tejzgjatur në vend. "Për Firenzen me një grup deputetësh e Sekretarin për Rininë, të ftuar nga studentet shqiptarë si dhe

kryebashkiaku i qytetit të artit italian. Cilido prej jush që gjendet në Firenzen apo pranë saj, i ftuar të vijë në 17.30 për bashkëbisedimin në 'Aula Magna' e Universitetit florentin. Programi për një Rilindje Shqiptare dhe hapja e mëtejshme e PS në qendër të takimeve. Dega jonë në Firenzen meriton falenderime paraprake", shkruan kreu socialist Edi Rama në adresën e tij të rrjetit social Twitter.

## Ish-kryetari i PD: Partia e Topit pa kauzë, lindi e "vdekur"

ILIR META:

"Politika të lërë konfliktet"



Ka zhvilluar dje punimet konventa zgjedhore e Lëvizjes Rinore për Integrim, ku priten të shpallen kryetari i ri dhe strukturat e reja drejtuese. Në fjalën e tij, kreu i LSI-së Ilir Meta u shpreh se ky vit është viti i shanseve të mëdha. "Politika të marrë përgjegjësinë e duhur e të mos pengojë procesin e integritimit. Nuk kemi kohë për të humbur. Viti 2012 është viti vendimtar për integrimin në BE, që përkon dhe me 100 vjetorin e Pavarësisë. Për shkak të një politike konfliktuale e të padrejtë gjeneratat e reja kanë vuajtur jo pak. Ndaj duhet të ecim me ritmin e 20 vjeçarëve të sotëm", u shpreh Meta. Ndërkohë që dje ka qënë kryetarja e LRI-së, Erisa Xhixho, e cila tha se s'kanë pasur asgjë përveç Kryemadhit dhe Metës. "Ne kemi pasur shumë ëndrra dhe dëshira për organizatën tonë, pasi në fillimet tona nuk kishim asgjë përpos emrit të Monika Kryemadhit dhe Ilir Metës. Pas kaq vitesh kemi një emër shumë të madh", ka thënë Xhixho.

### Lajmi

Deputeti demokrat Tritan Shehu e sheh me nota pesimiste lindjen e partisë së re, FRD e drejtuar nga Oketa, pasi sipas tij e ka të vështirë të zërë vend në politikën shqiptare, për shkak se nuk ka figura të forta në radhët e saj dhe s'ka bosh. Duke thënë se dhe se e filloi keq, pasi përjashtoi dy figura ende pa u bërë parti.

### TIRANE

JAKIN MARENA

Demokratët partinë e re të shfaqur në skenën politike shqiptare Fryma e Re Demokratike që ka për kryetar të grupit nismëtar deputetin Gazmend Oketa, e konsiderojnë si të padëmshme për elektoratin e djathtë. E cilësuar rëndom si parti e Topit, për ish-kryetarin e Partisë Demokratike, deputetin Tritan Shehu kjo parti nuk ka kauzë politike, madje nuk është e hapur dhe demokratike ashtu sikurse u deklarua nga Gazmend Oketa në momentin e themelimit të saj më 30 prill. "Fryma e Re Demokratike e krijuar vetëm disa ditë më parë nuk merr asnjë kokërr vote nga PD. Këtë e them nga fakti i thjeshtë se është një parti anemike, dhe siç e ka emrin "Frymë" është diçka e pakapshme, një forcë politike jashtë realitetit, pa kauzë, pa bosh, pa ideologji dhe mbi të gjitha pa elektorat të cilit do të duhet t'i drejtohet. Sepse ata janë vetëm një frymë", ka qënë deklarata e ish-zv.kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm, Tritan Shehu, dhënë dje për gazetën "Shqiptarja.com". Nga ana tjetër deputeti demokrat nuk ka munguar të analizojë dhe sjelljen antidemokratike ndaj atyre që kanë kontribuar në këtë parti të re të themeluar disa ditë më parë, duke thënë se ajo e ka filluar jo mirë dhe korrekte jetën e saj politike. Pasi ka përjashtuar ende pa u deklaruar zyrtarisht si parti politike ata të cilët kanë bërë programin e kësaj partie dhe pjesën më të madhe të statutit të saj. "Nuk e di si mund të jetë një parti e hapur apo si mund të jetë ndryshe nga të tjera, më demokratike dhe me një statut më bashkëkohor se gjithë subjektet politike shqiptare, mad-

# Shehu: Meksi-Çela u përjashtuan nga FRD

"Largoj ata që bënë programin, s'merr asnjë votë"



Tritan Shehu

je duke e krahasuar dhe me vendet me demokraci të zhvilluar në Evropën e bashkuar ku ne aspirojmë të integrohemi, një parti që ende pa u shpallur bën dy përjashtime të rëndësishme nga radhët e saj. Dy bashkëautorët e programit të partisë Fryma e Re Demokratike, përkatësisht ish-kryeministri Aleksandër Meksi dhe ish-deputeti Blerim Çela janë përjashtuar ende pa u krijuar parti, pikërisht duke mos u ftuar as në ditën themeluese. Që është një nga ditët më të shënuara për një parti politike. Dhe akuzojnë Berishën se është

të autoritar në PD dhe largon njerëzit, ndërsa ata pa lindur akoma parti, pra pa u bërë ende parti, filluan përjashtimet e figurave kryesore të saj", ka deklaruar Shehu. Për të cilin, ajo që u pa në panelin e kësaj partie të re, ajo që u pa në sallë, ku nuk kishte asnjë figurë politike që kontribuon në politikën shqiptare, dhe për më tepër mosfesa për Maksin dhe Çelën, tregon se roli i saj do të jetë shumë minor dhe pa asnjë ndikim në politikën shqiptare. Njëherësh duke iu rikthyer arsytimit të tij se kjo parti nuk ka figura dhe për pasojë nuk

mund të rivalizojë në asnjë ballafaqim elektorat partitë e djathta shqiptare, Shehu ka këmbëngulur se "kjo parti është një parti që ka lindur e vdekur, pasi është pa figura politike në përbërjen e saj, nuk ka karizmën e duhur asnjëri që të udhëheqë këtë parti drejt thithjes së elektoratit dhe mbështetësve për të zënë vendin e duhur në radhët e politikës shqiptare. FRD nuk i përket realitetit, është një mjegullnajë dhe amorfë", deklaroi ish-kryetari i PD, Shehu për gazetën. Deklaratat e deputetit të PD kanë ardhur vetëm disa

### Reagimet

Deri më tani ish-kryeministri Aleksandër Meksi ka heshtur për mediat në lidhje me faktin që ai nuk u ftua nga grupi organizator në ditën e themelimit të FRD. Por nuk e ka bërë një gjë të tillë ish-deputeti Blerim Çela, i cili bashkë me Maksin janë hartuesit e programit të kësaj partie.

ditë pas krijimit të FRD të drejtuar nga Oketa dhe në përbërje të së cilës është dhe ish-zv.presidenti i Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës Aleksandër Biberaj, dy figurat kryesore të njohura në vend. Ndërkohë që është vënë re mungesa e Meksit dhe Çelës në themelimin e partisë, por krahas tyre dhe e ish-kreut të PD, Eduart Selami si dhe të politologos Mirela Bogdani. Ndërkohë që ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj e ka mbështetur FRD, por pa qënë pjesë e saj. Dy ditë më parë, në një intervistë televizive kreu i FRD, Gazmend Oketa është shprehur se për Maksin, Selamin dhe figura të tjera politike dera është e hapur në këtë parti, pa përjashtuar dhe deputetët aktualë të PD.

### Takimi

## Nano merr mbështetjen e Dules për President

TIRANE

Kandidati për president Fatos Nano ka marrë mbështetjen e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Menjëherë pas takimit me kreun e PBDNJ, Vangjel Dule, ish-kreu socialist Nano mori garancinë e votës, teksa paralajmëroi takimet e ardhshme me kreutë e tjerë politikë. Ish-kryeministri u takua dje rreth mesditës me kreun e PBDNJ, Dule duke shpallur platformën e tij për president. Nano tha se procesi i takimeve për ambicien e tij për president po gjeron konsensus, në mbështetje të iniciativës kombëtare, që është integrimi në BE. "Vlerësoj, siç dëgjua zotin Dule, procesi po gjeron konsensus, në



Fatos Nano

mbështetje të iniciativave kombëtare që na bashkojnë me Europën e detyrat që duhet të kryejmë. Besoj që të gjithë stimujt që vijmë në këto takime, në një ditë që dëgjova dhe konvergencën e mesazheve të komisionerit Fyle për një proces konsensual, janë ato që i duhen vendit në një klimë kaq të ngarkuar me sfida dhe shfaqje aftësish për të kapërcyer. Emra të tjerë për të firmosur ka, s'është vetëm Dule, por ky është problemi im i fundit. S'më shkon në mendje të sjell një fraksionim apo konflikt më shumë në situatën politike aktuale", u përgjig Nano interesit të gazetareve, të cilët i uroi për ditën ndërkombëtare të medias. Ish-kreu socialist Nano nënvizoi se takimet e tij

me deputetët janë publike me qëllim shmangien e konflikteve politike, ndërkohë që theksoi se po pret takimin e radhës me kryeministrin Berisha dhe kreun e PR-së Fatmir Mediu. Duke paralajmëruar njëherësh dhe një takim me ambasadorin e BE në Tiranë, Sequi, Kreu i PBDNJ, Dule ashtu siç pritej rikonfirmoi votën e tij pro Nanos, madje strukturat e PBDNJ tha ai do ta zyrtarizojë mbështetjen e kësaj force politike për ish kreun socialist. "Do ketë shumë që do të jenë nismëtarë. Ne do jemi në pozitën modeste të nënshkruesve dhe të votuesve të kësaj kandidature. Do të bëjmë atë që kemi bërë dhe në vitin 2007 dhe nuk lëvizim nga qendrimi ynë", u shpreh Dule për mediat.



**"Gratë, Totozani takon Cherie Blair, vizita për reformën në gjyqësor"**

Cherie Blair, bashkëshortja e ish-kryeministrit britanik Tony Blair, mbërriti dje në mesditë në kryeqytetin shqiptar. Blair, e njohur si një aktiviste për të drejtat e grave, axhendën e saj të takimeve e ka nisur me Avokatin e Popullit Iglj Totozani. Këshilltarja Juridike e Mbretëreshës së Anglisë ndodhet në Tiranë për të marrë pjesë në konferencën

me temë "Reforma në gjyqësor si kusht për integrimin e Shqipërisë në BE", si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në familjen e madhe europiane. Njëherësh ajo pritet të takohet dhe me krerët më të lartë të politikës shqiptare, më të cilët do të diskutojë në lidhje me ecurinë e Shqipërisë drejt integritetit në BE dhe rolin një drejtësie të reformuar në

këtë proces të rëndësishëm. Konferenca për reformën në gjyqësor organizohet nga Unioni i Gjyqtarëve, Qendra Europiane me mbështetjen e Fondacionit SOROS dhe USAID-it për forcimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Në këtë takim, pritet të marrin pjesë dhe përfaqësitë diplomatike në Shqipëri, përfshirë atë të OSBE dhe BE.

**Komisioneri i BE, presion për Presidentin dhe '21 janarin'**

LAJME SHKURT

Lajmi

Komisioneri për Zgjerimin në KE, Fyle gjatë takimeve të zhvilluara me krerët më të lartë të politikës dhe të shtetit shqiptar ka kërkuar realizimin e kushteve për integrimin në BE, përfshirë këtu dhe zgjedhjen e një presidenti konsensual dhe hetimin e paanshëm e të pandikuar nga politika të 21 janarit.

TIRANE

JAKIN MARENA

# Fyle: 5 kushtet për politikën shqiptare

"2012-ta, vit i mundësisë së madhe për Shqipërinë"



Komisioneri për Zgjerimin në KE, Stefan Fyle dje në Kuvend

21 janari

"Me rëndësi jetike është të hidhet dritë mbi ngjarjes e 21 janarit, lirisht nga ndërhyrjet politike. Lufta kundër korrupsionit sfidë kyçe. Element me rëndësi është heqja e imuniteteve për deputetët, zyrtarët e nivelit të lartë dhe gjyqtarët në përputhje me standartet dhe praktikat më të mira".

Fyle: BE rëndësi lirisë së medias

Komisioneri për Zgjerim në BE, Stefan Fyle gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me kryeministrin Berisha deklaroi se BE i kushton rëndësi të madhe lirisë së medias duke nënvizuar se ajo është sfidë për të gjitha vendet e lira dhe demokratike. "Sot është dita botërore e shtypit, ndaj më lejoni të theksoj rëndësinë që BE i kushton lirisë së medias. Dëshirojmë të shikojmë që të vijojë puna e ligjit të medias dhe me anë të një organizimi të një konference që s'është sfidë vetëm për Shqipërinë", tha Fyle në ditën botërore të shtypit. Duke thënë se media e lirë shpreh në të vërtetë lirinë e një shoqërie të emancipuar.

Fyle në Tiranë, invalidët protestë

Këshilli Kombëtar i Personave me Afërsi të Kufizuar me rastin e vizitës së Stefan Fyle në Tiranë organizoi një protestë me karakter sensibilizues para Ministrisë së Integritetit. "Me anë të kësaj proteste dëshirojmë të sjellim në vëmendje të politikës disa fakte edhe argumente që ndikojnë pozitivisht në procesin e integritetit të vendit tonë në BE", u deklarua sipas komunikatës për shtyp të Këshillit të Personave me Afërsi të Kufizuar. Gjithashtu, ky këshill ka dhe mbështetjen e Forumit Evropian të Personave me Afërsi të Kufizuar, të cilët bëjnë me dije se protesta e ditës së djeshme do të transmetohet në disa gazeta në Bruksel.

Komisioneri për Zgjerimin në Komisionin Evropian Stefan Fyle ka qënë shumë konkret në mesazhet që ka përcjellë gjatë vizitës së tij në Shqipëri dhe në takimet me liderët kryesorë të politikës shqiptare. Kanë qënë 5 pika në formë porosie që zyrtari i lartë që ka "kyçin" e integritetit të Shqipërisë në BE, ka lënë dje gjatë takimeve me kreun e opozitës Rama, kryeministrin Berisha, presidentin Topi, ministrin e Jashtëm Haxhinasto e kryetaren e kuvendit Topalli. Fyle e konsideron vitin 2012, si vit të mundësisë së madhe për Shqipërinë që feston dhe 100 vjetorin e Pavarësisë. Ndërsa për herë të parë flitet dhe për datën e fillimit të procedurave për zgjedhjen e presidentit të ri që është është 24 maji. Por dhe është kërkuar sërish një hetim i paanshëm dhe profesional për 21 janarin. "Axbenda europiane të kthehet në një axhendë kombëtare, të ndërmerret një masë e konsiderueshme për çështjet kyçe nëpërmjet rezultateve të targetuara e të orientuara në implementimin e Planit të Veprimit, reforma zgjedhore, votimi i ligjeve me 3/5 dhe funksionimi i parlamentarizmit, procedura e zgjedhjes së presidentit të fillojë pas 24 majit si dhe të punohet për më shumë rezultat në sektorë si: shteti ligjor, të drejtat e njeriut", janë 5 pikat që sipas raportit të të dërguarës së Shqiptarja.com në Bruksel Anila Basha, komisioneri Fyle kishte përgatitur për politikën shqiptare. "Procesi i zgjerimit është sa teknik aq edhe politik. Jo vetëm Komisioni, por dhe të tjerë do ndjekin nga

afër atë që qeveria e opozita do kthejnë axhendën europiane në një axhendë kombëtare. Do të jenë shtetet anëtare që kur të marrin rekomandimet për mënyrën e zbatimit të prioritetëve, do shohin një panoramë më të gjerë ku zgjedhja e presidentit do jetë një element i rëndësishëm", tha Fyle. Pasi ka takuar kryeso-

cialistin Rama dhe kryeministrin Berisha, Fyle ka dalë në një konferencë të përbashkët për shtyp me kreun e qeverisë dhe më vonë ka mbajtur fjalën e tij në Kuvend. "Kjo ka të bëjë me angazhimin e qeverisë por dhe angazhimin e kryesocialistit Rama për të përfunduar reformën zgjedhore dhe atë parlamentare

para se të fillojnë procedurat për presidentin e ri. Kjo na bën që të sigurohemi që gara presidenciale të jetë pjesë e zgjidhjeve dhe jo e problemeve, në rast se këto reforma nuk përfundojnë. Angazhimi i kryeministrit dhe qeverisë është që zgjedhja e presidentit të jetë i negociueshëm. Nuk kam ardhur të jap këshilla

apo leksione se si duhet bërë kjo gjë, por për të parë përpara. Ajo që është e rëndësishme është që në zyrën e presidentit të vijë dikush që paraqet frymën e Kushtetutit dhe të përfaqësojë unitetin e popullit shqiptar", tha Fyle. Sipas tij, fakti që KE nuk e ka rekomanduar statusin për Shqipërinë, s'do të thotë se s'vlerëson rolin në rajon, sepse ajo luan një rol stabilizues. "Duhet thënë që viti 2011 s'ishte vit i mirë për rezultatet për 12 prioritetet kyçe. Por, tani unë shoh erën e ndryshimit e shpresoj që kjo mundësi të kthehet në realitet më vonë gjatë këtij viti", deklaroi ai.

**Berisha: "Me Ramën takim pas 24 majit"**

Nga të gjithë kryetarët e forcave politike në Shqipëri, jam i vetmi që kam deklaruar se s'do kandidoj për



postin e presidentit. Unë çdo ftesë i përgjigjem pozitivisht. Vlerësoj ftesën e Ramës, por Kushtetuta përcakton një afat kur fillon procesi kushtetues. Si unë dhe Rama për hir të respektit të postit të presidentit duhet ta respektojmë këtë. Jam gjithnjë për negociatat dhe siç kam e gjithë kjo histori e gjatë komunikimesh, takimet janë të vlefshme kur ata parapërgatiten nga stafet që kanë dhunti të japin kontribut në përgatitjen e tyre", deklaroi Berisha.

**Rama: "Po axhendës Evropiane"**

Në takimin me Fyle, kreu i PS Rama, pasi vlerësoi kontributin e rëndësishëm të BE për procesin integrues, e informoi për ecurinë e reformës parlamentare e zgjedhore, duke vënë në dukje rëndësinë e përfundimit të tyre brenda afateve. Ai rikonfirmoi angazhimin e PS për ofrimin e kontributit për avancimin e axhendës evropiane të Shqipërisë. Fule përgëzoi Ramën për rolin konstruktiv që ka luajtur opozita për ecurinë e procesit të reformave, në veçanti shembulli pozitiv i mënyrës së zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Ndërkohë që u fol dhe për zgjedhjen e presidentit me konsensus.



**Njoftim punësimi**

Grupi Mediatik "Free and Fair Media Group"

**kërkon:**

**Menaxher shitjes në fushën e reklamave**

*Kërkesa të nevojshme për aplikuesin:*

- ✓ Të jetë i pajisur me Diplomë Universitare. Përparsi do të kenë kandidatët të cilët janë të lidhur me fushën e marketingut.
- ✓ Të ketë eksperiencë pune në pozicione të ngjashme në fushën e medias.
- ✓ Të ketë afësi shpirtërore dhe menaxheriale të larta
- ✓ Të jetë i komunikueshëm, të dijë të punojë në grup dhe të menaxhojë me efikasitet rrjetin e klientëve të kompanisë.
- ✓ Preferohet të ketë njohuri në gjuhën angleze dhe italiane.
- ✓ Të njohë programet bazë office dhe njohuri mbi internetin.

Të interesuarit janë të lutur të dërgojnë kërkesën dhe C.V në adresën e e-mailit: marketing@shqiptarja.com



## Topalli takim me Vujanoviç, thellimi i Bunës dhe kalimi i gazit

Projekti i gazsjellësit që do të kalojë nëpërmjet Shqipërisë dhe thellimi i Bunës për të shmangur përmblytjet kanë qenë kryefjala e takimit mes Kryetares së Kuvendit, Jozefina Topalli dhe Presidentit të Malit të Zi, Filip Vujanoviç. Kryetarja e Kuvendit shprehu rëndësinë e bashkëpunimit me Malin e Zi për thellimin e Lumit të Bunës si dhe sistemin e

Liqenit të Shkodrës, si dy projekte që do të parandalojnë përmblytjet por edhe do të nxisin zhvillimin e turizmit dhe qarkullimit të njerëzve. Për këto dy projekte, Presidenti Vujanoviç shprehu gatishmërinë e plotë të Malit të Zi për të bashkëpunuar. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Vujanoviç vlerësoi nisjen e bisedimeve të palës shqiptare për projektin e gazsjellësit, i cili synon

transportimin e gazit nga Azerbajxhani përmes Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit. Ky projekt, theksoi Presidenti malazez është një shans i fuqishëm zhvillimi jo vetëm për Shqipërinë por për gjithë rajonin. Gjatë takimit, Presidenti Vujanoviç i përcolli Kryetares Jozefina Topalli përshëndetjet e Kryetarit të Kuvendit të Malit të Zi.

## Kalon në Parlament me 112 vota gjykata Administrative

# Biznesi, s'votojnë Berisha dhe Alibeaj

Kryeministri largohet para votimit, akuzoi opozitën për pengim

### Lajmi

Kryeministri Sali Berisha, deputetët Enkelejð Alibeaj dhe Pandeli Majko, të dy anëtarë në Komisionin e Ligjeve nuk e kanë bashkuar votën e tyre me kolegët e tyre që votuan 'pro' ngritjes së Gjykatës Administrative. Berisha u largua para votimit, Alibeaj nuk mori pjesë, ndërsa Majko abstenoj.

### TIRANE


FERNADA CENKO

Gjykata Administrative ka humbur dy vota tek sa është votuar në seancën e djeshme plenare. Deputeti i Partisë Socialiste Pandeli Majko, anëtar e Komisionit të Ligjeve ka abstenuar, ndërsa deputeti i PD, Enkelejð Alibeaj nuk ka marrë pjesë në votim. Të paktën këto është konfirmuar nga tabela e rezultateve të votave të pasqyruar në ekranin e Kuvendit. "Shqiptarja.com" nuk arriti që të marrë një përgjigje nga deputet demokrat, Enkelejð Alibeaj për mosmarrjen pjesë në votim. Nuk dihet nëse Alibeaj vërtetë nuk donte të votonte, apo nuk e kishte mendjen në kohën e votimit, ndërsa ai vetë nuk e ka sqaruar. Gjithësesi, ligji për Gjykatën Administrative ka marrë 122 vota pro në Kuvendin e Shqipërisë.

**BERISHA NUK VOTON**  
Kryeministri Sali Berisha nuk ka marrë pjesë në votimin për ngritjen e Gjykatës Administrative. Edhe pse ka akuzuar Partinë Socialiste për bllokim të këtij ligji për dy vjet rresht, vetë nuk i ka kushtuar as 2 minuta kohë për të votuar ligjin që kërkonte 84 vota. Kryeministri Berisha pasi artikuloj një batutë me grupin e PS, është larguar nga seanca e Kuvendit. Madje ai nuk ka shoqëruar as Komisionerin për Zgjerim, Stefan Fyle në dalje nga Kuvendi. Po ashtu nuk ka marrë pjesë në votim as ministri Sokol Olldash, as deputeti i pavarur Dritan Prifti dhe deputeti i PBDNJ, Vangjel Dule.

### EDUARD HALIMI

Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi është shprehur se votimi i Gjykatës Administrative shënon një histori të re për vendin dhe sistemin e



Votimi në Kuvend ku Alibeaj nuk ka marrë pjesë në votim, Majko abstenoj dhe Berisha mungon

drejtësisë. "Kuvendi hedh sot një hap domethënës, me të cilin secili prej nesh duhet të ndjehet krenar sepse merr pjesë në hapjen e një kapitulli të ri të reformës në drejtësi. Te ndasive politike, ne na bashkon një vizion i vetëm për pushtetin gjyqësor të orientuar drejt qëllimit strategjik për një drejtësi më cilësore, më efektive, më transparente, më të besueshme, më të pavarur dhe më të përgjegjshme. Sot, ne të gjithë

shprehim të njëjtin vullnet se na duhen gjyqtarë më të mirë, garanci më të forta për të drejtat e qytetarëve, gjykim më i shpejtë, më i drejtë, më i besueshëm dhe më profesional", është shprehur Halimi.

### FATMIR XHAFAJ

Deputeti socialist, Fatmir Xhafaj ka dhënë pesë arsytet pse opozita nuk ka votuar dy vjet më parë Gjykatën Administrative. Edhe pse ishte koha e vorimit për këtë ligj, Xhafaj i'a bëri edhe një herë

publike mazhorancës arsyet e zvarritjes. "Opozita ngriti shqetësimin se projektligji dje nuk parashikonte drejtë sistemin e gjykatave administrative në vend duke mosparashikuar një sistemi hierarkik të drejtësisë administrative. Projektligji sot ka reflektuar tërësisht duke përcaktuar gjykatat administrative të veçanta të shkallës së parë, apelit dhe kolegjin administrativ të gjykatës së lartë. Së dyti, projekti dje nuk

arrinte të zgjidhte pritshmëritë e lartë të biznesit lidhur me shpejtësinë në gjykimin e çështjeve administrative në të tre shkallët duke parashikuar një kohëzgjatje nga 2 deri në 4 vjet në rastin më të mirë. Së treti, projekti dje nuk parashikonte qartë përbërjen e trupave gjyqësore dhe të lënë këtë gjë në diskrecionin absolut të vet gjyqtarëve gjë e cila mundësonte arbitraritetin, standardet e shumëllojshme, krijonte kushte diskriminuese për shtetasit dhe biznesin dhe ishte një mundësi më shumë për korupsion në radhët e gjyqtarëve. Së katërti, projektligji i vitit 2009 nuk arrinte të parashikonte sakte detyrimet e administratës shtetërore gjatë gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative si dhe fuqinë e vendimit të Gjykatës në aspektin e mënyrës së ekzekutimit të vendimeve. Së pesti, projekti dje pothuajse nuk e rregullonte fare gjykimin në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë çka mundësonte konfliktin e kompetencave si dhe zvarritjen e panevojshme të proceseve", është shprehur Xhafaj.

## Dhunimi i Timoshenkos

# Topi bojkoton samitin e Ukrainës

### TIRANE

Presidenti i Republikës, Bamir Topi deklaroi dje se nuk do të marrë pjesë në samitin e krerëve të shtetit që pritet të mbahet javën e ardhshme në Ukrainë. Gjatë konferencës së shtyp me homologun malazez, Vujanoviç, Topi ka bërë me dije se ka refuzuar ftësesën në shenjë solidariteti me vendet e Bashkimit Europian, të cilat shprehën kundërtë trajtimin jo njerëzor të ish-kryeministres ukrainase Julia Timoshenko. "Unë mund t'ju them sot që, dje në mëngjes unë kam parqitur vendimin tim pranë strukturave tona diplomatike dhe pranë strukturave që menaxhojnë këtë Samit për të mos marrë pjesë duke iu bashkëngjitur linjës së vendeve të BE-së për të protes-



tuar nëpërmjet bojkotit për mënyrën e trajtimit të ish-kryeministres Timoshenko, e cila natyrisht sikurse dihet edhe nëpërmjet përcjelljes që ka bërë media, po i nënshtrohet një trajtimi jo njerëzor. Kështu që, në mënyrë të qartë jemi shprehur që do të bojkotojmë këtë takim. Kuptohet bojkoti nuk bëhet ndaj vlerave të Samitit të Presidentëve, po bojkoti bëhet ndaj vendit mikpritës, jo si vend, Ukrainës, por pikërisht standardit të demokracisë që sot vërtetë është një krizë të ushtrimit të tij", tha Presidenti i Republikës, Bamir Topi. Samiti i Ukrainës, i parashikuar për t'u zhvilluar në datat 11-12 maj të këtij viti normalisht duhet të ishte vazhdimi i traditës së takimeve të Presidentëve të Evropës Qendrore dhe

Juglindore dhe në themel të filozofisë së këtij komunikimi të përvitshëm janë arritja e standarteve të demokracisë në të gjitha vendet që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimi Europian. Një sërë politikanësh të lartë evropianë janë duke deklaruar bojkotimin e vizitave të planifikuara në Ukrainë, përfshirë kampionatin europian të futbollit, për arsye të trajtimit që po i bëhet ish-kryeministres Julia Timoshenko. Kreu i KE, Jose Manuel Barroso si edhe komisionerja për drejtësinë Viviane Reding kanë thënë se do e bojkotojnë kampionatin Euro 2012 që zhvillohet në Ukrainë dhe Poloni. Kancelarja gjermane mund të bëjë të njëjtën gjë, tha një zëdhënës i saj, duke shtuar se gjithçka varet nga fati i zonjës Timoshenko.

### LAJME SHKURT

#### ■ Konomi më në fund në vend të Sesorit

Edison Konomi është ligjvënës i ri i Parlamentit shqiptar, i cili mesditën e djeshme u ul zyrtarisht në "karrigen" e ligjvënës, duke zëvendësuar kështu Rudina Sesorin, pasi bëri betimin. Edhe pse duhet të zinte vendin e Sesorit, Konomi e përuroi mandatin në karrigen e Ben Blushit. Konomi do vijojë pjesën e mbetur nga mandati i deputetes Sesorit pas braktisjes së mandatit nga ana e kësaj të fundit pak muaj më parë. Pak ditë më parë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zyrtarisht deputetin më të ri të Partisë Socialiste zëvendësuar kështu Rudina Sesorin. Përzgjedhja e Konomit është bërë në bazë të listës së kandidatëve që PS ka paraqitur në zgjedhjet e vitit 2009.

#### ■ Një minutë heshtje për Ardian Klosin

Deputetja socialiste Valentina Leskaj, njëkohësisht edhe kryetarja e komisionit të Medias, ka kërkuar që Kuvendi të mbajë 1 minutë heshtje në nderim të kujtimit të Ardian Klosit. "Shqipëria, u shpreh Leskaj, ka humbur jo vetëm një ndër intelektualët e shquar të botës shqiptare, por edhe një nga kontributorët e ditëve të para për demokraci. Ditë më parë u nda nga jeta në mënyrë tragjike një ndër intelektualët e shquar të botës shqiptare, Ardian Klosi. Shqipëria humbi një prej personaliteteve që u shqua si historian, përkthyes, publicist. Ardian Klosi njihet si një nga kontributorët e ditëve të para për demokraci përfshirë edhe kontributin e tij në gazetën e parë opozitare, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Botues të saj", u shprehur Leskaj.



**Presidenti, Gjinushi sulm Malajt: Ti po i shërben Berishës**

Deputeti socialist, Arben Malaj, dhe kryetari i PSD, Skënder Gjinushi, kanë debatuar në emisionin 'Fakt' në UTV rreth qëndrimit të opozitës për zgjedhjen e presidentit. Debatu ka qenë i ashpër, pasi Arben Malaj mbroste idenë se opozita nuk duhet ta bojkotojë procesin, ndërsa Gjinushi mbroste tezën se nëse Berisha nuk pranon një kandidatūrë konsensuale, opozita nuk ka pse bëhet fasadë e tij në

Kuvend. Debatu rriti tonet shumë kur Malaj këmbëngulte se opozita duhet të provojë të votojë dhe kandidatë jo konsensualë, duke iu referuar ish-kryetarit të Partisë Socialiste Faton Nano. Debatu mes tyre u acarua, pasi Gjinushi theksoi faktin se Nano është në lojën e Berishës dhe se qëndrimet e Malajt nuk janë qëndrime të opozitës, por të Berishës. "Ti po i shërben Berishës", i tha Gjinushi Malajt. Duke sjellë

dhe ndezjen e atmosferës në këtë debat televiziv, ku janë përplasur dy përfaqësues të së majtës. Gjinushi ka qenë një kundërshtar i hershëm i idesë për të hyrë në negociata me Berishën për reformën zgjedhore, reformën në drejtësi dhe në veçanti për të zgjidhur sfidën presidenciale, pasi për të kryeministri duhet të largohet nga posti, si shkak i të gjitha problemeve në Shqipëri.

Ambasadori amerikan në Tiranë në ditën botërore të lirisë së medias, alarm për Shqipërinë

# Media, Arvizu: Ka presion politik

"Pati raste presioni politik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi median, përfshirë kërcënime ndaj gazetarëve. Në disa raste presioni politik dhe mungesa e fondeve kufizuan median e shkruar"

TIRANE  
JAKIN MARENA

**Lajmi**

Ambasadori i SHBA në Tiranë, Alexandër Arvizu në ditën botërore të lirisë së medias dha alarmin se në Shqipëri ka presion politik mbi median në mënyrë direkte e të tërthortë, madje deri në kërcënim ndaj gazetarëve, duke i detyruar ata të vetëcensurohen.



Alexandër Arvizu

gazetarëve. Në disa raste presioni politik dhe mungesa e fondeve kufizuan median e shkruar të pavarur, e gazetaret raportuan se kishin ushtruar gjerësisht vetëcensurë, tha ambasadori amerikan, Arvizu. Ai i referohet konstatimeve për censurën e mungesën e kontratave të punës që i bën shpesh gazetarët të raportojnë në mënyrë jo objektive. "E ardhmja e drejtë e Shqipërisë në BE varet nga një media e fortë dhe e pavarur", tha ai. Arvizu tha se në disa raste

te, s'janë vetëm qeveritë që sulmojnë, kanosin e kërcënojnë gazetarët por kriminelët, kartelët e drogës, terroristët apo fraksionet politike. "Kur gazetaret kërcënohen, sulmohen, burgosen, apo zhduken, gazetaret e tjerë vetëcensurohen. S'raportojnë më lajmet, ulin tonet e lajmeve, lënë hollësi pa përmendur. Burimet nuk i ndihmojnë më. Redaktorët hezitojnë të botojnë artikuj. Vendin e së vërtetës e zë frika. Të gjitha shoqëritë tona vuajnë", theksoi Arvizu.

e legjislacionit të rëndësishëm për shpifjen. Ky ishte një hap i vërtetë përpara. Por raporti vjetor i DASH për Të Drejtat e Njeriut vërente një numër fushash që kanë nevojë për

përmirësim", tha Arvizu. "Media është aktive e në masë të gjerë e pakufizuar. Por pati raste presioni politik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi median, përfshirë kërcënime ndaj

Në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, ambasadori amerikan në Shqipëri, Aleksandër Arvizu përmes një artikulli thotë se ardhmja e Shqipërisë në BE varet nga një media e fortë dhe e pavarur. "Në Shqipëri panorama ka qenë e përzier. Pozitivu pa përparimi në miratimin

**Koment**

## Presidencialet, një garë për tu shpikur

NGA PREÇ ZOGAJ  
vizon nga faqja 1

...detyrës, sipas përcaktimit në kushtetutë. Sepse ai nuk ka fituar, por e ka rregulluar. Ose ka dalë rastësisht si zgjidhje e minutës së fundit nga kombinimi i rrethanave. E gjithë kjo zbulon në fund të fundit diçka përvorse në vetë mekanizmin dhe funksionimin e sistemit tonë të Republikës parlamentare. Sistemi që kemi e kufizojnë garën presidenciale, kjo është e qartë. Si të mos mjaftonin kufizimet e sistemit, kemi edhe kufizimet e zakonave. Përballja e rivalëve në debate të hapura është bërë prej vitesh një mullë e ndaluar për publikun shqiptar. Kandidatët e forcave të mëdha politike llogarisin të fitojnë me zgjidhje dhe marifete anësore, "pa beteje" të drejtpërdrejtë dhe pa gjykim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit. Ata i bëjnë bisht përballjes për programet, nuk fitojnë, por e hedhin edhe njëherë lumin, ndryshe garojnë dhe ndryshe qeverisin. Në këtë aspekt marrëdhënia e politikës me publikun ka arritur pikën më të ulët të denatyrimit dhe degradimit. Nuk e teprojmë po të themi se për të ashtuquajturën elitë politike publiku nuk ekziston si zot i botës së tyre. Në fakt nuk ekziston. Po të ekzistonte nuk do të shpërfillej në këtë mënyrë.

vështirësive që paraqet, mbetet për t'u shpikur. Askush dhe asgjë nuk i pengon kandidatët e vetëkandiduar apo të kandiduar nga ndonjë parti politike t'i japin një përmasë më publike garës së tyre, duke paraqitur miniprograme apo programe për drejtësinë, për liritë dhe të drejtat njerëzore në kontekstin shqiptar, për marrëdhëniet me ekzekutivin dhe institucionet e tjera të pavarura, për politikën e jashtme, e tjerë. Asgjë nuk i pengon të organizojnë takime me shtresa të caktuara apo të kërkojnë të dëgjojnë në grupet parlamentare. Nuk ka dyshim se këto forma rrisin piacën e garës, normalisht edhe presionin pozitiv ndaj atyre që e kanë në dorë zgjedhjen e Presidentit. Të humburit në një fushatë të tillë i bëjnë një shërbim vendit në fakt sepse, ndër të tjera, bëjnë të dalë në pah meskiniteti i krerëve kur të nxjerrin nga mënga asin e tyre mediokër.

Një element tjetër me rëndësi i kësaj gare është shpalosja e vizioneve që kanë dy partitë më të votuara dhe krerët e tyre për postin e Presidentit të Republikës. Çfarë presidenti duan ata? A mund t'ja thonë hapur publikut? Berisha e ka të vështirë të jetë transparent dhe i besueshëm. Ka provuar, pa sukses nga këndvështrimi i tij, qoftë me konsensualin Alfred Moisiu, qoftë me politikun Bamir Topi. Rama nga ana e tij i ka të gjitha mundësitë të jetë më i hapur në këtë pikë. Rama dhe Berisha mund të kenë mendime të ndryshme për profilin dhe ro-

lin e Presidentit, por përderisa askush nuk e fiton këtë betedë në fushë të hapur, me votë popullore, është mirë të vendoset prej tyre me një marrëveshje

gjentelmenesh që Presidenti të jetë një politikan, një ish politikan apo një figurë e shquar mbi të gjashtëdhjetat, më mirë akoma rreth të shtatëdhjetave. Ber-

isha dhe Rama mund të mendojnë e të shprehin edhe për zgjedhjen e Presidentit nga populli. A ia vlen? Përgjigja do të ishte "jo", nëse populli do të

kishte në dorë të zgjidhte vetë deputetët. Por sa kohë që deputetët zgjidhen si në autobus dhe kryeministri del nga kombinacionet e aleancave dhe t'rezave, është e domosdoshme që një prej pushteteve në Shqipëri të mbulohet me votë popullore. Në të kundërtën, publiku duhet të kuptojë se oligarkia politike ka prirjen ta kanalizojë në drejtimin që i intereson atë që quhet vullnet i popullit, pra ta shvlerësojë. Askush nuk e ka thënë deri tani se ligji spanjoll i zgjedhjeve që ka përshtatur Shqipëria, përtej retorikës mashtruese, u përzgjedh për një arsye shumë praktike: për t'i siguruar oligarkisë së partive të mëdha hyrjen në parlament pa garë në popull, me një garë servilizmi ku duhet të fitojnë simpatinë e kryetarit të partisë për t'u vendosur në krye të listës.

Kjo është t'ia hedhësh publikut. Por publiku, ai i liri, nuk duhet të qahet apo të llastohet sikur atij vetëm ia fusin dhe s'ka faj i shkrerit. Publiku duhet të jetë i ndërgjegjshëm se kur voton për shumicën qeverisëse, voton edhe për Presidentin. Kjo është logjika e sistemit të republikës parlamentare, logjikë e cila, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008, është sanksionuar edhe në Kushtetutë. Kur e rrethon elita e vet politike, publiku i ka të gjitha mundësitë të çajë rrethimin me votë. Vota e lirë nuk mund të rrethohet. Vetëm po të ngjallej Enver Hoxha dhe të hiqej dhoma e fshehtë, gjë që nuk mund të ndodhë.

BIE

Fair

**BALKANS' INTERNATIONAL EDUCATION FAIR**

Ne datën **5 Maj 2012**, organizohet Panairi Nderkombëtar i Edukimit për Ballkanin, (BIEF) në Tiranë, Shqipëri pranë **Hotel Rogner-Europapark në Bulevardin 'Deshmoret e Kombit'**.

Ky panair perqendrohet ne prezantimin e programeve per Edukimin jashte vendit ofruar talenteve te Shqiperise dhe gjithë Ballkanit. *Jane te ftuar te gjithë nxenesit dhe studentet e cdo moshe nga Shqiperia, Kosova, Mal i Zi dhe Maqedonia. Aty ju presin dhe shume surpriza te tjera FALAS.*

Pjesemarros do te jene *vetem* shkollat dhe institucionet e huaja te cilat per nje dite do te ofrojne mundesi aplikimi te drejtperdrejt apo thjesht intervistim e takim me aplikante te interesuar per: Kolegje, Universitete, pre-Master, Master, PhD, Internships, Work Experience, Summer Schools, programe specifike dhe bursa studimi.

Do te keni mundesi te kontaktoni me Rrjetet e Shkollave per aplikime ne: UK, USA, Canada, Australia, New Zealand, Singapore, Malaysia, Greece, Malta, Germany, Austria, France, Spain, Italy, Turkey etj.

Te gjitha shkollat do te kene perfaqesuesin ekzekutiv per regjistrimin e aplikimeve te cilat fillojne me: **9:30 deri me 19:00.**

**Oftrohen mbi 2000 profile akademike dhe rreth 15.000 programe te dedikuara, ne 21 gjuhe te ndryshme.**

Ju ftojme te shpenzoni nje te shtune ne shoqerine tone ne kete event unik, organizuar per here te pare ne Tiranë, Shqiperi.

Hyrja eshte falas, veshja 'si per te Shtune 😊 e thjeshte. Do te asistoheni ne perkthim ne gjuhen Shqipe.

Cdo koment mund t'a botoni ne: [events@ande-lm.com.al](mailto:events@ande-lm.com.al)

JU PRESIM TE PANUMERT.  
JU FALENDEROJME PARAPRAKISHT!

## Turizmi, "yjet" i vendosin operatorët sipas dëshirës

Vetëm 26 hotele në Shqipëri, nga 600 të tillë gjithësej, kanë "yjet" që meritojnë, ndërkaq shumë të tjera janë, madje, të paregjistruara. Ministria e Turizmit prej disa vitesh nuk bën më certifikim të standarteve të hoteleve, duke e lënë atë në dorë të vetë këtyre biznesve për t'io deklaruar sipas dëshirës. "Pa u standartizuar si njësi, nuk mund të arrish

rezultate pozitive. Po bëhet një përpjekje nga Shoqata e Turizmit, në bashkëpunim me USAID-in, për të bërë një kategorizim për standartet e hoteleve", deklaroi dje kryetari i Akomodimit, Zak Topuzi. Sipas të dhënave të shoqatave të turizmit, në vend ka 60 mijë shtretër, nga të cilët 23 mijë ofrohen në hotele. Por ajo që i tërheq turistët e huaj të vijnë në Shqipëri, është

natyra e egër. "Turistët në përgjithësi pëlqejnë natyrën e virgjër, janë ngopur me natyrën e kultivuar. Duan natyrën e egër, u pëlqen mikpritja e ushqimi shqiptar", shprehet Topuzi. Njëzet një letre dërguar kryeministrit, shoqata e njërive turistike ka kërkuar nga qeveria ulje të TVSH-së, në masën 8% dhe ulje të taksës së fjetjes.

Me një VKM të papublikuar, punonjësit e Shifrës kaluan nga SHISH te Mbrojtja

# Berisha, sekretet nën kontroll

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar e shqetëson më së tepërmi qeverinë, duke e marrë tashmë krejtësisht nën kontroll edhe këtë sektor të shërbimeve inteligjente

## Lajmi

Me një Vendim, të marrë jashtë mbledhjeve të zakonshme javore dhe të mbajtur fshehur një muaj, qeveria shqiptare ka vendosur t'i heqë përfundimisht të drejtën e menaxhimit të shërbimit të Shifrës Shërbimit Informativ, për të kaluar punonjësit dhe fondet përkatëse buxhetore në ministrinë e Mbrojtjes.



Në foto: Kryeministri Sali Berisha dhe Kreu i SHISH Brahari Shaqiri

## Vartësia

Vendimi i qeverisë përbën një turrje të kompetencave të shërbimeve inteligjente kombëtare, pasi mbrojtja e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe hartimi e shkatërrimi i materialeve kriptografike janë kompetencë vetëm e Ekzekutivit

dhimi, instalimi i shifrës, dhe kontrolli i përdorimit të shifrës për të gjitha institucionet shtetërore; mbrojtja e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në të gjitha strukturat shtetërore, kur ky informacion transmetohet me mjete të komunikimit masiv e publik; përdorimi i mjeteve, pajisjeve e sistemeve kriptografike të specializuara, fortësia e të cilave të jetë në përputhje me nivelin e klasifikimit të informacionit dhe përdorimi i sistemeve kriptografike, mjeteve e pajisjeve të komunikimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që duhet të bëhet pas miratimit e certifikimit nga DSIK-ja.

Me sa duket, ka qenë pikërisht mbrojtja e informacionit të klasifikuar, që e shqetëson më së tepërmi qeverinë, duke e marrë tashmë krejtësisht nën kontroll edhe këtë sektor të shërbimeve inteligjente.

## LAJME SHKURT

■ **Leku sërish rivlerësohet ndaj euros, bie ndaj USD**  
Ditën e djeshme, në tregun valutor leku është vlerësuar sërish kundrejt monedhës europiane, një lajm i mirë ky për kredimarrësit në euro. Një euro është këmbyer dje me 140.11 lekë, 0.08 lekë më pak se një ditë më parë. Ndërkohë, leku po vijon të dobësohet ndërkohë kundrejt monedhës amerikane. Një dollar është kuotuar në nivelin e 106.62 lekëve një ditë më parë, ndërsa, krahasuar me të mërkurën, është këmbyer me 0.07 lekë më shumë.

■ **Draghi: Inflacioni do të rritet, kredi më të lira**

Presidenti i Bankës Qendrore Europiane, Mario Draghi, deklaroi se presionet inflacioniste do të vazhdojnë të jenë prezente, ndërsa kostoja e huamarrjes do të shënojë rënie. Në konferencën e përmuajshme, Draghi tha gjithashtu se Banka Qendrore është e gatshme të ofrojë më tepër likuiditet për sektorin bankar europian, nëse do të jetë e nevojshme. Përsa i përket programit të dytë të rifinancimit në terma afatgjatë, që përfundon në datën 1 mars, Draghi tha se ky operacion do kohën e vet për të dhënë rezultatet.

■ **Kompania Lufthansa shkurtor mbi 3 mijë vende pune**

Kompania e madhe gjermane Lufthansa ka shpallur planet për të eliminuar 3.500 vende pune në vitet e ardhshme, në një përpjekje për të shkurtuar shpenzimet dhe për të rritur fitimet. Njoftimi u bë të enjten pasi kompania një ditë më parë njoftoi humbje prej 397 milionë eurosh në tremujorin e parë të vitit 2012. Kompania përmendi shpenzimet e larta të karburantit për aeroplanët e saj dhe tatimet si shkak për këtë. Shkurtime e vendeve të punës janë pjesë e një plani për të kursyer 1.5 miliardë euro deri në fund të vitit 2014. Lufthansa raportohet se ka rreth 120 mijë të punësuar.

## TIRANE

### GENC KONDI

Më datë 9 prill të këtij viti, qeveria shqiptare ka vendosur përfundimisht largimin e shërbimit të Shifrës ngë Shërbimit Informativ Shtetëror dhe kalimin e tij në vartësi të ministrisë së Mbrojtjes. Vendimi mban një datë, 9 prill 2012, gjatë së cilës nuk është zhvilluar mbledhje e Këshillit të Ministrave, duke lënë të kuptohet urgjencën në marrjen e një mase të tillë. Ndryshe nga praktika në shumicën e rasteve, VKM në fjalë nuk është publikuar as në sajtin zyrtar në internet të Këshillit të Ministrave, por ka hyrë menjëherë në fuqi, pavarësisht nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

### VENDIMI

Shërbimit Informativ të Shtetit, me këtë Vendim, i hiqet një fond buxhetor prej 10 milionë lekësh të reja, që ishin caktuar më parë në Buxhetin e Shtetit të vitit 2012, ku për shpenzime korrente ishin parashikuar 9.6 milionë lekë dhe për investime 400 mijë lekë. Po ky fond, i kalon ministrisë së Mbrojtjes në programin "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi".

Ministrisë së Mbrojtjes i shtohen shtatë punonjës për funksionimin e Drejtorisë së Shifrës, si autoriteti kombëtar për sigurimin e komunikimeve dhe autoriteti kombëtar i shpërndarjes, në varësi të kësaj ministrie, thekson qeveria, duke shtuar se, në të njëjtën kohë, Shërbimit Informativ të Shtetit i pakësohen shtatë punonjës.

### KOMPETENCA

Në kuadër të një fushate për të kufizuar kompetencat e

Shërbimit Informativ Shtetëror, qeveria, në mbledhjen e javës së parë të tetorit 2011, ka marrë vendimin që Drejtoria e Shifrës të mos jetë më një strukturë në varësi të SHISH-it, por të kalojë si strukturë në një institucion që kontrollohet nga Ekzekutivi. Në mënyrë të tjerë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e qeverisë.

Në vendimin e mëparshëm të qeverisë, me numër 922, datë 19.12.2007, fjalët "strukturë në varësi të Shërbimit Informativ të Shtetit", janë shfuqizuar.

### KONTROLLI

Në vendimin e qeverisë me datë 19 dhjetor 2007 përcak-

tohen kompetencat e sigurisë së komunikimeve. Sipas kësaj VKM-je, Drejtoria e Shifrës, strukturë në varësi të Shërbimit Informativ të Shtetit, do të ishte Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Komunikimeve dhe Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes.

Vendimi vitin e kaluar nga qeveria, që e ndryshonte këtë vartësi, përbën një turrje të kompetencave të shërbimeve inteligjente kombëtare, pasi, jo vetëm mbrojtja e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në të gjitha strukturat shtetërore, por edhe hartimi e shkatërrimi i materialeve kriptografike, do të jenë tash-

më një kompetencë vetëm në dorë të qeverisë.

Në ligjin për sigurimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit roli i Drejtorisë së Shifrës sqarohet më së miri duke i lënë gjithë kompetencat Drejtorisë së Shifrës, strukturë në varësi të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Në ligjin e vitit 2007 Autoriteti Kombëtar i Sigurimit të Komunikimeve, ishte autoriteti i vetëm përgjegjës për sigurinë e informacionit. Në VKM, detyrat kryesore të këtij autoriteti, ishin: hartimi, pro-

## Financat

# BQE, s'ndryshon interesi i euros


## TIRANE

Banka Qendrore Europiane i ka lënë dje normat e interesit bazë të pandryshuara për monedhën e përbashkët euro në 1 për qind, ndërkohë që eurozona nuk arrin ta marrë veten nga efektet e masave të rrepta fiskale që janë ndërmarë në 17 vende. Vendimi nga këshilli drejtues i BQE-së - që u takua në prani të forcave të mëdha të sigurisë në Barcelonë të Spanjës - ishte gjerësisht i pritshëm. Banka qendrore ende po pret ndikimin e huasë prej 1 mijë miliardë euro me afat trevjeçar që u ka dhënë bankave të eurozonës dhe do që të mbajë presionin mbi qeveritë që të zbatojnë reforma fiskale



dhe në tregjet e punës. BQE është bërë më e shqetësuar rreth dobësisë së ekonomisë së eurozonës dhe nuk ka të ngjarë të përjashtojë veprime të mëtejshme në muajt në vijim - si ulje të nor-

mave të interes apo injektim të reja të likuiditetit afatgjatë në sistemin bankar. Ecuria negative e rënies ekonomike në Spanjë, ku pothuajse një në katër punonjës është i papunë, ishte në qendër të vëmendjes dhe si rrjedhojë e faktit që takimi u mbajt në Barcelonë. Ndërkohë, Franca dhe Spanja zhvilluan ankande të suksesshme të borxheve qeveritare, duke qetësuar tensionin elektoral, përpara një fundjave të nxehtë me ngjarje politike. Parisi shiti 7.4 miliardë euro bono thesari, me kërkesë të lartë për letrat me vlerë 9, 10 dhe 13-vjeçare. Spanja gjithashtu shiti sasi maksimale, 2.5 miliardë euro, në bonot tre dhe pesëvjeçare, por me interesa shumë më të larta.



## Grabitën 50 mijë euro, 30 vite burg pesë bullgarëve

Njësitë hetimore Task-Forcë, pranë prokurorisë së Tiranës kërkon dënimin me 30 vite burg për pesë hakërsat bullgarë që vidhnin bankomatet në Shqipëri. Prokurori Armand Gurakuqi, dje lexoi pretendencën për shtetasit Dragomir Bonev, Ivo Ivanov, Nikolay Tsonev, Pavel Milenov dhe Aleksander Kolev, duke i kërkuar gjykatës së Tiranës shpalljen e të

pandehurve fajtorë dhe dënuar ata me nga 6 vite burg secilin. Sipas konkluzioneve të prokurorit Gurakuqi, pesë të pandehurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë arritur që në vende dhe kohë të ndryshme të tërheqin nga bankomatet shumën prej 50 mijë euro në 282 transaksione. Sipas akuzës pas përvetësimit të të dhënave të klientëve shqiptarë, shtetasit bullgarë i klononin

kartat dhe më pas disa i përdorin vetë në Shqipëri disa të tjera i dërgojnë me postë drejt Bullgarisë ku edhe i përdorin për blerje të ndryshme. Përveç tërheqjes së parave kesh, të pandehurit kanë bërë edhe blerje me anë të internetit në SHBA me këto karta të klonuara. Lidhur me këtë vepër penale pesë bullgarët hetohen dhe në Bullgari, për vjedhjen e bankomateve.

## UEFA: Drejtuesit e klubeve pastrojnë paratë e krimit

# Ekipet shqiptare, me kontigjentë kriminalë

### Zbardhet takimi mes Pierre Cornu e prokurorëve

#### Lajmi

Futboli shqiptar është i kapur nga eksponentë kriminalë të cilët arrijnë të bëjnë pastrimin e parave të fituara në mënyrë të kundërligjshme. Alarmi vjen nga zyrtarë të UEFA-s të cilët dje kanë zhvilluar një takim me dy prokurorë shqiptarë, ku kanë diskutuar lidhur me hetimin e rasteve të trukimit të ndeshjeve.

#### TIRANE

ELTON QYNO

Zyrtarë të UEFA-s kanë vënë alarmin se futbollit shqiptar menaxhohet nga kontigjentë kriminalë që janë të implikuar në grupe kriminale. Ekipet e futbollit këta persona i përdorin thjesht për të kryer pastrimin e parave të fituara nga vepërimtaritë e jashtëligjshme dhe se aspak atyre nuk i intereson cilësia e futbollit që luhet në fushat e blerta. Në takimin e zhvilluar mes përfaqësuesit të UEFA-s Pierre Cornu, Drejtorit të Hetimit në Prokurori Sokol Stojani, prokurorit Shkëlqim Hajdari dhe përfaqësuesit të Federatës Shqiptare Eduard Prodan, u diskutua për një sërë pikash, ku më tepër palët u përqëndruan në ato që kishin të bënin rreth bashkëpunimit mes UEFA-s, FSHF-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim hetimin e rasteve ku ka informacione për trukimin e ndeshjeve sportive. Mësohet se në takimin me dyer të mbyllura Pierre Cornu i ka vënë në dijeni prokurorët shqiptarë se disponon informacione se në futbollin shqiptar biznesmenët në ndryshëm janë duke financuar para kriminale. Sipas UEFA-s, fushat e blerta janë të kthyer në Shqipëri si një mekanizëm tepër i rëndësishëm për të bërë pastrimin e parave, pasi biznesmenët që janë të implikuar në trafikun e drogës, prostitucionit dhe krime të tjera investojnë në futboll. Pierre Cornu ka shprehur habinë se pse pikërisht gjatë këtyre viteve, nuk është hetuar asnjë klup futboll në Shqipëri, për të mësuar rreth buxhetit të tij dhe mënyrën e ardhjes së parave.

**TAKIMI NË**

#### PROKURORI

Paraditen e djeshme në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme është zhvilluar një takim mes dy prokurorëve Stojani dhe Hajdari si dhe përfaqësuesit të UEFA-s Cornu e përfaqësuesit të FSHF-së Eduard Prodan. Gjatë takimit palët ranë dakort për ritjen e bashkëpunimit midis tre institucioneve me qëllim hetimin e rasteve të trukimit të ndeshjeve sportive. Cornu in-

formoi se UEFA ka vendosur një sistem për deduktimin e të dhënave nga vende të ndryshme mbi rezultatet e ndeshjeve, çka përbën një indicie mbi të cilën mund të hetohet mbi mundësitë e ndeshjeve me rezultat të fiksur. Ndaj në këtë kuadër, përfaqësuesi i UEFA-s, kërkoi mbështetjen e Prokurorisë Shqiptare si dhe përfshirjen e strukturave të tjera shtetërore për ta vlerësuar seriozisht këtë

shqetësim. Nga ana e përfaqësuesve të Prokurorisë Shqiptare, u theksua se nga ana e institucionit të akuzës do të ketë mbështetje të plotë dhe bashkëpunim për të luftuar këtë fenomen negativ. Në këtë aspekt, u pa me interes përdorimi i dhënave të deduktim-it që përdor UEFA për trukimin e ndeshjeve, të cilat mund të shfrytëzohen për hetim. Njëkohësisht, gjatë

penale në Shqipëri, pasi kap vite më parë Hajdari me një nisim të tijen ka arritur të miratojë një ligj që bën fjalë lidhur me fiksimin e rezultateve të lojërave sportive. Fenomeni i trukimit të ndeshjeve në vetvetë është korrupsion, pasi duke ndikuar financiarisht mbi një ose më shumë lojtarë, arrihet të përfitohen shuma financiare astronomike brenda një periudhe prej vetëm 90 minuta.

#### Gjatë takimit palët ranë dakort për ritjen e bashkëpunimit midis tre institucioneve

takimit u vlerësua edhe që të shihet mundësia për profilimin e oficerëve të veçantë të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit për parandalimin e ndeshjeve të truquara.

#### TRUKIMI SI KORRUPSION

Prokurorët Shkëlqim Hajdari dhe Sokol Stojani, u shprehën gjatë takimit se trukimi i rezultatit të një ndeshje sportive është vepër

penale në Shqipëri, pasi kap vite më parë Hajdari me një nisim të tijen ka arritur të miratojë një ligj që bën fjalë lidhur me fiksimin e rezultateve të lojërave sportive. Fenomeni i trukimit të ndeshjeve në vetvetë është korrupsion, pasi duke ndikuar financiarisht mbi një ose më shumë lojtarë, arrihet të përfitohen shuma financiare astronomike brenda një periudhe prej vetëm 90 minuta. Prokurorët shqiptarë i kanë kërkuar gjatë takimit vënie në dispozicion të informacioneve dhe më pas do jenë ata që do ndjekin penalisht abuzuesit e këtyre rasteve. Ndërkohë që përgjatë këtyre viteve ka qënë prokuroria e Durrësit ajo që gjatë hetimeve ka arritur të prangosë disa persona, mes tyre dhe biznesmenin Paro Laçi për trukimin e një ndeshje sportive të kategorisë së tretë që luhet mes Sukthit dhe ekipit të Rubikut. Ndërsa për sa i përket skuadrave të kategorisë së parë edhe pse flitet shumë për trukimin e rezultatit asnjë rast nuk është arritur të hetohet nga prokuroria.

#### LAJME SHKURT

#### ■ Tritol uqsjellësit, pranga dy personave

Dy persona janë vënë në pranga nga Policia e Librazhdit pasi dyshohet se janë autorët kryesorë të vendosjes së eksplozivit në ujësjellësin të fshatit Gizavesh. Sipas burimeve zyrtare, mësohet se janë identifikuar si të dyshuarit kryesorë për ngjarjen, të cilët janë shtetasit Gëzim Topi, 37 vjeç dhe Petrit Buzra 58 vjeç. Denoncimi është bërë nga banorët e fshatit, të cilët kishin pikasur sasi të konsiderueshme tritoli në depon e ujit. Kanë qënë ekspertët e kriminalistikës ku në bashkëpunim me forcat e xhenjos kanë bërë të mundur heqjen e tritolit.

#### ■ Vlorë, zjarr i djeg skafin brenda në port

Një zjarr i fuqishëm shpërtheu në afërsi të depozitave të bitumit në Portin e Vlorës. Një skaf i ankoruar në brendësi të një punishteje riparimi u shkumbua nga flakët që ranë dje në këtë zonë. Nuk dihen shkaqet e këtij zjari të befasishtëm ndërsa për të shuar flakët e tij është dashur mjaft punë për shkak se terreni ishte i mbingarkuar nga mbetje inerte. Dëshmitarët thanë se në fillim është dëgjuar një shpërthim i fuqishëm e më pas flakët u përhapen me shpejtësi. Ne vendin e ngjarjes shëni i zjarrfikësve, Ernest Pashai tha se po hetohet për zbardhjen e plotë të ngjarjes, e cila mund të kishte shkakuar zjarr edhe në zonën e banuar.

## Pretenca e prokurorisë

# Gjobiti Bombaj, 3 vjet burg "Stresit"

#### TIRANE

Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar dënimin me 9,6 vite burg për Akimend Lushaj ose siç njihet ndryshme me emrin artistik "Stresi" dhe tre shokëve të tij që gjobitën vitin e kaluar me 25 mijë euro rregjizorin Leonard Bombaj. E vetmja që i ka shpëtuar masës së dënimin ka qënë e pandehura me inicialet A.XH. për të cilën prokuroria vendosi të pezullojë dosjen. Ndërsa për sa i përket masës së dënimin për katër të pandehurit prokuroria kërkoi dënimin me 3 vite burg të këngëtarit "Stresi", më 2 vjet burg për shtetasin Rolando Kurti, 2 vjet burg për Sevastian Kallabakun dhe 2.6 vite për të pan-



dehurin Elis Basha. Në konkluzionet përfundimtare prokurori Ardian Nezha u shpres se 15-vjeçarja me inicialet A.XH. është bërë shkak i këtij konfliktit me Leonard Bombaj dhe të pandehurve Arkimend Lushaj, Rolando Kurtin, Elis Bashën dhe personin tjetër të identifikuar së fundi me emrin Sevastian Kallabaku të njohur ndryshe me nofiken "Arusha". Sipas të dhënave të Prokurorisë, vajza 15-vjeçare ka deklaruar gjatë komunikimit të akuzës se nuk e kishte kërcënuar regjisorin Bombaj edhe pse ai e kishte përdhunuar disa here në ambientet e studjove "Sirea Film". Gjithashtu, vetë 15-vjeçarja ka mohuar se së bashku me këngëtarin "Stresi" i kishin kërkuar regjisorit të paguajë

shumën prej 25 mijë eurosh si formë presioni për të mos e denoncuar publikisht si përdhunues femëjsh. Në dëshminë e katër të pandehurve të tjerë, vihat re i njëjti qëndrim. Ata kanë mohuar akuzat dhe pretendojnë se nuk i kanë vënë gjobë regjisorit Bombaj. Mirëpo ky i fundit pretendon se nën presionin e vazhdueshëm të armës, por dhe presionit psikologjik, autorët i kanë marrë fillimisht 5 mijë euro, si dhe automjetin e tij. Më pas makina i është rikthyer si rezultat i negociimit me babanë e të pandehurit Arkimend Lushaj, ndërsa ky i fundit në bashkëpunim dhe me të pandehurit e tjerë kanë vijuar duke i kërkuar në formën e gjobës shumën prej 25 mijë eurosh.

AKTUALITET



**SHKODËR, PRANGA GRABITËSVE**  
Policia e Shkodrës ka bërë të mundur parandalimin e një grabitje në një lokal, duke prangosur në flagrancë dy persona. Petrit Palnikaj, 20 vjeç nga Tropoja dhe Altin Logu 26 vjeç, nga Dukagjini u vunë në prangat e policisë pasi të lartpërmendurit u kapën në flagrancë, duke tentuar të vjedhin, në bashkëpunim me njëri-tjetrin një lokal privat, në lagjen Skënderbeg të Shkodrës.





**KAVAJË, 6 TË ARRESTUAR**  
Gjashtë të mitur janë vënë në prangat e policisë së Kavajës të akuzuar për vjedhje të rreth 15 lokaleve, bizneseve dhe banesave të ndodhura në zonën e Kavajës dhe Durrësit. Pas kallëzimit nga ana e të dëmtuarve, policia arriti të prangosë shtetasit A.Sterniqi, A.Merhori, G. Isha, E.Berdufi, A. Zhugri dhe 20 vjeçarin Gëzim Myzeqari që të gjashtë me banim në Kavajë.

# Zbardhen përgjimet e tre të dyshuarve për falsifikim Kartat e identitetit false, zbulohet baza

## Personat punonin pranë rrugës së Bogdanëve

**Lajmi**  
Zbulohet në Tiranë një bazë falsifikatorësh të kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Policia nëpërmjet përgjimeve dhe blerjeve të stimuluar ka arritur të identifikojë tre persona, të cilët nëpërmjet shumave financiare kryeni falsifikimin e dokumentave të ndryshme.



Në foto: Faksimile e vendimit të gjykatës

**TIRANE**  
ELTON QYNO

Prokuroria dhe policia e Tiranës kanë zbuluar një bazë falsifikimi që ndodhej në një lokal, pranë shkollës "Avni Rustemi", që ndodhet mes rrugës së "Durrësit" dhe asaj të "Kavajës". Tre persona Mariglen Nikaj ose siç njihet me nofkën Profesori, Fraglin Fekollari dhe Qazim Hysko janë të dyshuar se në bashkëpunim me njëri-tjetrin arrinin të paisnin me karta identiteti, certifikata dhe pasaporta biometrike shtetas të ndryshëm, duke u marë shuma të konsiderueshme financiare. Dy agjentë të infiltruar kanë bërë disa blerje të autorizuar nga prokurori i çështjes dhe pas kësaj edhe nëpërmjet përgjimeve kanë arritur të zbulojnë bazën e falsifikimit në kryeqytet.

Gazeta "Shqiptarja.com", siguron të plotë vendimin e gjykatës, e cila pas kërkesës së prokurorisë, autorizon policinë të bëjë një kontroll në lokalin ku dyshohet se shërbente për falsifikimin e pasaportave. Nga ky kontroll është arritur të sekuestrohen dy pasaporta biometrike, disa certifikata, dokumenta makine dhe disa karta identiteti. Aktualisht hetimet rreth kësaj çështje vashdojnë nga prokuroria e Tiranës.

**VENDIMI I PLOTË**  
Në vendimin e gjykatës thu-

het se nga ana e prokurorisë Tiranë është sjellë për gjykim kërkesa për kryerjen e kontrollit në lokalin BAR-KAFE me adresë "Rr.Bogdaneve" tek kryeqzimi i shkollës "Avni Rustemi", godinë 3-re katëshe përballë shkollës "Avni Rustemi" në katin e parë Tiranë. Gjatë shqyrtimit të kërkesës rezultoi se: Në datën 11.11.2011 ka filluar procedimi penal nr.4742 i vitit 2011 në ngarkim të shtetasit me pseudonimin "profesori" ose "geni". Policia gjyqësore Tiranë ka arritur të sig-

"B...". Kjo patentë ka rezultuar e falsifikuar me akt ekspertimi nr.9845 datë 24.11.2011. Emri dhe mbiemri i personit të dyshuar është Maringlen Nikaj. Është autorizuar nga Policia gjyqësore një person që pranon bashkpunimin që të kryjë një blerje të simuluar tek i dyshuari "Geni". Meqënjese dyshohet se shtetasi Maringlen Nikaj mund të ketë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 141/a dhe 186 të Kodit Penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimet nr.30

dt.21.03.2012 dhe 30/1 dt.05.04.2012 ka vendosur: "Lejimi e përgjimit të bisedimeve telefonike për numrat e telefonit 067... në përdorim të shtetasit Fraglin Fekollari dhe nr. 069... në përdorim të shtetasit Mariglen Nikaj për të gjitha thirrjet hyrëse dhe dalëse në këta numra telefoni si edhe përçaktimin në kohë reale të vendndodhjes së telefonuesit". Janë detyruar të marrin pjesë në përgjimeve telefonike 069... dhe 067... Nga përgjimi i këtyre numrave telefonike rezultoi se shtetasi Maringlen Nikaj bashkëpunon hapzati me shtetasin e quajtur Qazim Hysko i cili ka përdorur numrin telefonik 069... Konkretisht në datën 28.03.2012 ora 14:35 numri telefonik 069... që e përdor agjenti i Policisë gjyqësore ka udhëzuar në numrin telefonik 069... në përdorim të Maringlen Nikaj se mbiemri i personit Artur Kola në një nga dokumentet fallo të porositur nga policia, nuk ishte Bala po Kola. Në datën 28.03.2012 ora 14:36 shtetasi Maringlen Nikaj telefonon Qazim Hyskon në numrin telefonik 069... ku i transmeton udhëzimet e agjentit të Policisë gjyqësore për mbiemrin e personit fiktiv nga Bala në Kola. Në këtë rrethana rezultoi se shtetasi Maringlen Nikaj bashkëpunon me shtetasin Qazim Hysko ku ky i fundit ndërmerr aktin e falsifikimit fizik të dokumentave. Është sekuestruar dokumenti në emër të Artur Kola dhe me akt ekspertimi ka re-

## Falsifikimet Ministria, ndryshoi skemën e aplikimit

**TIRANE**  
Falsifikimi i kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike, solli ndryshimin e praktikës së aplikimit nga ana e strukturave të Ministrisë së Brendshme. Pak muaj më parë, ministria njoftoi të gjithë qytetarët se nuk duhet të paraqiteshin direkt tek zyrat e aplikimit, por si fillim për të marrë një pasaportë biometrike, duhet që ata të paiseshin me dokumentacionin përkatës nga kryeplaku i lagjes si dhe nga rajonet e policisë. Kjo mënyrë aplikimi u ndryshua, fill pas informacioneve

zultuar i falsifikuar. Nga raportet e shërbimit për vëzhgim-përgjimin e shtetasve Maringlen Nikaj dhe Qazim Hysko ka rezultuar se këta shtetas janë takuar shpesh me njëri-tjetrin duke shkëmbyer edhe sende me njëri-tjetrin sipas porosive simuluese të kryera nga Policia gjyqësore. Nga raportet e shërbimit të policisë gjyqësore rezultoi se shtetasi Maringlen Nikaj të ketë hyrë në lokalin "Bar Kafë" përballë shkollës "Avni Rustemi" Tiranë. Në nënin 202 të K.Pr.Penale përcaktohet se "Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale gjykatë merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose i banesës". Në mbështetje të dispozitës së mësipërme Gjykata çmon se ka arsye të bazuara për të dyshuar se në lokalin BAR-KAFE me adresë "Rr.Bogdaneve" tek kryeqzimi i shkollës "Avni Rustemi", godinë 3 katëshe përballë shkollës "Avni Rustemi" në katin e parë, Tiranë mund të ketë prova materiale të vlefshme për zbardhjen e rrethanave të procedimit penal nr.4742 i vitit 2011. Në këto rrethana, kryerja e kontrollit të ambienteve në lokalin BAR-KAFE me adresë "Rr.Bogdaneve" tek kryeqzimi i shkollës "Avni Rustemi", godinë 3 katëshe përballë shkollës "Avni Rustemi" në katin e parë ka për qëllim gjetjen e të dhënave të vlefshme për hetimin në lidhje me veprat penale për të cilën dyshohet se kanë kryer shtetasi Maringlen Nikaj dhe Qazim Hysko.

### LAJME SHKURT

**Kanosi gjyqtarët, arrestohet 57 vjeçari**  
Pak para mesnates së djeshme një 57 vjeçar nga qyteti i Vlorës u vu në prangat e policisë. Burime zyrtare nga policia e këtij qyteti thanë se i ndaluar është identifikuar si Jeton Demiraj. Nga ana e policisë thuhet se gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë, Demiraj ka kërcënuar 2 anëtarë të trupit gjyqësor të kësaj gjykate. Lidhur me këtë rast ndaj tij misërisht hetimet për veprën penale "Kanosja e gjyqtarit" dhe se momentalisht materialet hetimore rreth kësaj çështje i kanë kaluar prokurorisë së rrethit Vlorë.

**Tiranë, policit i grabisin pistoletën**  
Arma e detyrës i është vjedhur brenda në shtëpi një punonjësi të policisë së burgjeve së kryeqytetit. E po ashtu edhe një shumë parash. E gjitha kjo ka ndodhur në banesën e policit, një shtëpi përdhese në qytetin e Tiranës. Nga hetimet që kanë kryer kolegët e policit A.H.41 vjeç, me detyrë punonjësi i policisë Burgut 313, gjatë natës duke gdhirë ditë e djeshme, persona të paidentifikuar kanë hyrë në banesën e tij dhe i kanë marrë pistoletën e shërbimit, të llojit "TT", si dhe shumën prej 5000 lekësh. Policia tha se po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Ndërkohë që deri tani për këtë ngjarje nuk është arrestuar asnjë person i dyshuar.



## Ina Rama, padit shoqërinë "Etebest" për lekët e Tom Dedës

Kryeprokuroerja Ina Rama padit në gjykatën e Tiranës shoqërinë përbarimore "ETEBEST" Sh.p.k., pasi kjo e fundit i ka kërkuar dëmshpërblimin me 1 milion lekë të vjetra për çdo muaj të vitit të prokurorit të Matit Tom Deda, i shkarkuar dy vite më parë nga kryeprokuroerja Rama. Mësohet se Deda, ka fituar në Gjykatën e Lartë rikthimin në punë dhe se nëpërmjet

këtij vendimi ai kërkon të hyjë prokuror ose të paguhet për muajt e heqjes nga puna. Tom Deda nëpërmjet shoqërisë përbarimore të sipërcituar, kërkon lekët e muajve të heqjes nga puna dhe se për këtë gjë, mësohet se Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur një shumë fare të vogël, për shkak të mos pasjes lek në buxhetin e saj. Nisur nga këto kushte në 30 prill

kryeprokuroerja Ina Rama i është drejtuar me një padi civile gjykatës së Tiranës, duke kërkuar nga togat e zezë të kundërshtojnë veprimet përbarimore të shoqërisë "ETEBEST" Sh.p.k. I pyetur rreth këtij fakti prokurori Tom Deda është shprehur se kryeprokuroerja po shkel ligjin, pasi nuk po zbaton një vendim të detyrueshëm sic është vendimi i Gjykatës së Lartë.

### Lajmi

Dy persona janë varë brenda një familje, nga një 31 vjeçare e quajtur Manjola Dollapi. Kjo e fundit ka qëlluar me breshëri kallashnikovi, duke lënë të pajetë bashkëshortin e saj, shtetasit Eduart Dollapi dhe dashnorin e saj Kaçanik Gjuriqi. Pas krimit e reja është arrestuar nga policia në kushtet e flagrancës.

### TIRANE

ELTON QYNO

Krimi në familje këtë herë është regjistruar në qytetin e Tropojës, ku Manjola Dollapi ka qëlluar me kallashnikov mbi burrin dhe dashnoriduke i lënë që të dy të vdekur në vend. Viktimat janë Eduart Dollapi dhe Kaçanik Gjuriqi, të cilët janë gjendur nga policia e qytetit të dy të pajetë në ambientet e brendshme të shtëpisë. Sipas policisë ngjarje është regjistruar në orët e vona të mesnatës së djeshme, ku pas një përplasje fizike mes bashkëshortit të 31 vjeçares, shtetasit Eduart Dollapi dhe dashnorit të saj shtetasit Gjuriqi, Manjola Dollapi ka rëmbyer një armë zjarri të llojit automatik model 56 dhe ka qëlluar në drejtim të dy personave. Pas kryerjes së krimit 31 vjeçaria është larguar nga vendi i ngjarjes duke shkuar në polici, ku fillimisht ka denoncuar krimin si një grabitje me pasojë vdekjen e dy personave dhe më pas ka ndryshuar thëniet e saj para oficerëve të policisë duke treguar se autore e vrasjes së dyfishtë ishte vetë ajo. Pas kësaj dëshmie 31 vjeçari është arrestuar në kushtet e flagrancës dhe është izoluar në dhomat e paraburgimit në Tropojë.

### NGJARJA

Ngjarja e rëndë është rregjistruar në orën 02:45 të mesnatës së djeshme. Rreth kësaj ore në banesë është kthyer nga puna viktimja Eduart Dollapi, i cili sipas burimeve policore punonte me një forgon linjën Tropojë-Kukës-Kosovë. Ndërkohë që ai punonte, për të mbajtur familjen gruaja e tij, 31 vjeçaria Manjola Dollapi ka pasur kohën të krijonte një lidhje paralele duke zënë dashnor shtetasin Kaçanik Gjuriqi. Pikërisht gjatë natës së

# Tropojë, policia arreston 31-vjeçaren Manjola Dollapi

## Vrau dy në Tropojë gruaja: Ishte grabitje

### Gruaja vret Eduart Dollapi dhe Kaçanik Gjuriqin



Qyteti i Tropojës

djeshme, ky i fundit kishte shkuar në e dashura e tij për të kaluar natën pranë saj, por siç duket planet nuk dolën ashtu si ishin parashikuar. Teksa çifti i të dashuruarve qëndronte i qetë, në banesë është kthyer bashkëshorti i Manjolës. Sapo ai ka konstatuar praninë e një mashkulli tjetër brenda në shtëpinë e tij, ka rëmbyer një thikë duke tentuar të vrasë bashkëshortin, shtetasen Manjola Dollapi. Mirëpo ai

është ndaluar nga dashnorin i saj Kaçanik Gjuriqi, me të cilin filloi të përpalet fizikisht me grushta dhe të shahen rëndë njëri me tjetrin. Sipas burimeve pranë policisë së Tropojës në këtë kohë 31 vjeçaria ka shkuar në një nga ambientet e shtëpisë, ku nga ka marrë një automatik me të cilin ka qëlluar disa herë në drejtim të bashkëshortit dhe dashnorit të saj. Nga ndërtimi i dinamikës së ngjarjes, policia bëri me dije se

fillimisht 31 vjeçaria ka qëlluar me disa plumba burrin e saj, dhe pasi e ka parë të mbytur në gjak atë, ka qëlluar dhe në drejtim të dashnorit, duke i lënë që të dy të vdekur në vend.

### DENONCIMI PËR GRABITJE

Policia lokale e Tropojës, fillimisht ishte informuar për të shtënat në lagjen "Parizani" por më pas ka mësuar se fjala ishte për dy persona të vrarë me armë zjarri. Ndërkohë që pak orë pas krimit të dyfishtë, mësohet se shtetasja 31-vjeçare është vetëdorëzuar në polici dhe ka pranuar krimin. Por mësohet se para se të pranonte autorësinë e krimit, e

reja është paraqitur në komisarariat duke denoncuar për një grabitje me pasojë vdekjen e dy personave, por më pas këtë alibi Manjola Dollapi e ka rëzuar vetë. Ndërkohë që pas arrestimit të saj, një grup specialistësh të policisë kanë bërë dokumentimin e provave të gjetura në vendin e ngjarjes. Sipas policisë, brenda në shtëpi u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një automatik kallashnikov model 56, disa gëzhoja si dhe një thikë kuzhine. Pritet që brenda tre ditësh 31 vjeçaria të dalë para gjykatës së Tropojës për të njohur me masën e sigurisë "arrest me burg".

### LAJME SHKURT

**Grabiten turistët Çekë, 9 të shoqëruar**  
Nëntë persona janë shoqëruar nga policia e Kukësit në lidhje me grabitjen e turistëve çekë, ngjarje kjo e cila ka ndodhur natën e kaluar. Menjëherë pas kallëzimit të bërë nga turistët çekë, në vendngjarje kanë shkuar efektivet e Sektorit Kundër Krimëve të Rënda të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Kukës. Policia tha se ka kryer gjatë ditës disa kontrolle banesash të personave të dyshuar si autorë dhe u shoqëruar në ambientet e policisë 9 persona me karakteristika e moshë të ngjashme sipas përshkrimeve. Grabitja ka ndodhur në vendin e quajtur "Ura e Tejdritit", në komunën Ujmisht. Njoftohet nga policia se turistët kanë rënë pre e grabitjes në kohën kur po flinin në automjetin e tyre. Personat e armatosur u kanë marrë atyre sendet personale, celularë, aparate fotografike si dhe një sasi të konsiderueshme financiare.

**Kanos një person dhe i vjedh makinën të dashurës**  
Policia e Korçës deklaroi dje se ka vënë në pranga një shtetas të moshës 34-vjeçare nën akuzën e kanosjes me armë zjarri dhe vjedhjes. Nga të dhënat e para mësohet se ngjarja ka ndodhur në Korçë ku Lorenc Ademi për motive të dobëta ka kanosur me armë zjarri një shtetas me inicialet N.S. i moshës 21 vjeç dhe më pas ka vjedhur automjetin "Seat Ibiza" që ishte në pronësinë e një femre 38 vjeçare me të cilën autori bashkëjetonte.

### Ripyeten dëshmitarët

# Vrasja e Dodës, përgjim të dyshuarve

### TIRANE

Ende pa asnjë autor vrasja e 36 vjeçarit Nikolin Doda pranuarit të tavernës "San Marco" që ndodhet përballë prokurorisë së kryeqytetit. Hetimet e policisë dhe prokurorisë së Tiranës, janë përqëndruar rreth pjesëtarëve të një fisi në zonën e Laçit, ku 36 vjeçari Doda ka tentuar në vitin 1997 të vrasë njërin nga anëtarët e këtij fisi. Për gjatë ditës së djeshme grupi hetimor ka marrë në pyetje dhjetëra persona, mes të cilëve edhe disa nga familjarët dhe shokët e viktimit. Ata kanë treguar se Nikolin Doda nuk ka pasur konflikte dhe se gjithmonë ka qëndruar i lirë. Për dobi të hetimeve, janë marrë sërish në pyetje 6-të vajzat



Nikolin Doda

që ndodheshin në ambientet e brendshme të tavernës si dhe njëri nga policët privatë të prokurorisë së Tiranës, i cili sipas policit ka arritur të shohë makinën dhe personat që kanë qëlluar me armë. Por policit privat, s'ka mundur të bëjë dot identifikimin fizik të autorëve të krimit dhe për pasjë, policia vashdon të ketë vështirësi në zbardhjen e kësaj ngjarje, ku vrasjes së Dodës mbetet të plagosur dhe tre shtetas të tjerë me tyre edhe oficeri i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministri Uran Doda. Ndërkohë që për sigurimin e provave dhe zbardhjen sa më parë të ngjarjes, prokuroria e Tiranës ka autorizuar policinë të kryejë përgjimin e dhjetërave persona të cilët dyshohet se

kanë lidhje me krimin e rëndë. Ka qënë pikërisht ora 01:15 e natës, kur në zonën e Brakës, përballë prokurorisë së Tiranës janë dëgjuar breshëri kallashnikovi. Pikërisht në këtë orë, pranoi i tavernës "San Marco" i shoqëruar dhe nga tre të plagosurit, punonjësi i SHKB Uran Doda, dhe shtetasit Agron Doçi e Ilmi Meta kanë dalë nga ambientet e brendshme të tavernës, dhe po qëndronin në trotuar. Në këtë moment pranë tyre është afruar një automjet tip "Golf 4", ku prej andej për rreth 10 sekonda është qëlluar me armë zjarri tip kallashnikov. Si pasojë e kësaj goditje ka mbetur i vdekur 42 vjeçari Nikolin Doda dhe janë plagosur 3 personat që e shoqëronin.

# Abonohu!

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:  
*To Subscribe please contact:*

Agjensia e Abonimeve të Shtypit (TRENOVA)  
Tel: +355 682047825  
e-mail: arbentrenova@yahoo.com

POSTA SHQIPTARE  
Tel: +355 4 2375598  
e-mail: abonime@postashqiptare.al

ADRION Ltd  
Tel: +355 4 2240018  
e-mail: sales@adrionltd.com

*Ja si fillohet dita...*



[**SHQIPTARJA.com**]

origjina e lajmit...

# Aty ku zbulon spektaklet e natyrës

Bukuria natyrore e Osunit, ka ujëvara, dhe kanione unikale



# Adrenalina që falin lumenjtë

ROVENA RROZHANI

Ndërsa bora kishte mbuluar Berat në muajin shkurt, monotonia kishte përfshirë anëtarët e Rafting Albania Group. Por mjaftoi një shtytje dhe ja hera e parë në kanionet e Osunit jashtë sezonit. "Nuk e kishim provuar ndonjëherë në borë dhe po na mbyste bardhësia. Njerëz-



it sikur e ngadalësuan ritmin e tyre. Gjatë muajve kur nuk bëjmë rafting, të gjithë ne antarët e shoqatave rafting ndiejmë që na mungon adrenalina natyrore që jemi mësuar të marrim deri në katër herë në javë gjatë sezonit. Unë u bëra nxitësja duke i shtyrë që të shkonim. Ndalojmë tek "Gjurma e..."

# Fundjava

Suplementi i së premtes të SHQIPTARJA.com



ENADA HOXHA RREFEN PER RAPORTET E SAJ ME PARTNERIN NE JETE DHE NE SKENE

# "PA BALETIN NUK KA LUMTURI"

Mes skenës klasike dhe spektaklit televiziv, jeta dhe karriera e një balerine të vendosur për të arritur ëndrrat e saj

■ ■ ■ TIRANË

ROVENA RROZHANI

Balerina e parë e Teatrit të Operas dhe Baletit, për të paktën katër muaj në viti i jep ditëve të saj të punës një orar të shfrenuar, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Është koha kur së bashku me partnerin e saj në skenë dhe në jetë përkushohen për të realizuar formatin e spektaklit "Dancing with the stars", pa anashkaluar aspak kalendarin e shfaqjeve në Teatrin e Operas. Kështu vit pas viti, projekt pas projekti karriera dhe familja e Enadës dhe Gerdit ecin bashkë në një të njëjtën rrugë, drejt ëndrrave dhe ambicieve për të ardhmen.

Edicioni i tretë i Dancing, edicion i tretë i një sezoni tepër të ngarkuar pune ....



Sa herë që vjen kjo periudhë gjëja e parë që mendon është ngarkesa e madhe, orët e zgjatura. Fillon që në dhjetë të mëngjesit dhe mbaron në dhjetë të darkës. Ke të bësh me njerëz të ndryshëm në karaktere dhe edukatë, edhe pse ky edicion ka njerëz vërtet të këndshëm që vijnë

me shumë dëshirë dhe shikon ditaditës zhvillimin e tyre apo mënyrën sesi ata punojnë apo si e përcjellin në skenë. Gjithsesi lodhja është pafund. Gjëja e parë që më shqetëson është hedhja e materialit, pastaj të punohet me ta, tu tregohet stili i kërcimit dhe sesi ata duhet ta

përcjellin në publik. Ngarkesa tjetër është se përveç "Dancing..." jemi edhe në Teatrin e Operas, janë shfaqjet e shpeshta në teatër dhe familja që t'i lë pas. Gjithsesi mendohen e ke gjithë kohës çfarë bëhet në shtëpi, djali çfarë bën. Teksa flas me të në telefon më kërkon që t'i shkoj

sa më shpejt në shtëpi. Një ditë e ngarkuar me shumë ngarkesë fizike dhe mendore.

Arrin të gjesh kohë për gjithçka?

Unë edhe Gerdi e kemi pasion këtë punë... ► Vijnë në faqen 19



# Të pjekësh peshkun në kripë të aromatizuar



# Europa në celuloid falas në Tiranë

# Trëndafilat anglezë "përplasen" në skenë



## Dëshironi të udhëtoni?

**BUKURIA NATYRORE** e Osumit, që përgjatë rrjedhës së tij, formon kanione, ujëvara, shpella. Një monument I gjallë që më në fund shijohet nga turistët

# KANIONET E OSUMIT

## Të zbulosh spektaklet e natyrës

Magjia e kanioneve miliona vjeçare

Ndër pasuritë ujore dhe natyrore shqiptare bëjnë pjesë edhe kanionet. Prej disa vitesh tashmë ato janë jo vetëm një "zbulim" bukurish natyrore, por edhe një vend turistik që gjithnjë e më shumë është duke gjetur vend mes turistëve vendas dhe të huaj. Më të famshmit dhe më të eksploruarit mbeten kanionet e Osumit, të konsideruara si monumente të natyrës.

Kanionet e Osumit, kanë një gjatësi prej 26 km dhe ndodhen 450 m mbi nivelin e detit. Mendohet se ato janë formuar 2-3 milionë vite më parë nga erozioni i ujit që depërton thellë në tokë. Përgjatë gjithë grykës ka mjaft kalime nëntokësore dhe shpella të paeksploruar.

Në Kanionet e lumit Osum, ndodhen 6 ngushtica, ku kanioni në shtratin e lumit merr një ngushtësi deri në 1.5 m, ndërsa hapësira lart në sipërfaqe shkon deri në 35 m. Përveç tyre, te kanionet ndodhet Katedralja, Syri, Porta e Djallit... Shpatet e kanionit bien thikë me shtratin e lumit nga një lartësi prej 80 deri 100 metra dhe krijojnë një pamje fantastike. Kanioni ka një gjatësi prej 11 kilometrash në pjesën e tij të



Fotot nga Gent Shkullaku

**Në disa sektorë të tij shfaqen ujëvara të mëdha të cilat në ditë me diell japin një spektakël të jashtëzakonshëm**

pa ndërprerje, nga Vau i Grepckes deri në dalje të fshatit Blezencke.

Gërryerjet ndër vite i kanë dhënë formën e ngrëhinës natyrore të kultit. Në gjirin e këtij kanioni, që përshkohet nga lumi Osum, në të dy krahët e tij rrjedhin ujëvara nga fshatra të ndryshme, të cilat kalojnë në një sistem shkëmbor. Kanioni si origjinë, më i madhi në Shqipëri, është ndër me fantastikët në Europë, i karakterizuar kështu dhe nga studiuesit evropiane, gjeografë që kanë ardhur në zonë. Ky kanion ka bukurinë mahnitëse edhe për ekosistemin që ruan në vetvete, ku gjelberimi në të dy krahët gjatë shpateve të kanionit, është i përhershëm. Shkurra mesdhetare me bimësi si marja, shqopa etj me një botë të pasur të gjallë dhe peshq të kategorive nga më të ndryshme të ruajtura në themelet

### Kanë thënë për kanionet

#### Rudina Xhunga

"Sot njoha Kanionet e Osumit dhe u mrekullova".

#### Genc Pollo


"Dy here e kam mbajtur lart pafundesisht gjatë shikimit në jetën time. E para ka qenë gjatë vizites sime të pare në Neë York dhe takimit të pare me gratacelat atje dhe hera e dyte në Kanionet e Osumit, kryeveper e natyrës dhe bukuritë për njerëzimin".

#### Shpresa Becaj

"Zoti i ka dhuruar vendit tonë mrekulli të mahnitshme natyrore. Kur mendja e dora njerëzore vihet në shërbim për të perfeksionuar e njohur këto bukuritë mahnitëse, krijohet një harmoni midis hyjnore dhe njerëzores."

#### Eltar Deda

"Përvoja e paharrueshme dhe një fundjave që do mbahet mend gjatë. Kanionet e Osumit janë një thesar i Shqipërisë



Në foto: (Sipër) Genc Pollo ministër i Inovacionit (Majtas) kanionet e Osumit

e lumit Osum. Në muret vertikale të kanionit ka mjaft guva e zgavërime të formuara nga proceset e karstit. Midis tyre dallohet "Vrima e nuses", që ndodhet 800 m në afërsi të fshatit të Bigazit dhe që është një zgavër apo ndoshta një shpellë karstike në formën e një galerie me gjatësi 7 - 8 m dhe diametër rreth 2 m.

Në disa sektorë të tij shfaqen ujëvara të mëdha të cilat në ditë me diell japin një spektakël të jashtëzakonshëm. Kanioni i Osumit ka qenë thaujësi i pashfrytëzuar

për qëllime turistike deri në fillimin e viteve '90. Por qysh nga ajo kohe kanionin kanë nisur ta vizitojnë turistët të huaj. Një pamje e rrallë e kanionit mund të shihet dhe nga vetmja ure që ndodhet në te, në afërsi të fshatit Blezencke. Pikërisht aty është vendi me i ngushtë i kanionit dhe arrihet lartësia me e madhe nga shtatori i lumit. Në afërsi të fshatit Dhores mund të vizitosh dhe vendin e shenjtë për besimtarët bektashianë të zonës, pasi sipas legjendës aty gjendet "Gjurma e Imam Aliut".

### Turet

#### Maj-Qershor

Rafting në kanionet e Osumit

Mbërritja gjatë paradites në Berat. - Nisja drejt Kanioneve të Skraparit. Udhëtimi zgjat 1 orë e 30 min. Mbërritja në mes të kanioneve dhe përgatitja për të filluar aventurën. Poshtë ujëvarës blu gjithë grupi ha drekën. Aventura mes kanioneve zgjat 2,5-4 orë në varësi të nivelit të lumit. Paketa fillon 40 • / person - Rafting dhe dreka e paketuar.



#### Maj-Korrik

Eksplorim kanioni Skrapar

Gjate këtij udhëtimi nën shoqërimin e guides ARG, grupi përjeton aventura të ndryshme si ecje përgjatë shtratit të lumit mes shpateve të kanionit; not në pishinat natyrale të Osumit, ngjitje në disa nga shligjet e Kanionit. Gjatë ekspeditës shijohet një drekë e paketuar e marrë me vete nga Albania Rafting Group. Paketa fillon nga 25 • / person.



#### Korrik- Shtator

Rafting në lumin e Vjosës, Përmet

Rremtarët që duan të bëjnë një udhëtim rafting në lumin Vjosë duhet të mbërrin në mëngjes në qytetin e Përmetit. Ata do të lundrojnë me gomone në lumë, për rreth 2-4 orë. Pas ose gjatë udhëtimit grupi shijon një drekë të paketuar. Paketa fillon nga 45 • / person.



#### Mars - Nëntor

Rafting për fillestarë e fëmijë

Itinerari Corovodë - Jaupas, Berat. Skuadra takohet në Berat dhe grupi bashkohet për t'u nisur, me makinat tona drejt Corovodes. Para nisjes së aventurës grupi udhëzohet nga një "leksion" për të gjitha teknikat dhe truket e nevojshme për t'u përdorur gjatë rafting. Kjo paketë fillon nga 35 Euro/person.



Tel: 0672006621

## TREVIS TRAVEL & TOURS



TREVIS TRAVEL & TOURS

Rr. KAVAJES Pall.217 nr.16

tel: +355 450 7086

mobile: +355 67 20 21986

e-mail: trevis\_travel@live.com

saku.vojsava@hotmail.com

**TOUR NE BOSNJE**  
18-20 MAJ - 3 DITE 140 EURO

**HOTEL VIRGINIA**  
DATE 5-12 KORRIK

1000 EURO PER 2 PERSONA ALL INCLUSIVE

HOTELI ESHTË I KATEGORISE SUPERIORE RESORT NE NJE NGA ISHUTU ME TE BUKUR TE GREQISE RHODOS

## Dëshironi të udhëtoni?

ROVENA RROZHANI

Ndërsa bora kishte mbuluar Beratin në muajin shkurt, monotonia kishte përfshirë anëtarët e Rafting Albania Group. Por mjaftoi një shtytje dhe ja hera e parë në kanionet e Osumit jashtë sezonit. "Nuk e kishim provuar ndonjëherë në borë dhe po na mbyste bardhësia. Njerëzit sikur e ngadalësuan ritmin e tyre. Gjatë muajve kur nuk bëjmë rafting, të gjithë ne antarët e shoqatave rafting ndiejmë që na mungon adrenalina natyrale që jemi mësuar të marrim deri në katër herë në javë gjatë sezonit. Unë u bëra nxitësja duke i shtyrë që të shkonim. Ndalojmë tek "Gjurma e Abaz Aliut" dhe ne e re-

**Në maj e qershor bëhet rafting në kanionet e Osumit, ndërsa në korrik rafting spostohet në Vjosë**

spektojmë, sepse është një vend i shenjtë e po ashtu edhe të gjithë ata që kalojnë aty. Ndalojmë edhe tek "Vrima e Nuses". Aty ngaqë është vend i hapur edhe era uturinte. Të gjithë u stepën. Por u futëm dhe e provuam herën e parë në borë" kështu rrëfen Blerina Ago, sekretare e Federatës Shqiptare të Rafting të krijuar një vit më parë, që drejtohet nga Zamo Spahari. Rasti i tyre ishte kërkim i esktrëm i adrenalinit, ndërsa pranvera ka cecelur sezonin e eksportimit dhe argëtimin të rafting për të gjithë të pasionuarit dhe turistët, të cilët janë të shumtë pasi vitet e fundit ky sport është shndërruar në një trend edhe për tregun shqiptar. Në maj e qershor bëhet rafting në kanionet e Osumit, ndërsa kur niveli i ujit bie për shkak të vapës, nga korriku deri në shtator rafting spostohet në lumin e Vjosës në Përmet. "E duam Vjosën sepse mban më gjatë si sezon ngaqë lumi ka më shumë prurje, por ka edhe një natyrë shumë të bukur e njerëz mikpritës"- thotë Blerina.

Ajo nuk e konsideron rafting një sport ekstrem dhe as çështje muskujsh por teknike dhe stili. "Do ta quaja sport aventurë, sport në natyrë, dhe në Shqipëri është rafting turizëm. Ne nuk kemi gradën e gjashtë të ushtrimit të këtij sporti në vend. Arrijmë deri në gradën e tretë si Osumi, si Vjosa" thotë Blerina e cila bën krahasimet mes dy vendeve.

# Rafting, adrenalina që falin lumenjtë

## Të ndjesh emocionet e një udhëtimit unik



### Propozimi

Federata i ka kërkuar shtetit shqiptar që cdo turist të presë një biletë simbolike për mjedisin. Këto fonde simbolike do të investohen në mbrojtje të natyrës.

Lumi i Osumit nuk ka dallësi si Vjosa. Kjo e fundit ka më shumë adrenalinit, dhe njerëzit kur janë atje thonë se pikërisht aty është adrenalina ekstreme, por Osumi ka një rrugë që je i detyruar të ndjekësh sepse është i ngushtë. Aty krijohet ndonjë vorbull e padukshme për turistët, dhe nëse je pa guidë profesioniste atëherë mund të bllokohesh. Ka një rast të shënuar në kronikën e medias, dhe pikërisht antarët e federatës së rafting ia kanë dalë mbanë t'i nxjerrin nga vështirësia. Këtu Blerina thekson se nuk ka arsye për frikë, por vetëm për kujdes dhe përgjegjësi. Asnjëherë nuk duhet bërë rafting pa guidë të vërtetë. Federata e Rafting bën dy herë në vit inspektim të terrenit pasi lumi ndryshon cdo ditë. Madje për herë të parë nga në fund të majit do të organizohen kurset e trajnimit profesional të cilat mbështeten nga Programi Rritje Albanie pranë USAID. Këto kurse do të zgjasin dy javë dhe javën e praktikës në terren do

ta asistojnë mjeshtrot italianë për të qenë plotësisht në përputhje me përvojën e huaj. Këto kurse duam t'i bëjmë të hapur për të gjithë publikun."shpjegon Blerina Ago. Nisur nga përvoja e shteteve të tjera edhe në Shqipëri turistët e huaj duhet të shoqërohen nga guidat shqiptare, profesionale. Në asnjë shtet nuk lejohet të bësh rafting pa guidë të njohur nga stafi. Kjo shmang incidentet e pakëndshme dhe që dëmtojnë njerëzit e turizmit.

### TË GJITHË PËR RAFTING

Pjesë e rafting janë bërë të gjithë, diplomatë të huaj, politikanë, artistë, fotografë, përfaqësues të senatit amerikan e mjaft njerëz të njohur, të cilët

## Vajza e dashuruar me rafting

Blerina Ago është e para vajzë që praktikon rafting, prej moshës 14 vjeçare. Emocionet e para të saj nga rafting ishin rrahje të forta zemre, dridhje këmbësh. Por më pas fundjavat që nuk ka shkuar në lumë, kanë qenë të pakta. Ajo është juriste në profesion, por në gomonen e rafting ajo është krah i djathtë i guidës profesionale, remon dhe asiston. Tashmë edhe ajo ka ambicien për tu bërë një guidë profesionale. Nëse do të marrë provimin...pse jo të jetë e para guidë profesionale femër... e ndoshta në krahun e saj të djathtë mund të jetë një maskull....


**PRANVERA** i hap rrugë fundjavave në lumenjtë Osum, Vjosë dhe Devoll, në kërkim të një turizmi në natyrë dhe një sporti që po shndërrohet në trend

## Rafting

### Biznesi

Argëtim në grup

Të gjithë që hipin në gomone për të eksploruar kanionet duhet të punojnë bashkë. Femra apo meshkuj qofshin. Madje Blerina tregon se fillimisht meshkujt vendosën në pozicionet më të rëndësishme, por më pas femrat



kanë treguar shumë sedër. Aq sa kanë zënë vendet e djemve. Ata mendojnë si të punojnë bashkë, sepse kompanitë e huaja sjellin punëtorët e tyre për të forcur punën në grup.

### Edukimi

Sport për fëmijë

Rafting Junior bëhet për të zhvilluar edukatën e marrjes me sport edhe tek fëmijët. Ka fëmijë të moshave të ndryshme, të cilët vijjnë zakonisht në fundjavë. Për ta është zgjedhur rafting për të gjithë, një itineraer nga Corovoda



deri në Berat, kryesisht 18-20 kilometra. Ato kanë dallë, por kanë një nivel të ulët vështirësie, shumë e përshatshme për fëmijët, të cilët hyjnë me veshjet e posacme. Albania Rafting ka pasur shumë kërkesa edhe nga rrethet e ndryshme të Shqipërisë.

## Flamuri ynë në rafting botëror

Më shtator të këtij viti federata shqiptare do të ngrejë flamurin në Ceki, ku do të zhvillohet kampioniati botëror i rafting. Ndërkohë Federata Shqiptare e Rafting pretendon që në vitin 2013 të zhvillojë kampionatin kombëtar italian në Shqipëri. Blerina shpjegon se presidentin e federatës italiane e kanë ccur në kanionet e Osumit, ku e shëtiten për një kohë shumë të gjatë. "Prisim reagimin e tij dhe ishim në ankh. Por ai filloi të thoshte "Ju nuk e dini që këni një thesar", u lehtësuam. Gjatë qëndrimit të tij, presidenti u shpreh se duhet bërë dicka më konkrete që kapërcen letrat. Do përipiqem dhe do punojmë që të sjellim kampionatin italian"-sqaron Ago. Të paktën 70 shoqata aderojnë në federatën italiane, të cilat marrin pjesë në kampionat. Por ftohen edhe shoqata të tjera nga bota.

kur hipin në gomone janë si të gjithë, madje zhvishen nga luksi i jetës së përditshme. Dikush edhe i ka zhgënjyer përkohësisht. "Na kanë zhgënjyer deri sa nuk janë futur në kanion. Rruga nuk është e mirë dhe duke mos qenë një njeri sportiv, krijohet një situatë e sikletshme. Por kur hyjnë aty brenda ndërrojnë mendim. Nuk ka një njeri të vetëm që të mos i pëlqejë kanionet"-thotë Blerina, e cila kujton edhe rastin e një turisteje 70-vjeçare nga Holanda, e cila ishte e shëndoshe dhe jo shumë sportive. Në fund të udhëtimit, tha: "la futa jetës. Këtë gjë duhet ta kisha bërë që kur isha 18 vjeç por atëherë nuk kisha mundësi dhe e bëra tani". Ndërsa një grup të rinjsh nga Suedia gjatë gjithë rrugës, u acaruan nga plehrat, kushtet, dhe ishin shumë të vrenjtur. Por kur hynë në kanion filluan të thoshin se kjo ishte Shqipëria dhe ishte e bukur. Pas këtij rasti, është momenti për të komentuar me Blerinën se natyra jonë është perlë, por njerëzit janë shumë hapa më pas. Por ushtruesit e rafting janë optimistë dhe përipiqen të ndikojnë sa mundet tek instancat qeveritare për mjedisin rrotull kanioneve plot bukuri natyrore. Blerina tregon: "Kanionet e Skraparit janë më të mëdhatë. Ne bëjmë 14 kilometrat më të bukur, që janë të gjelbëruar, shikon përbërje shkëmbore, habitesh çfarë ka bërë natyra, ndërsa grackat nuk i kupton turisti."

## INFOTRAVEL AGENCY

Rr. Asim Zeneli, Pall. I ri, Tirana; Tel/fax: +355 4 2260836; E-mail: infotravelalb@gmail.com; Web: www.infotravel-alb.com

## HOTEL QUEEN 4\* BUDVA

### Çmimi 166 euro/çift

( i vlefshëm per gjithe muajin MAJ)

- 2 nete me mengjes dhe darke (akomodim ne dhome 2-shë).
- Darka e pare ne forme bufete ne restorantin "Show kitchen" .
- Darka e dyte ne Restorant i A carte restaurant "Lokanda"
- Perdorimi i Saunes, pishines dhe fitnesit.
- 30% zbritje ne te gjitha llojet e masazheve.
- Check out i vonë .
- Parkimi
- Taksat e turistit

### FEMIJET DERI NE 10 VJEÇ NE DHOME ME PRINDERIT JANE FALAS

FEMIJET NGA 10 DERI NE 18 VJEÇ

ME PRINDERIT NE DHOME PAGUAJNE 50 EURO/

FEMJUE + 1 EURO/DITE/FEMIJE TAKSE TURISTI

Personi i trete ne dhome paguan

64 euro + 1,5 euro/dite per takse turisti.

Perdorimi tek i dhomes eshte

120 euro + 1,5 euro/nata per takse turisti.

## Dëshiron të shkosh në kinema?

**FESTIVALI I FILMIT** European dhe prodhimet më të fundit hollivudiane ofrojnë një fundjavë të pasur me filma

# Produksionet më të mira të viteve të fundit, nga dhjetë shtete të Bashkimit European Europa në celuloid falas në Tiranë

Dy filma europianë në ditë me hyrje të lirë për publikun e gjerë deri në datën 8 maj

Për datën 2 maj Festivali European i Filmit sjell në ekranin e madh të Millennium, disa nga prodhimet më të më fundit dhe më të mira të kinematografisë europiane. Gjatë fundjavës do të shfaqen me hyrje të lirë, gjashtë filma në orët 18.00 dhe 20.30. filmi i parë për ditën e premte është "Guinness" i regjisorit Alexis Kardaras. Po gjatë të premtes do të shfaqet edhe filmi belg "The Intruder". Trilleri misterioz është drejtuar nga Frank van Mechelen dhe tregon historinë e Tom Vansant një fizikant nga Brukseli i cili vihet në kërkim të vajzës së tij, të larguar nga shtëpia dhe të humbur prej 18 muajsh. Të

shtunën do të shfaqen "Attack the Block", një prodhim anglez i vitit 2011. Në historinë e tij ai shënon 13 çmime dhe 22 nominime, përfshirë edhe nominimin për Bafta. Komedia horror, tregon për një adoleshent anglez që përpiqet të mbrojë lagjen e tij nga një pushtim alienësh. Filmi është shkruar dhe drejtuar nga Joe Cornish ndërsa në rolet kryesore luajnë John Boyega, Jodie Whittaker dhe Alex Esmail. Natyrisht që mbremja e të shtunës dhuron për publikun një projektion të veçantë të filmit italian "Vincere", pasi do të jetë i pranishëm edhe regjisorit Marco Bellocchio. Filmi është një rrëfim biografik dhe dramatik i të



dashurës sekrete të Musolin-it, Ida Dalsler, dhe djalit të tyre Albino. Në rolet kryesore luajnë Giovanna Mezzogiorno, Filippo Timi dhe Fausto Russo Alesi. Ndërsa të dielën do të projektohen "Sonny Boy" dhe "Tales from the golden age". I pari rrëfen një histori të pamundur dashurie, bazuar në një ndodhi të vërtetë dhe ka fituar një çmim dhe tre nominime në festivale. Regjia e filmit është nga Maria Peters. Ndërsa "Tales from the golden age" sjell në ekranin e madh disa nga legendat urbane të Rumanisë komuniste. Drejtuar nga Hanno Höfer filmi ka për protagonistë Diana Cavallioti, Radu Iacoban dhe Vlad Ivanov.

### PROGRAMET E KINEMASE

#### NE FUNDJAVE



#### Filmat në sallë

Festivali European  
(Në 18:00 dhe në 20:30)  
"Man on a ledge"  
(Vetëm paradite)

#### Orari dhe Çmimet

**Filmi 2D**  
ora 10:30 – 300 lekë  
ora 13:00 – 300 lekë  
ora 15:30 – 500 lekë  
ora 18:00 – 500 lekë  
ora 20:30 – 500 lekë  
ora 23:00 – 500 lekë

**Filmi 3D**  
ora 10:30 – 500 lekë  
ora 13:00 – 500 lekë  
ora 15:30 – 700 lekë  
ora 18:00 – 700 lekë  
ora 20:30 – 700 lekë  
ora 23:00 – 700 lekë

#### NE FUNDJAVE



#### Filmat në salla

"The Lucky One"  
(Në të gjitha oraret e tjerë)

The Grey  
(Ora 13:00, 15:00, 22:00)

#### Orari dhe Çmimet

ora 13:00 – 500 lekë  
**Qendra Kristal**  
ora 18:00 – 500 lekë  
**Qendra Kristal**  
ora 12:30 – 500 lekë AGIMI  
ora 17:30 – 500 lekë AGIMI  
ora 20:00 – 500 lekë AGIMI  
ora 22:00 – 500 lekë AGIMI

## Mashtrimi i Sam Worthington



Në zemër të Manhattanit, duke ngritur sytë drejt qiellit dikush sheh Nick Cassidy, teksa ndodhet në parvazin e një hoteli në katin e 23 – të tij. Burri kërcënon se do të hidhet dhe menjëherë policia vihet në lëvizje. Rruga mbyllet për trafikun, mbërrijnë televizionet për të xhiruar dhe për të dhënë lajmin e fundit, turma qëndon e palëvizur ndërsa e kaluara e Nick fillon të zbardhet në media. Edhe ai ka qenë një polic. Dy vjet më parë përdunoi në burg për një krim që nuk e kishin kryer. Ai është gati që të pastrojë imazhin e tij dhe në rastin më të parë, arratiset nga burgu dhe shpërfaq një plan të

### SKEDA E FILMIT

**Titulli:** "Man on the ledge"  
**Regjia:** Asger Leth  
**Skenari:** Pablo F. Fenjves  
**Aktorë:** Sam Worthington, Elizabeth Banks, Jamie Bell  
**Kohëzgjatja:** 102 min  
**Gjinia:** krim/Triller

dëshpëruar që e con në parvazin e një hoteli të lartë. Është atje për të hedhur kartmonedha për njerëzit duke u shndërruar kështu në një "hero" popullor, të dashur nga turma që deri para pak minutash priste të shikonte "spektaklin" e hedhjes. Por ndërsa policia vazhdon hetimet dhe përpjekjet vetëm një psik-

ologe beson tek pafajësia e tij Nick. Ajo bëhet negociatore e policisë, që ta shpëtojë. Por nuk e di se në të njëjtin kohë vëllai i Nick është vetëm një hap larg kryerjes më të madhe të vjedhjes së diamanteve në të gjithë historinë... Kjo është historia e trillerit "Man on a ledge" që fillon projektionet prej datës 4 maj në kinema Millennium.

## Të shpëtosh nga një foto

Logan Thibault, është një marini që i ka mbijetuar tre misioneve në Irak. Këtë fat ai ia dedikon një fotografie gruaja të cilën nuk e ka takuar kurrë, por që e mban gjithnjë me vete. Pasi kthehet në shtëpinë e tij, në Karolinën e Veriut, marini fillon të kërkojë gruan misterioze. Pas shumë mundimesh gjen Beth dhe fillon të ketë një marrëdhënie pa treguar aspak

### SKEDA E FILMIT

**Titulli:** The Lucky One  
**Regjia:** Scott Hicks  
**Aktorë:** Zac Efron, Taylor Schilling, Blythe Danner  
**Gjinia:** Dramë  
**Kohëzgjatja:** 101 minuta

historinë e fotos së saj në frontin e luftës. Një foto mes rrënojave që lënë shpërthimet e bombave dhe me shkrim domethënës "Ruaj veten!"

Fillon kështu një dramë e formë me ngjyrimet romantike që vë bashkë patriotizmin dhe dashurinë. Filmi është drejtuar nga regjisorit Scott

Hicks, dhe është një përshatje e bestsellerit me të njëjtin titull të Nicholas Sparks, autor i njohur "Notebook" dhe "Dear John". Në rolin e marinsit është aktori Zac Efron ndërsa Beth, gruaja shpëtimtare interpretohet nga aktorja Taylor Schilling. "The Lucky one" mbërrin në kinema vetëm një javë pas premierës botërore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës



## Dëshiron të ndjekësh një spektakël?

**HENRI VI** Drama historike e Ulliam Shekspir është shkruar përfaqësisht mes viteve 1588-1592

# Trëndafilat anglezë “përplasen” në skenë

Shfaqet sonte premiera e “Henri VI”

Premiera më e rëndësishme e sezonit të Teatrit Kombëtar finalizon sonte në mbrëmje pritjen e gjatë të “Henri VI”, pjesa e dytë e trilogjisë shekspiriane. Vepra e ngjitur në skenë nga regjisor Adonis Filipi, është pritur me padurim nga publiku shqiptar për vetë faktin se me këtë shfaqje, Teatri Kombëtar do të shkojë në Festivalin Shekspirian duke u bërë pjesë e performancave teatrorë nga e gjithë bota. Këtu të parët do të jenë spektatorët shqiptarë që do të shijojnë premierën absolute dhe do të shuajnë kureshtjen mbi konceptin regjisorial të veprës, për të cilën regjisor është shprehur se rri me klasikes dhe modernes, mbi lojën e aktorëve dhe shumë komponentëve të tjerë të shfaqjes.

### KOHË E VËSHITARA TË HENRI VI

“Këto janë kohë të vështira, virytet janë mbytur nga ambicidet dhe mirësia është zbur nga zemërimi; joshja ndaj të keqes mbizotëron dhe drejtësia nuk ka më vend”. Këto janë disa nga fjalët që Shekspiri i ka vënë në gojën e Dukës Gloucester, vetëm pak para se të arrestohet. Peshë e tyre vjen në kohë ashtu si e gjithë drama historike, jo vetëm si një kujtim ndaj kësaj pene të fuqishme të letërsisë botërore, por edhe si një apel vërtetësisht, koherence që karakterizon veprat e mëdha. Sepse kostumet mund të ndryshojnë, emrat, vendet, por qenia njerëzore e pësh-tjelluar nga dëshira për pushtet mbetet dhe ndikon në shohëri e sisteme me të gjitha futitë. Ashtu sic ndodhi me mbreti Henri VI. Pjesa e dytë e trilogjisë, fillon me martesën e mbretit me princeshën Margaret të Anzhisë. Henri VI është



Foto nga provat gjenerale të Henri VI



shumë i ri në moshë dhe shumëkush në oborr mundohet ta joshë për të qënë sa më pranë kurorës. Eilliam de la Poli, Konti i Safolkut, synon të ndikojë tek mbreti nëpërmjet mbretëreshës së re. Pengesë për këtë plan është regjenti i kurorës, Hamfri, Duka i Gloucester, i cili gëzon popullaritet më të

gjithë mbretërinë. Mbretëresha Margaret, për ta goditur në këtë pikë të fortë të tij, nis intrigat ndaj gruas së Hamfrit, Eleanor, Duke e parë si rivalen e vetme për fronin, mbretëresha bën gjithshka është e mundur që Eleanor të shihet si e përfshirë në magji dhe të dënohet. Shumë shpejt fisnikëria angleze ndahet në kampe dhe betejat e Shën Albanit është ajo që do të vendosë për fatin e kurorës. Kështu fillon lufta 100 vjeçare midis Trendafilave të Anglisë.

### 23 AKTORË PËR 67 PERSONAZHE

Një kastë e gjerë aktorësh angazhohen në këtë shfaqje ku shihen plot 23 aktorë në skenë të brezave të ndryshëm të cilët duhet të mbulojnë

### Trilogjia ballkanike

Henri VI” Vepra historike e Shekspir, ka marrë një dimension të ri falë “Globus Theater” dhe Festivalit Botëror të Shekspir, në kuadër të Lojërave Olimpke 2012. Tashmë të gjithë e njohin si “Trilogjia ballkanike” pasi të treja pjesët i janë dhënë tre trupave ballkanike, shqiptare, serbe dhe maqedone. Teatri Kombëtar i Beogradit, me regji të Nikita Mihajlovic, do të interpretojë në serbisht pjesën e parë ai më 11 dhe 13 maj. Shfaqjet e trupës sonë do të jenë më 12 dhe 13 maj. Ndërsa Teatri Kombëtar i Bitolës me regjisorin amerikan John Blondell, do të interpretojë pjesën e fundit të trilogjisë, më datat 12 dhe 13 maj. Vënia pranë e pranë në këtë triptik shekspirian që evokon luftën civile dhe përplasjen mes ideologjive, të cilat sipas organizatorëve janë të freskëta në kujtesën e tre shtetave të Ballkanit. Megjithatë do të jenë edhe dy trupa të tjera që do të sjellin Henrin shekspirian. Trupa kombëtare e Meksiko Siti do të sjellë pjesën e parë të trilogjisë ndërsa trupa e Buenos Airesit, pjesën e dytë.

### 67 PERSONAZHE. Kështu Henri VI interpretohet nga Indrit Çobani, Mbretëresha Margaret nga Mira Hysaj, Jack Cade vjen nën interpretimin e Bujar Asqeriu, ndërsa Yllka Mujo sjell Dukeshën Eleanor. Gloucester realizohet nga Krista Skrami dhe Duka i Yorkut vjen nga Vasjan Lami. Duka i Safolkut i përket Dritan Boricit, ndërsa ai i Buckingham, Ahmet Pashës. Rolet e tjera janë Neritan Lica, Naun Shundi, Fatos Sela, Ervin Bejleri, Arben Derhemi, Mehdi Malka, Gjergj Mena, Sokol Angjeli, Roland Saro, Marjana Kondi, Fadil Kujfosa, Anil Frashëri, Florian Kokona, Marsela Lena dhe Gladiola Harizaj.

### SHPUA E FILIPT PËR HENRI

Jo vetëm kasti i aktorëve, por një staf i gjerë artistësh përfshihen në realizimin e një shfaqjeje. Në këtë rast skenografia i është besuar Genc Shkodranit, konsumet, Anila Zajmi Katanoli ndërsa koreografia e huaj Georgia Maddamma është marrë me lëvizjet e aktorëve. Muzika gjithaq e rëndësishme vjen nga Armand Broshka ndërsa solist dhe njëherazi i përfshirë si një aktor është klarinetisti i njohur Fatos Qerimaj. Vepra shekspiriane ka ardhur në shqip falë përkthimit të Shpresa Qatipit dhe Piro Tankut.

## Premiera

# Të ëndërrosh në papafingon e Metropolit

Tri çifte; nga të cilët; një çift me probleme vëmendjeje ndaj njëri-tjetrit, një çift me problem tradhëtie bashkëshortore dhe një çift që nuk e njohin më njëri-tjetrin dhe dy personazhe, njëra “rob” i teknologjisë dhe tjetra aspirante për t’u bërë këngëtare. Këta personazhe i japin startin premierës “Ëndrra në papafingo” e cila shfaqet këtë fundjavë në Teatrin Metropol. Në këtë komedi, të drejtuar nga regjisor Erion Isai janë përzierë të gjitha zhanret dramaturgjike, si

monologu, dialogu, absurdi, gjuha e trupit, performanca, muzika, si dhe forma më moderne e interpretimit “stand up”. Kjo komedi ka një ritëm të shpejtë, duke i zbrëthyer situatat e batutit në një temporitëm që publikun do ta bëjë të gjejë veten, të qeshë me personazhet por edhe me veten atje ku ai do të gjejë pasqyrën e vetes tek personazhet e komedisë. Por sigurisht ajo që do të mbizotërojë do të jetë e qeshura. Shfaqja tenton të thyjë tabutë; si në “sitat” e fjalorit skenik,

ashtu edhe në disa figura “të paprekshme”.

Personazhet janë interpretuar nga aktorët Natasha Sela, Kastriot Rramollari, Albana Sançolli, Ajlin Petrela, Lorenc Kaja, Denis Kurushi, Olta Çali dhe Klesta Shero. Sipas regjisorit këto personazhe vijnë me një stil të veçantë, pasi shpeshherë dalin nga lëkura e tyre dhe tregojnë qëndrimin e tyre personal si aktor. “Ata kulmojnë me karakteret gjeniale të Shekspir. Aty ku një marangoz, një ëndës, një

ndreqës gjyrykësh, një rrobaqepës etj, mblidhen për të krijuar një tragjedi, atë të Piramid dhe Tizbës. Kjo ëndërr e tyre e madhe për të “shokuar” publikun me një tragjedi rrëqethëse duke mos ditur se si bëhet i bën ata superkomik”, thotë regjisor. Një pikë tjetër e fortë është përfshirja që i bëjnë aktorët publikut. Në këtë shfaqje publiku jo vetëm do shijojë lojën e aktorëve por shpesh do të bëhen pjesë e kësaj komedie nëpërmjet aktorëve në situatat që ata kanë.

## JETA ARTISTIKE

4-5-6 MAJ



**Teatri Kombëtar**  
“Henri VI”

Autor: Ulliam Shekspir  
Regjia: Adonis Filipi  
Aktorë: Indrit Çobani, Emira Hysaj,  
Ora: 20.00  
Çmimi: 500 lekë

Pas kompleteve në oborrin mbretëror fisnikëria angleze ndahet në kampe dhe betejat e Shën Albanit është ajo që do të vendosë për fatin e kurorës. Kështu fillon lufta 100 vjeçare e Trendafilave të Anglisë

4-5-6 MAJ



**Galeria Kombëtare e Arteve**  
“Shqipëria fantastike”

Autor: Ibrahim Kodra  
Kurator: Rubens Shima  
Ora: 10.00 - 18.00  
Çmimi: 200 lekë/100 lekë

Piktura të mbledhura nga koleksioni i Fondacionit “Ibrahim Kodra” në Milano vepra nga koleksioni i Z. Kozma Dashi vepra nga fondi i GKA, si dhe vepra nga koleksione te ndryshme private.

5-6 MAJ



**Teatri Kombëtar i Komedisë**  
“Familja në shi”

Regjia: Ilir Bezhani  
Aktorë: Xhevahir Zeneli, Xhemil Tagani, Andon Qesari, Genc Fuga  
Ora: 19.00  
Çmimi: 400 lekë

Ngjarja vërtitet rreth një shkrimtari e familjes së tij, i cili i gjendur përpara domosdoshmërisë së një operacioni, zhytet në borxhe. Për të dalë nga halli mendon të inskenojë rrëmbimin e fëmijës së doktorit.

4 MAJ



**Universiteti i Arteve**  
Orkestra Simfonike e RTSH

Dijrgjent: Czeslaw Grabowski  
Solist: Klejda Tare  
Ora: 19.00  
Hyrja e lirë

Koncerti sjell pjesë nga kompozitorët enjohur Kilar Rrahmaninov dhe Beethoven në interpretimin e pianistes Klejda Tare dhe drejtimin artistik David Tukiçit

## Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

Luga  
e argjendte

Receta nga Dhurata Thanasi

# Të pjekësh peshkun në kripë të aromatizuar

Mirëdita të gjithë lexuesve të Luges së Argjendte! Para se t'ju uroj fundjavë të këndshme dua t'ju ofroj një recetë tejet të shijshme, të shpejtë dhe shumë të thjeshtë për tu gatuar në fundjavë. E kam fjalën për gatimin në kripë të aromatizuar. Kjo mënyrë gatimi, sipas një peshkatori pugliez, është përdorur kaherë nga peshkatarët të cilët në det e sipër, në mungesë zjarri, enësh kuzhine e mbi të gjitha urije, e gatuanin peshkun e gjuajtur në kushtet që u lejonte ambientin. Peshku aromatizohej me ndonjë erëz dhe vendosej në një shtrat kripe, mbulohej mirë po me kripë dhe lihej në orë të tëra në diell. Kripa në kontakt me diellin shërbente si "furrë" dhe piqte peshkun, duke i ruajtur të gjitha vlerat ushqyese dhe aromën unike. Asnjë lloj gatimi tjetër i peshkut, duke filluar që nga ai në avull, i zier, tiganisur, në zgarë apo në tavë nuk i ruan vlerat sa gatimi i peshkut në kripë. Gatimi në kripë është një ndër më të shëndetshmit, për sa i përket ruajtjes së vlerave, ushqyese, kripërave minerale dhe vitaminave. Unë në familjen time e aplikoj shpesh dhe sidomos kur ftoj miq, pasi është një gatim që nuk të lodh dhe në të njëjtën kohë bën një figurë të mrekullueshme të kripës apo të ftuarit. Mishi që përftohet nga gatimi është shumë i shijshëm dhe më lëng. Mos u "merroni" nga sasia e kripës! Ajo ngjizet dhe pasi është pjekur del si bllok dhe nuk influencon kripësinë e peshkut, mishit apo pulës.

PËRGATITJA E KRIPËS

## Këshilla

# Truket për këpucë të reja

Një palë këpucë kamoshi nuk mungojnë asnjëherë në garderobë. Janë të bukura, por sa mund duhet që të mbahen të pastra dhe të reja. Këpucët e lëkurës apo të kamoshit janë tepër delikate dhe pastrimi i tyre shpesh kërkon duar ekspertësh. Ja disa truke për t'ia dalë mbanë me këpucët tuaja.

## HEQJA E NJOLLA

Nëse ndotja është në sipërfaqe, përdor tul buke, të cilën e kalon mbi njollën e kuqëzës për të hequr pisllëkun. Kur njolla është e fortë, atëherë shkurdini pluhurin këpucës, pastaj me një pambuk të njomur në qumësht fërkojeji pak dhe në fund shplajeni. Në rastin e një njolle shumë të vështirë, kaloni një sfungjer të



## Përbërës

**Për kripën e aromatizuar**  
 1 degë rozmarinë e fresket  
 2 gjethe dafine  
 2 thelpj hudhër(sipas dëshirës)  
 2 qese kripë të jodizuara (e rekomandoj pasi ka lageshtinë e detit)  
 1 peshk 1.5 kg( levrek, kocë, salmon ose troftë lumi)  
 vaj ulliri ekstra i virgjër  
 Feta limoni,

## Ë AROMATIZUAR

Merrni erëzat dhe thelpijtë e hudhrës dhe bluajini për 2 min në mikser. Rozmarinë hiqini degën mesore dhe merrni vetëm gjethe. Masa që del përzihet në mënyrë të njëtrajtshme me kripën kokërtrashë dhe në këtë mënyrë është përfutur kripë të aromatizuar.


## PËRGATITJA E TAVËS

Në një tavë shtroni letër kuzhine (kalk), ku të jenë mbuluar mirë buzët e tavës. Hidhni një shtresë kripë në gjatësinë e peshkut që do të gatuani. Vendosni peshkun e pastruar mirë, sidomos në pjesën e brendëshme. Personalisht nuk e mbush me asgjë, sidomos limon, pasi peshku i freskët, hidhërohet në pjekje e sipër. Pasi e keni mbuluar dhe ngjeshur mirë e mirë me kripë, në mënyrë që të mos duket asnjë sipërfaqe e peshkut, vendosni në furrë që është nxehur 10 minuta më parë në temperaturën 200 gradë C për 40 min. Pasi hiqet nga furra, peshku lihet rreth 5 minuta të pushojë dhe me anë të një thike çlirohet nga kripa dhe pjesë pjesë ndahet në pjatat përkatëse.



## Teknika e gatimit

### Me çfarë shoqërohet peshku



Kjo lloj gateshe shoqërohet vetëm me vaj ulliri të rrahur me lëng limoni të shtrydhur dhe pak piper të zi dhe pak majdanaz, të cilën e hedhim mbi peshk sipas dëshirës. Peshku mund të shoqërohet me zarzavate të pjekura, kunguj, patëllxhane, spërkatur me të njëjtin lëng limoni ose vetëm vaj ulliri apo thull balsamike. Zarzavatet të pjekura mund tu hidhet lëngu i vajit ullirit me limon ose thull balsamike me farra susami. Zarzavatet marrin një gusto sublime!

**Vila 12**

Cdo të premte Lounge Bar, me gime 200L Lounge Drink, Cdo të shtunë Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela  
 Cdo ditë një menu e pasur me gatime shtëpie dhe italiane.  
 Cdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpie, dhe një pije.  
 Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

**RUGA "MUSTAFA MATOHITI",  
 PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA**  
**Cel. 0696070651**

**TË PJEKËSH** në kripë të aromatizuar, të mësosh të mbash në formë këpucët e lëkurës dhe të kamoshit

## PROGRAMACIONET E FILM TV

### SOT



20:00 Emisioni "Fiks Fare"  
 20:50 Top-Fest 9 Gjysëmfinale



20:10 Skuadra e re pj 41  
 21:00 Emisioni "Zonë e lirë"



19:55 "Jetë e dyfishtë" pj.85  
 21:00 Emisioni "Debat"



21:30 Pse u martova? Komedi  
 21:00 Mundësia e vetme Aksion

### E SHTUNË



20:45 Emisioni "Pop Channel"  
 20:45 "Big Brother 5" reality show



20:05 "Skuadra e re" pj.42 serial  
 20:55 "Ezel" pj.69-70



20:00 "Mos e beso po deshe"  
 21:00 "Histori Dashurie"



21:00 Pengjet Hits  
 23:30 George Shore, pj 1 Plus

### E DIEL



20:17 "Exclusive" dokumentar  
 21:00 Show Portokalli



20:10 "Anatomia e Greit" pj.105  
 21:00 X Factor Albania



19:45 "Dancing with the stars" forum  
 20:45 "Sketch show" sezoni i ri



21:00 "Burlesque" Hits  
 23:30 Zoçka e bardhë Komedi

## Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

**MES SKENËS** klasike dhe spektaklit televiziv, jeta dhe karriera e një balerine të vendosur për të arritur ambiciet dhe ëndrrat

Balerina rrëfen për raportet e saj me partnerin në jetë dhe në skenë

ROVENA RROZHANI

vijon nga faqja 13

...dhe kush e bën me shumë dashuri e gjen kohën për gjithçka.

**Të dy në një punë, në një profesion, kaq vite bashkë, kudo...**

Unë jam mësuar dhe e kam kërkuar këtë gjë. Gjithmonë mendoja për njeriun e jetës sime që do të ishte më mirë ta kisha në profesion, sepse duke dashur kaq shumë profesionin nuk do të më kishte kuptuar njeri tjetër kaq shumë. Kurse kështu kuptohemi.

**Sa harmoni keni në punë?**

Ka edhe harmoni, por edhe debate të forta. Gerdi ka një natyrë që nuk toleron, ndërsa unë jam bërë shumë tolerante për sa i përket punës që bëjmë qoftë në çift, qoftë në grup. Ose kur ai thotë: "Shiko Enadë se ajo që the nuk mendoj se do godasë shumë..." unë e kundërshtoj dhe aty fillon një debat tjetër, por gjithsesi kjo ka sjellë edhe rezultatin, sepse punët e përbashkëta kanë edhe harmoninë edhe debatin brenda. Por harmonia në familje është pa diskutim.

**Kur bëni debate harrojnë që jeni bashkëshortë?**

Ndoshta Gerdi ka filluar ta harrojë këtë, duke qenë që jam bërë shumë tolerante. Nuk e kam harruar dhe mundohem që atë debat ta bëj me zë të ulët, kurse Gerdi ka filluar të bëhet më gjaknxehtë dhe flet me zë të lartë dhe kjo mua ka filluar të më të bëjë të mos ndihem mirë. Por sigurisht që vjen falja direkt pas kësaj, duke më thënë: "Ti kuptoje që jemi në momente pune dhe ndonjëherë ka edhe ngritje zëri".

**Çfarë vendi zë shtëpia?**

Gjërat e lëna pas i ka rregulluar mami i Gerdit. Ne kur shkojmë gjejmë rehatin e shtëpisë, ku ha diçka, merresh me djalin dhe është një kohë shumë e shkurtër. Kur arrin në orën 12 të natës nuk ke as kohë të flasësh, apo të hapësh një bisedë familjare. Edhe ajo koha me djalin kur unë luaja me të, është reduktuar, thjesht një bashkëbisedim me të, dëshira për të qëndruar pranë e ta puthësh. Por tani është duke u rritur dhe nuk është më ai djali i vogël që e mbaje në prehër dhe e mbysje me të puthura, por edhe ai lëviz, ka dëshirë e veta. Gëzimi më i madh është kur ti shkon dhe ai të thotë "Je mami më e mirë në botë!" ose kur ke ndryshuar

Nga ditët e gjata të punës, tek ngrohtësia familjare

look, të thotë: "Sa e mirë që je bërë moj mami!" Janë fjalë pa fund, "Je drita, dashuria, shpirti im" dhe këto bëjnë që gjithë atë lodhje të madhe gjatë ditës e harron kur je pranë tij.

**Dashuria ndryshon në kohë?**

Dashuria piqet, nuk besoj se ka ndryshuar. Unë kam të njëjtat ndjenja, edhe Gerdi po kështu. Ka mbetur po ajo

**Një prind që alternon edhe punën edhe familjen gjithmonë ka një boshllëk... unë mbetem e pakënaqur që nuk jam pranë djalit gjithë ditën**

dashuri, sigurisht që është bërë më e ngrohtë, krahas dashurisë bëhesh edhe shoqe, edhe shumë e lidhur... nuk gjej dot fjalën e duhur. Ka mbetur po ajo dashuri, por është zhvilluar, është bërë më e madhe, më e gjërë. Dhe kur futet në mes edhe Roan, bëhet shumë shumë e madhe. Kjo të bën të ndihesh mirë me veten dhe me njëri-tjetrin

**Ka plane zgjerimi të familjes?**

Dëshira është, por puna e ngarkuar nuk të favorizon për këtë gjë. Sepse nga një projekt vjen një tjetër. Kur ti këto projekte i ke ëndërruar kaq shumë dhe një moment që ti mendon se duhet të sjellësh një fëmijë tjetër në jetë, atëherë ti thua u prish dhe ajo kalaja që ti ke ndërtuar shembet e tëra, nuk bie një gur, por e tëra. Të kesh fëmijë do të thotë të mos i përkushtohesh më vetes tënde, por atij, sepse vetëm ashtu mendoj që je një prind ideal. Një prind që alternon edhe punën edhe familjen gjithmonë ka një boshllëk, sado që ti vërtet mund të jesh esencë në atë një orë që rri, por unë mbetem e pakënaqur që nuk jam pranë djalit gjithë ditën, edhe pse ai një pjesë të



Enada dhe Gerd Vaso në baletin "Znizel"

lumturi më të madhe se të kesh një familje solide. Do të thoja që kjo është një lumturi më vete që ma gëzon jetën pa masë, por kur një gjë nuk shkon në balet ose nuk jam e kënaqur me veten, me punën që po bëhet, unë e kam një vuajtje të madhe, nuk jam e lumtur. Nëse mua më shikon të lumtur, unë jam lodhur, kam bërë një punë shumë të mirë, ose lodhja e madhe që shikon atëherë është lumturi e madhe, atëherë unë vërtet kam bërë diçka, kur nuk bëj gjë, jam e mërzitur. Në tërësi në vendin tonë, ndodh që ka punë të ngjeshur dhe pastaj nuk ka fare. Kjo është ajo që më mërzit.

**Si soliste dhe koreografe, si i mendon vitet e ardhshme?**

Ajo që kam ëndërruar dhe që ëndërrroj është që të vazhdoj si balerinë e parë e teatrit, për shumë vite me radhë të jem protagoniste në baletet që do të vihen... kjo është ëndrra ime. Për sa i përket koreografisë, vërtet kam bërë një shkollë dhe kam pasur eksperienca të ndryshme, qoftë edhe me punë të mira që kanë rezultuar të sukseshme, do të më pëlqente që t'i bëja të dyja, pa lënë njërin ose tjetrin. Sigurisht do zoti që të jem mirë në formë, do të doja sa më larg që unë të lija profesionin tim si balerinë. Sigurisht që e ardhmja do të jetë koreografia, por më vjen shumë mirë që unë krijoh dhe kërcë pjesët e mia. Ambicia ime nuk janë krijimet e vogla. "Dancing..." është një spektakël gjigand ku ti tregon aftësitë e tua, sepse nuk është e lehtë. Sfida ime më vete, bashkë me Gerdin. Dua që të afirmohem si koreografe, kjo ka qenë ëndrra ime. Të jem koreografe e Teatrit të Operas dhe Baletit, krahas Agron Alisë. Ai, për fat të keq, është në këtë gjendje të rëndë dhe do të doja që pse jo edhe unë edhe Gerdi të ishim pasardhës të denjë t'i. Duke sjellë vepra të bukura dhe në ëndrrat e mia do të doja të kisha të paktën një balet në vit. Po luftoj të bëj një gjë të tillë në sezonin e ardhshëm.

**djali juaj do të shkojë drejt artit**

Unë atë do të doja, por atij i pëlqen edhe sporti. Pastaj nëse do të krijohë ndonjë pasion tjetër t'ia lëmë kohës. Unë do të doja shumë të ishte me artin. Unë do të filloj ta angazhoj në kurse sportive jo sepse jam nga ato mamatë që dua ta ngarkoj. Gjithë halli im është që duke qenë se është djalë, dua t'ia ngarkoj ditën, që

kur të vijë një moshë, të mos e ketë mendjen të jetë gjithë kohën jashtë me shokët, por të ketë vetëm një kohë të kufizuar me ta, duke qenë se dita i mbushet me sporte të ndryshme, atëherë ai nuk do të ketë as kohën dhe as fuqinë.

**Enada dhe baleti përgjithmonë bashkë?**

Bashkë. Pa baletin nuk ka lumturi. Do të thoni ju ku ka

ditës e kalon në kopësht, një pjesë me gjyshen e tij, luan, shkruan, mëson vjersha, pikturon...Fakti që unë nuk i përjetoj këto gjëra bashkë me të, e quaj mungesë dhe fakti që ai në darkë kur shkoj të shtrihem me të, më thotë, "Gjumë të ëmbël mami, më ke munguar shumë" aty kuptohet që çdo gjë...

Vërtet kohë e sotme ka ardhur që ti ke nevojë të bësh dy-tre punë që të përbalosh jetën, por unë mendoj se edhe prindërit tanë kanë qenë në punë dhe unë i kam ndjerë afër. Ata kanë qenë tetë orë në punë, ndërsa puna jonë është më e gjatë, sigurisht është me sezone, por që aktivitetet gjithmonë të bëjnë të mos jesh prezent. Unë jam munduar që në çdo aktivitet ta marr me vete, gjatë provave apo shfaqjes, thjesht për të qenë me të. Në pushime mundohem të jem padiskutim me të. Edhe kur kam punë jashtë mundohem ta marr me vete. Doja dhe dua që derisa ai të mbushë 18 vjeç, të jem shumë prezent që pastaj jem e qetë në rrugën që do të marrë.

**Ëndrrat për të ardhmen janë pafund, si fëmijë artistësh mendohet se**



Enada dhe Gerd Vaso me djalin e tyre Roan



# Intervista

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Një nga romanet më të njohur të letër... sisë shqipe, "Atentat në PARIS", i shkrimtarit Skifter Këlliçi, vjen në botimin e dytë i ripunuar. Botimi i parë i përkiste periudhës së realizmit socialist, i shkruar në kushtet dhe trysinë e ideologjisë së kohës, madje i censuruar, ku nuk janë lejuar të botohen fragmente e personazhe të ndryshme. Ky roman me një univers të madh ngjarjesh, që lëvizin nga Italia në Francë, nga Franca në Shqipëri e deri në Greqi, Turqi e Serbi, të cilat lidhen vetëm me një enigmë, "Pse e vrau Avni Rustemi Esat Pashë Toptanit?!", është mjaft mbresëlënëse me portretizimet që u janë bërë të gjithë personazheve të veprës, aktorëve politikë e mediaticë të kohës. Shkrimtari rrëfen tashmë këtë bashkëjetesë të historisë me frymëzimin letrar dhe qëndrimin e tij ndaj idesë për rehabilitimin e figurës së Esat Pashë Toptanit.

**Në romanin tuaj "Atentat në Paris", një vend të rëndësishëm ka zënë portretizimi i Esat Pashës. Cili është Esat Pasha sipas jush?**

-Esat Pasha është ai që përshkruhet nga historiografia shqiptare që në fillimet e saj, duke përfshirë edhe studimet e periudhës paskomuniste, deri në ditët tona: "Veprimtar politik që punoi kundër interesave kombëtare. Si komandant i forcave rezerviste Shqipërisë së Mesme që luftonin për mbrojtjen e Shkodrës, (1912-13), pas vrasjes së pabesë të komandantit Hasan Riza Pasha, organizuar prej tij, ua dorëzoi qytetin malazezëve. . . Më 1913-n ngjiti në Durrës Pleqësinë që u kundërvu qeverisë së përkohshme të Vlorës. . . Më 1914-n u përball me kryengritjen që nisi kundër tij. I rrethuar në Durrës për afro shtatë muajsh prej kryengritësve, shpëtoi falë ndërhyrjes së ushtrisë serbe që pushtoi Shqipërinë e Mesme. Në verë të vitit 1915 nënshkroi një marrëveshje me qeverinë e Beogradit në dëm të pavarësisë politike të Shqipërisë dhe tërësisë territoriale të shtetit shqiptar. Prej vitit 1916 vijoi veprimtarinë në mërgim, duke u vetëshpallur si përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Versajë. U vra me atentat nga Avni Rustemi në Paris më 13 qershor". (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 2008, vëll. 3, faqe 2728-29).

**Në cilat arkiva e keni zbuluar se Esat Pasha ishte mbrojtës i interesave të Serbisë, siç aludohet në veprën?**

-Fakte të tilla nuk i kam gjetur unë, por studiuesit që janë marrë me këtë problem, që nga akademik Kristo Frashëri, profesorët Muin Cami, Gazmend Shpuza, Hysen Kordha, Ana Lalaj dhe deri tek studiuesi kosovar Sheredin Berisha, që kohët e fundit ka botuar studimin e gjatë me titull "Veprimtaria antikombëtare e Esat Pashë Toptanit (1912-1920)".

**Mund të përmendi disa nga këto fakte?**

-Për shembull, në marrëveshjen midis Pashiqit (kryeministër i Serbisë) dhe Esat Pashë Toptanit, më 17 shtator të vitit 1914, të nënshkruar në Nish, në mesin 7 vjet në dukje se "në emër të miqësisë së përjetshme" Toptani dhe Pashiqi kanë rënë në ujdj për doganën e përbashkët ndaj vendeve të tjera si dhe për mjetet e përbashkëta të komunikacionit. Sipas studiuesi Sheredin Berisha duken qartë synimet e hapura të Serbisë për aneksimin e Shqipërisë, që i miratonte pa ngurrim Esat Pashë Toptanit). Shembull tjetër: Pas pushtimit të Shqipërisë së Mesme nga forcat serbe bëhen bisedime midis Mishkoviçit, përfaqësues i komandës ushtarake serbe dhe Esat Pashës, ku ky i fundit kërkon:

"Neni 1. Që nëpunësit të jenë formalisht, kurse serbët të marrin qeverisjen dhe ven-



Më foto: (majtas) Shkrimtari Skifter Këlliçi (djathtas) Avni Rustemi



## Këlliçi: Si reagan mediat

**Dy gazetarët francezë janë personazhe reale. Në kohën e diktaturës m'i zhdukën nga romani**

dosjen e rregullit; në Elbasan prefekti të emërohet njeri i Esatit, por punët t'i kryejë njeri i caktuar Serbisë.

Neni 2. Në Tiranë kajmekami do të emërohet nga Esat Pasha, kurse punët do t'i kryejë një njeri i Serbisë ("Po kështu në Çermenikë, Qukës etj.)

Ja disa nene të marrëveshjes Toptani-Jovanoviç, më 27 qershor 1918:

Neni 4. Ekselencia e tij, Esat Pashë Toptani, do të fillojë menjëherë organizimin e ushtrisë dhe xhandarmërisë. Për udhëheqjen dhe instruktimin e ushtrisë qeveria serbe do të verë në dispozicion njerëz të vet, si dhe një numër të konsiderueshëm xhandarësh.

Neni 7. Sa të zgjidhet princ, Esat Pasha do t'i paraqesë Asamblesë projekt-kushtetutën e Shqipërisë. Pasi Asambleja të aprovojë kushtetutën, Esat Pasha do të formojë qeverinë nga njerëz që përkrahin idenë e bashkimit serbo-shqiptar"

A nuk të kujtojnë nënën e mësipërme të këtyre marrëveshjeve, pazarrilëqet që bënte edhe Enver Hoxha me Titon në vitet 1945-48, që e shndërronin Shqipërinë në republikë të shtatë të Jugosllavisë?

**Pse mendoni se Francës i interesonte të kishte marrëdhënie të mira me Esat Pashën?**

-Pas Luftës së Madhe, më 1918-n (kështu quhej atëherë Lufta e Parë Botërore), e cila përfundoi me fitoren e Antantës, (Francë, Angli, Rusi, etj), Esat Pasha me 600 ushtarë u bashkua me ushtrinë franceze në Frontin e Lindjes me qendër në Selanik. Për shkak të qëndrimeve të tij ndaj çështjes shqiptare, ai nuk mund të kthehej në Shqipëri. Madje studiuesi Sheredin Berisha në studimin e tij "Ve-

primtaria antikombëtare e Esat Pashë Toptanit, (1912 -1920)", vë në dukje:

"Sipas ushtarakut De Fontenej, Esati humbi çdo shpeshë për t'u kthyer në Shqipëri, sepse, siç u shpreh troç, lidhjet e tij me Serbinë kishin kaluar çdo kufi të bashkëpunimit të sinqertë". Kështu ai u vendos në Paris, ku u mbajt si aleat, paguhet me shuma marramendëse nga shteti francez. Madje, për t'u zbavitur, ndonëse i martuar, e ndihmuan të kishte edhe një të dashur 22 -vjeçare, të quajtur Lizetë Dyfur. Synimi ishte që Esat Pasha të kthehej në krye të Shqipërisë. Por Kongresi i Durrësit (dhjetor 1918) dhe sidomos Kongresi i Lushnjës (janar 1920), nga ku doli edhe qeveria e cila u vendos në Tiranë, i preu çdo shpeshë Esat Pashës, Francës dhe Serbisë që ai të kthehej në Shqipëri.

### Burimet e romanit

U bazova në dosjen hetimore të Avni Rustemit dhe njoftimet e gazetave rreth jehonës së atentatit. Gazetari i "Lë Pëti Parizienit", Gaston Rishar, që ka mbrojtur në procesin gjyqësor Avni Rustemin dhe ka demaskuar në shtyp Esat Pashën, si dhe Rene Puoja i "Lë Tanit" që bën të kundërtën, janë personazhe të vërteta

**Grupimi në pikëpamje pro dhe kundër mbrojtjes së Avni Rustemit i gazetarëve dhe avokatëve francezë, me ç'qëllim është bërë nga ju?**

-Që të nxjerr artistikisht në pah të vërtetën, pra duke u bazuar në dosjen hetimore të Avni Rustemit dhe njoftimet e gazetave rreth jehonës së atentatit dhe procesit gjyqësor në fund të nëntorit dhe fillim të dhjetorit të vitit 1920. Si pasojë, gazetari i "Lë Pëti Parizienit", Gaston Rishar, që ka mbrojtur në procesin gjyqësor Avni Rustemin dhe ka demaskuar në shtyp Esat Pashën, si dhe Rene Puoja i "Lë Tanit" që bën të kundërtën, janë personazhe të vërteta, ndonëse janë trajtuar artistikisht.

**Cili ishte në të vërtetë Avni Rustemi, vrasësi i Toptanit?**

-Një djalosh atdhetar që, pavarësisht se e

mbrojt veten në gjyq me tezën se e vrau Esat Pashën pa paramendim, se duke u përballur me të në hyrje të hotelit "Kontinental", lexoi "në ballin e tij mizoritë që ky pasha kishte kryer në Shqipëri, dhe i pushtuar nga një ndjenje urrejtjeje, nuk u përmbajti, nxori revolvërin dhe qëlloi", e dinte se do të dënohej me vdekje, siç kërkoi prokuroria deri në castin e fundit të këtij procesi. Akt me të vërtetë i rrallë pas një atentati gjithashtu të rrallë, ku ndryshe nga atentatorët e tjerë që njeh historia, qëlloi dhe nuk kërkoi të largohej, gjë që kishte mundësi ta bënte, por qëndroi, në mënyrë që në gjyq të demaskonte Esat Pashën, siç ndodhi në fakt, dhe e detyroi jurinë që të jepte vendim për ta liruar, sepse kishte vrarë një tradhtar të atdheut të vet.

**Krugu i Avni Rustemit nga Shqipëria në Paris, është ashtu siç përshkruhet në roman?**

-Po, nga Tirana, ku merr përsipër të shkojë në Paris, për të vrarë Esat Pashën, (edhe sot nuk dihet nëse është bërë një takim i fshehtë, kush mori pjesë në të, kush e ngarkoi me këtë detyrë, kush i dha paratë për udhëtimin dhe qëndrimin në kryeqytetin francez. . .), pra nga Tirana shkon në Romë, u shpjegon shokëve bashkëstudentë se po udhën për në Paris për të ndjekur kurse pedagogjje. Dhe kur kthehet përsëri në Romë, kur shokët e pyesin se përse nuk u kishte treguar të vërtetën, Avniu përgjigjet se kurrë nuk mund t'u zbulonte një të fshehtë të tillë. Madje, deri sa u vra nga njerëzit e Zogut, më 1924, ai nuk tregoi asgjë rreth këtij atentati. Kanë mbetur vetëm ato fakte dhe ngjarje që ka deponuar në hetuesi dhe gjyq, pra pak a shumë është ashtu siç i kam përshkruar unë në roman.

**A mund të pohojmë se historianët nuk e kanë zgjidhur ende çështjen e rolit historik të Esat Pashë Toptanit, dhe pse ju guxat të shkruarit për një temë kaq komplekse?**

-Historianët, duke u mbështetur në citimet nga Fjalori Enciklopedik, botim i vitit 2008, për mendimin tim, e kanë zgjidhur këtë problem. Mund të shtoj këtu edhe shprehjen e nxjerrë nga zëri "Toptanët" të kësaj enciklopedie, të shkruar nga akademik Kristo Frashëri, që është njohësi më i mirë i historisë së Tiranës, në të cilin ai vë në dukje se një degë e përfaqësuesve të kësaj familjeje me tradita



Në foto: Esat Pashë Toptani (djathtë) Vepra e ribotuar "Atentat në Paris" e Skifter Këlliçi



# franceze për vrasjen e Esad Pashës

Nëse bëhet rehabilitimi i figurës së Esad Pashës? Ju them ku ta kërkonti

atdhetare, përfaqësohej nga Abdi, Murat, Refik Toptani dhe vazhdon: "Dega tjetër nuk u shkëput nga disa mendësi feudale, anadollake. Pijnjoll më negativ i kësaj dege ishte Gani Toptani, i cili ka kryer zullume, vrasje, plaçkitje jo të pakta në fshatrat e Tiranës; vëllai i tij, Esat pashë Toptani, i cili arriti deri në shkallën e gjeneralit të ushtrisë perandorake osmane, u vra më 1920 me atentat nga Avni Rustemi për veprimtari tradhtarë, ndaj atdheut të vet" (faqe 2728).

**Jeni pro, apo kundër zërave që duan të rehabilitohet figura e Esad Pashës?**

-Si pasardhës i një familjeje të vjetër tiranase: gjyshi im, Masar Këlliçi, ish-deputet i Parlamentit të parë shqiptar, 1920-'24), larguar pastaj nga jeta politike si kundërshtar i Ahmet Zogut; vëllai i tij, Mytesin Këlliçi, një nga atdhetarët që ngritën më 20 nëntor të vitit 1912 flamurin kombëtar, aty ku sot ndodhet selia e Bibliotekës së vjetër Kombëtare, në rrugën e Elbasanit dhe pastaj senator në Kongresin e Lushnjës, si nipi i publicistit Reshat Këlliçi pse jo, do të doja që edhe Esat pashë Toptani të rehabilitohej dhe emri i tij të renditej krahas toptanasve të tjerë atdhetarë. Por faktet historike që përmenda më sipër, mjerisht dëshmojnë për të kundërtën.

**Mendon se këta zëra pro rehabilitimit të Esad Pashës kanë zbuluar fakte të reja historike?**

-Mundet. Nuk do të ishte as rasti i parë dhe as i fundit. Historia e Shqipërisë është minierë ende për t'u eksploruar. Nga arkivat "mund të dalin" fakte që dëshmojnë se Esat Pasha nuk e tradhtoi Ismail Qemalin, se nuk ua dorëzoi malazezve Shkodrën, se nuk vrau pas shpine Hasan Riza Pashën, se nuk cenonte Pavarësinë e Shqipërisë, se marrëveshjet me Serbinë që e kthenin vendin tonë në koloni të saj nuk janë të vërteta, etj, etj. Por kur tërë popullit shqiptar mbështeste Kongresin e Lushnjës, pra, kur ky kongres përcaktonte kufijtë e Shqipërisë që kemi sot (për fat të keq, pa Kosovën, Çamërinë dhe vise të tjera shqiptare në Malin e Zi), si mund të justifikohen veprimet e Esat Pashë Toptanit, i cili, që nga Parisi, duke gjetur mbështetjeje e Francës dhe të Serbisë, vetëqubej kryeministër i Shqipërisë, me një qeveri kullull të përbërë nga Pal Terka, ministër i Jashtëm dhe Gjergj Goga sekretar? Jo vetën kaq, por si mund të justifikohen veprimet e tij për të rrëzuar me çdo kusht

qeverinë e Tiranës, duke dalë kështu kundër vullnetit të popullit shqiptar që e mbështeti dhe e mbrojti atë? Cdo gjë që shkruhet në roman zbulohet në arkiva. Pas atentatit të Avni Rustemit në vendin tonë u bë festë, gazeta franceze iu dërguan telegrame ku kërkohet me këmbëngulje lirim i Avni Rustemit. Në shumë qytete të Shqipërisë u organizuan mitingje në mbrojtje të tij, populli krijoi për Avni Rustem kengë si "O Avni Rustem Marina, /Shkove burra, shkove trima, /Qëllove si vetëtima, /Si vetëtima qëlllove, /Esat Pashën ç'e rrëzove, /Shqipërinë ç'e shpëtove"? Personalitetet franceze

## Esat Toptani

**Në Paris u mbajti si aleat, u pagua me shuma marramendëse nga shteti francez. Macje për t'u zbvatur, ndonëse i martuar, e ndihmuan të kishte edhe një të dashur 22-vjeçare, të quajtur Lizetë Dyfur. Synimi ishte të kthehej në krye të Shqipërisë. Kongresi i Durrësit dhe sidomos Kongresi i Lushnjës nga ku doli edhe qeveria e Tiranës, u preu atyre shpresat**

që u prit në Vlorë, pas kthimit nga Parisi, si hero, përse Esat Pasha mbeti i harruar fill pas vrasjes? Përse? Përse?!

**Ju i keni renditur disa fakte të tilla në romanin "Atentat në Paris".**

-Dhe tani po rendis fakte të tjera historike që dihen dhe që zbulojnë veprimtarinë anti-kombëtare të Esat Pashës në vitin 1920. Esat Pasha bëri ç'është e mundur të rrëzonte qeverinë e Tiranës, të kryesuar nga Sulejman bej Delvina. Për këtë, veç të tjerash, dëshmon edhe Eqrem bej Vlora në librin e tij në dy vëllime me kujtime, botuar vitet e fundit:

"Menjëherë pas formimit të qeverisë së Ti-

ranës, shkruan ai, të gjitha krahinat shqiptare e njohën autoritetin e saj. . . Ndërkaq, Esat Pashë Toptani me banim në Paris, u dha urdhër njerëzve të tij në Shqipërinë e Mesme që të mblihdeshin dhe kur të vinte rasti, të rrëzonin qeverinë. Përballë këtij rreziku të ri, qeveria. . . u përpoq t'i bindte me të mirë esatistët se përmbysja me dhunë e qeverisë do të rrizonte dëshirat dhe nepsë e fqinjëve për të rrëmbyer troje shqiptare dhe kjo mund të ishte rrezik i madh për ekzistencën e Shqipërisë se re". (faqe 163 e veprës së cituar). Më pas Eqrem bej Vlora shkruan se qeveria e Tiranës

dërgoi në Paris një delegacion të kryesuar nga Fuat bej Toptani, për të biseduar me Esat Pashën, por esatistët, siç vë në dukje ai: "zgjeruan lëvizjen e tyre në të gjithë Shqipërinë e Mesme, duke vënë në mes Tiranën" (Po aty), etj.

Në ndihmë të këtyre pohimeve të Eqrem bej Vlorës na vënë edhe pohimet e mëposhtme të akademikut Kristo Frashëri. Në një takim që kam pasur me të në pranverë të vitit 1974, kur shkruaja romanin "Atentat në Paris", ai më kujtonte:

"Bandat e Esat Toptanit, me Osman Balin në krye, në ditët e para të qershorit të vitit 1920, sillëshin në kodrat rreth Kishës së Shën Prokopit dhe pritnin një urdhër nga Esat Pasha që të pushtonin Tiranën dhe të rrëzonin qeverinë. Atëherë kryeministri Sulejman Delvina iu lut Mytesin Këlliçit, myftiu i Tiranës, që të hynte në bisedime me ta dhe t'u kërkonte që të mos shkaktonin gjakderdhje, "sepse kjo qeveri i kishte ditët e pakta". Dhe ata i besuan myftiut si njeri i perëndisë. Por ndërkohë ishte njoftuar urgjentisht Bajram Curri me trimat e tij që ia behën në Tiranë shpartalluan bandat e Osman Balit dhe dogjën

dhe kullat e Esat Toptanit. Pikërisht ato ditë edhe Avni Rustemi vrau Esat Pashën dhe lëvizja esatiste mori fund."

**Ju në faqet e romanit shkruani se atentati i Avni Rustemit pati jehonë në shtypin francez dhe botëror. Vërtetë?**

-Sigurisht, sepse Esat pasha cilësohej nga Franca zyrtare si Kryeministër i Shqipërisë. Kjo e detyroi delegacionin shqiptar në Konferencën e Paqes në Versajë, të përbërë nga Mehmet Konica dhe Mithat Frashëri, të bënte këtë deklaratë:

"Zyra e shtypit shqiptar është e autorizuar të deklarojë se Esat pasha nuk kishte asnjë funksion zyrtar, për më tepër nuk ka qenë kryetar i shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes, siç e kanë quajtur shumë gazeta franceze. Të gjitha të drejtat e popullit shqiptar i mbrojnë delegacioni i qeverisë së ligjshme të zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës, që ndodhet prej kohësh në Paris" (Gazeta "Ymanite", 20 qershor 1920).

Veç kësaj Mithat Frashëri në një artikull të botuar në Paris më 1920, midis të tjerash shkruan kështu për Esat Pashën:

"Esat Pasha u bë foleja drejt se cilës rrodhi gjithçka që mund të kishte te keq në Shqipëri: tradhti, konservatorizëm, ambicie, lakmim, frikë prej dritës dhe së mirës. Ai u bë qendra e të gjithë atyre që ndiqnin një qëllim kundër Shqipërisë. Fuqia e tij vinte sa prej shkaqesh të brendshme, aq edhe prej rrethanave të jashtme. Mbi intrigat që kishte lidhur me Serbinë dhe Malin e Zi, pa vonuar shumë u shtuan edhe ato me Greqinë. (Mithat Frashëri "Kush është Esati pasha", "Chi e quel Esat?", Paris 1920, cituar sipas studimit "Veprimtaria anti-kombëtare e Esat Pashës, (1912-1920)", nga Sheredin Berisha, në internet).

**Cili ka qenë rrugëtimi në vite i romanit tuaj "Atentat në Paris"?**

U botua më 1978-n, në 15 mijë kopje që zhdukën në pak ditë, mbase edhe nga titulli sensacional, por unë pas disa muajsh, pavarësisht se u vlerësua nga lexuesit, kuptova që kishte disa të meta të rëndësishme. Me ripunimet që i bëra më 1989, 2005 dhe 2011, mendoj se ky roman, i ribotuar nga Ombrë GVG, me botues Gëzim Tafën, të cilit i jam mirënjohës, do të mbetet në letërsinë shqiptare si vepër e mirë më temë historike.



# Big Brother 5

**BISEDA** Gerta thotë se i është dukur shumë çudi në momentin që ka hyrë në shtëpinë e BB, e mendimi që kishte krijuar që jashtë për ta, ka ndryshuar rrënjësisht. Françeska e pyet se çfarë mendimi ka pasur Gerta për të e ajo përgjigjet se ajo i është dukur pasive e koketë nga jashtë,

## TIRANE

### SUADA DACI

Duket se dy bjondet e shtëpisë së Big Brother Albania, Gerta dhe Françeska, i kanë sheshuar mosmarrëveshjet mes tyre. I kemi parë të qëndrojnë shumë afër e të bisedojnë me njëra-tjetrën, ndryshe nga disa javë më parë, që kanë debatuar ashpër mes tyre. Edhe pse nuk bëjnë pjesë në të njëjtin "grup" brenda shtëpisë, dy vajzat vlonjate janë përpjekur të njihen dhe të dinë më shumë për njëra-tjetrën.

Gerta e Françeska qëndrojnë në oborr duke biseduar për lojën në BB. Së bashku me Eriomin, ata flasin për hyrjen e Klaujdës që ka qenë e papritur e ajo nuk ka takuar asnjërin prej banorëve në momentet e para. Gerta thotë: "Po sikur të hyjë një banor i ri tani?" e Françeska përgjigjet se po të hyjë, do të thotë që do të shkente automatisht në finale, çka nuk do të ishte e drejtë, e nga ana tjetër nuk duhet të pretendojë për të fituar. Gerta thotë se nuk është e thënë që ata që kanë hyrë jo që në fillim, nuk janë pretendent për të fituar, duke përfshirë dhe veten. Françeska shprehet se këta persona kanë avantazh karshi të tjerëve, pasi i njohin që jashtë e Gerta thotë se kjo gjë nuk qëndron, e për veten e saj nuk ka qenë e njëjta gjë. Erioni kërkon të dijë më tepër e Gerta thotë se i është dukur shumë çudi në momentin që ka hyrë në shtëpinë e BB, e mendimi që kishte krijuar që jashtë për ta, ka ndryshuar rrënjësisht. Françeska e pyet se çfarë mendimi ka pasur Gerta për të e ajo përgjigjet se ajo i është dukur pasive e koketë nga jashtë, gjë që Françeska e pranon, por Gerta shton se tani nuk i duket më ashtu. Për Eriomin thotë se pothuajse nuk dukej fare në ekran e ishte shumë i qetë, ndërsa për Gertën ka pasur simpati nga jashtëm, gjë që nuk ka vazhduar brenda shtëpisë së BB. Françeska thotë se në përgjithësi femrat janë në rolin e koketës, duke përjashtuar Klaujdin, e Gerta thotë se këtë të fundit nuk e duronte dot pasi e acaronte. Gerta thotë për Gertën se di të luajë, por duhet të ketë karakter më të fortë, e këtë javë ka ndryshuar



# FRANÇESKA & GERTA

## "Mike dhe rivale"

Dy banorët tregojnë për jetën e tyre jashtë BB

shumë prej nominimit. Françeska e mbështet këtë mendim e thotë se Genta është bërë 'grricëse', pasi gjithçka e merr për keq. Më pas, Gerta tregon për familjen e saj që jeton në Elbasan dhe për dhuratën që i kanë bërë për 20 vjetor, një makinë, ndërsa motra sapa është martuar e ka mundësi që të dyja të ikin në Amerikë, pasi bashkëshorti i motrës jeton atje. Dy vajzat tregojnë që nuk mbajnë shoqe afër, nga frika se zhgënjehen e preferojnë të rrinë me motrat e tyre e së fundi, Gerta tregon për ish të dashurin e tij, i cili ka qenë xheloz e tani nuk kanë më asnjë lidhje, pasi ajo është e prerë në vendimet që merr.

### GERTA - FRANÇESKËS: "TI JE MË TIP SE ERMALI"

Franseska qëndrojnë së bashku për disa orë, ku së pari kanë ndenjur duke biseduar në oborr e duke ndarë eksperiencat e jetës me njëra-tjetrën, e

më pas kalojnë në kuzhinë, ku gatuanjë drekën. Françeska tregon se i ka bërë çudi një rast që i ka thënë Gentës të mos përsërisë fjalët e të tjerëve, e ajo i është përgjigjur: "Nuk përsëris fjalët e Liamit", ndërkohë që ajo nuk e kishte përmendur fare Liamin. Gerta thotë se Liam e Ermali janë të dy nervozë, ndërsa Françeska shton se paçka se ata kanë debatuar në BB, mendon se jashtë do të jenë miq shumë të mirë. Françeska thotë se kohët e fundit nuk e shikon Arbrin në finale e shton se vendin e tij mund ta zëre Gerta në finale. Gerta përgjigjet se kjo gjë sigurisht që i pëlqen, por nuk është e sigurt. Françeska thotë se do të ishte mirë që në finale të shkonin dy femra (ato të dyja), e Gerta thotë se më shumë shikon Françeskën në finale sesa Ermalin, pasi ajo është më aktive. Françeska përgjigjet se ata të dy janë tipa të kundërt, por dhe Er-


mali ka pjesën e tij që di të debatojë dhe është i shkolluar, ndërsa ajo është vajza e debateve. Gerta thotë se shkollimi nuk ka të bëjë pasi ata nuk kanë ardhur të bëjnë politikë, e Gerta thotë se Françeska i duket më tip se Ermali. Françeska përgjigjet se nuk mund të pohojë se është e njëjta gjë si të shkojë ajo, si të shkojë Ermali në finale, pasi kjo nuk do të ishte shprehje dashurie. Gerta pyet Françeskën nëse do të hiqte dorë nga loja për Ermalin e ajo mohon. Françeska thotë se në përgjithësi është shumë dyshuese e mendon se jashtë lidhja e saj me Ermalin do të jetë më bukur, por nuk mund të thotë se jep jetën për të.

### FRANÇESKA DHE GERTA LAGIN ARBRËRIN

Franseska i propozon Gertën të lagin Arbrin, teksa ai është në gjumë. Ajo thotë se Arbri e ka zgjuar disa herë atë, kështu që nuk është problem e Gerta pranon. Liam i thotë vajzave të kenë kujdes të mos lagin krevatin e tij e gjithashtu i këshillon të largojnë mikrofonin e Arbrit që të mos e lagin. Françeska e Gerta shkojnë në dhomë pa u ndërjerë, që të mos e zgjojnë Arbrin, e i hedhin sipër një enë me ujë të ftohtë teksa ai është në gjumë. Arbrit i del gjumi menjëherë e ngrihet nga krevati, teksa vajzat shpërthejnë në të qeshura. Arbri paralajmëron vajzat të kenë kujdes tani e tutje e për me tepër Françeska që ngrihet gjithnjë e fundit. Gerta thotë se Graciano i ka përkrahur në këtë mision, por ai mohon. Tani i thotë Liamit: "Po Gerta ç'pati?" e Graciano thotë se ajo ishte organizatorja. Liam thotë se Arbri është nxehur nga veprimi i vajzave, e Gerta thotë se Françeska i ka hedhur një enë të tërë me ujë. Arbri së fundi afrohet pranë vajzave e u thotë se nuk e ka problem se e kanë lagur, mjafton që uji të ketë qenë i pastër. Ai shton se i vjen mirë që Françeska ia hapi rrugën për t'i bërë dhe ai të tilla shaka. Banorët mbledhen së bashku duke kujtuar ditët e qëndrimit në shtëpinë e BB dhe situata më gazmore e pikante që kanë ngjarë aty. Ndërkohë, Arbri mendohet që t'i kthejë hakun Gertës që e ka lagur, dhe teksa qëndrojnë të ulur në oborr, e lag Gertën dhe Gertën.

### Ermali - Dritanit:

## Je i lodhur për moshën që ke



Banorët janë mbledhur në Boborr e bisedojnë, ku Tani po i tregon për profesionin e tij si volejbollist e në përgjithësi për pagesën që ata marrin. Graciano i thotë Tanit: "Ti je shumë i lodhur për moshën që ke" e Ermali ndërhyn e thotë të njëjtën shprehje që Graciano ka thënë për Tani, me arsyetimin se po të kishte pasion, do ta ndiqte më me vendosmëri këtë rrugë. Liam mbron Tani e ky i fundit shprehet se ka shumë vështirësi në rrugën e sportit. Më pas, Françeska distancohet me Gertës e bisedojnë së bashku për netët e spektaklit, për pëlqimin e publikut ndaj tyre e së po ashtu për nominimet. Françeska thotë se ka dy muaj e gjysmë qëndrimi në shtëpi e Graciano shton se janë në javën e tretë të muajit të tretë e kujtojnë surprizat që kanë marrë gjatë qëndrimit në BB. Françeska i thotë Gracianos se si do të jenë kripet me të nominuarit këtë javë, pasi në nominim janë vetëm Graciano e Genta e ata do të thonë përse duhet të qëndrojnë njëri apo tjetri. Ermali thotë me shaka se Genta duhet të largohet pasi nuk u ka bërë më bukë, ndërsa Graciano thotë: "Duhet të largohet që të rregullojë marrdhënien me Rubensin".

### "The Toaster"

# Sjellin muzikën Ska-Jazz në kryeqytet

## TIRANE


Ndonëse e filluan me vonesë koncertin e tyre, ata nuk i zhgënjën adhuruesit e muzikës Ska-Jazz. Një nga grupet e njohura amerikane, "The Toaster", performoi për publikun kryeqytetas, një pjesë të mirë të repertorit të tyre. "The Toasters", i cili ka mëse 30 vjet që luan në skena të ndryshme botërore, ishte i pranishëm edhe në Tiranë, falë Tirana Ekspres. Grupi i cili është duke zhvilluar një tur të rëndësishëm nëpër të gjithë Europën, u ndal edhe për një koncert në Tiranë. Përrth një orë, banda e "The Toasters", solli për



publikun kryeqytetas një mori këngësh të reja, por edhe hite të suksesshme të tyre në vite. "Don't Let The Bastards Grind You Down", "I'm Running Right Through The World", "Today's A Good Day", etj, ishin disa nga hitet, që grupi solli në vëmendje të adhuruesve të




muzikës Ska-Jazz. Kjo rrymë muzikore është zhvilluar në vitet '80, me bazë muzikën Ska-Jazz, ndërkohë që shton edhe elementin rock/punk, duke ruajtur rëndësinë e saksafonit dhe trumpetave. "The Toasters", është një nga grupet e para amerikane në valën e tretë të



Ska-Jazz, dhe është aktualisht një nga grupet më jetëgjata të kësaj rryme. Ata kanë nxjerr në treg nënte albume muzikore si, "Thrill me up", "Dub 56", "Enemy of the best", ndërsa albumi tyre i fundit muzikor titullohet "One more Bullet". Ai është lanuar në vitin 2007,

dhe erdhi si rezultat i përvjetorit të tyre të 25-të. Në vitin 1990 "The Toasters", përjetuan një shkallë të vogël të suksesit komercial, për shkak të popullaritetit që rryma Ska-Jazz, arriti të kishte në Amerikën e Veriut. Ndalesa e ardhshme e grupit amerikan, do të jetë vendi fqinjë Greqia, ku ata do të performojnë hitet e tyre. Tirana Ekspres organizon evente gjithmonë me grupe dhe këngëtar të njohur. Organizatorët shprehen se, preferojnë të sjellin ato grupe dhe këngëtarë, që janë më afër shijëve muzikore të publikut. Ata pretendojnë gjithashtu se shumë shpejt, do të sjellin në Tiranë, edhe këngëtarin britanik Atilla.



ZBAVITJE

[SHQIPTARJA.com] nditëse

Zjarr shtëpisë nga zjarri i dashurisë

Zjarr i dashurisë nganjëherë të shtyn të bësh edhe të pabërën. Por rasti i një fotoreporteri austriak është vërtet i rrallë pasi u dënua nga gjykata meqë i kishte vënë zjarrin disa herë shtëpisë së vet. Në fakt ai vinte zjarrin djakje dhe pastaj, menjëherë lajmeronte zjarfikësit për ta shuar. Shkurrt pra, ai, siç u detyrua ta pranonte edhe me gojë në një gjyq, zjarrin e shkakonte vetëm për pretekst, sepse vetëm kështu mund të shihte edhe një herë sytë e asaj që ia kishte marrë mendjen. Në fakt, fotoreporteri kishte parë një ditë, kur në shtëpinë e një fqinji të tij kishte rënë vërtet zjarri, të vinte një eksperte e piroteknikës që ishte shumë e bukur e që nga ai cast, kishte rënë në dashuri me të. Dhe me shpresë se ajo do të vinte sa herë që binte zjarri, për të verifikuar shkaqet, ai nuk hezitonte t'i vinte flakën ndonjë pjesë të shtëpisë. Ky ishte edhe shkak që nga gjykata u mor si një rrethanë lehtësuese, për ta dënuar me kusht, por vetëm me një kusht tjetër. Që ai t'i nënshtrohej edhe një terapie në psikiatri.



Një alarm i... regjistruar

Disa vjet më pare, gjatë një fluturimi ajror nga San Francisco për në Londër, pasagjerët e një aeroplani të British Airways kaluan disa minuta vërtet të tmerrshme, kur nga altoparalanti u njoftua se aeroplani po rrezohet në oqean. Menjëherë pas këtij njoftimi aeroplani u përfshi nga kaosi. Nga të gjitha anët dëgjohehin këllthma dhe ulërima dhe ishte e pamundur të qetësoheshin, pasi secili mendohej të gjente një mënyrë për të shpëtuar nga "katastrofa" dhe askush nuk u zinte besë fjaleve dhe lutjeve të personelit që të qetësoheshin, sepse asgjë nuk ishte e vërtetë. Vetëm pas disa minutave paniku, atëherë kur u bindën vërtet se aeroplani nuk kishte asnjë problem u mësua edhe e vërteta e atij alarmi të rremë. Dikush nga pasagjerët, duke dashur të bënte shaka, kishte ndezur magnetofonin që ka të regjistruara të gjitha mesazhet që përdoren gjatë udhëtimit, përfshi edhe ato të rasteve të avarisë, duke terrorizuar të gjithë udhëtarët.



Porno-shop që kthen besimtarët

Që kur dikush hapi një dyqan porno-shop në një nga rrugët e Kennedale, të Texas-it, prifti i kishës përballë humbi qetësinë. Jo thjesht për faktin se dyqani ishte pranë kishës së tij, por edhe se i vinte inat që shumë nga besimtarët, kalonin më tepër kohë në dyqanin "me drita të kuqe" se sa në shtëpinë e Zotit. Por pikërisht dyqani në fjalë u bë shkak që prifti t'i mbyshje sërisht kisha me besimtarë. Kështu, një ditë të bukur prifti vendosi të fotografonte të gjitha makinat që parkonin përpara dyqanit në fjalë dhe më pas, nëpërmjet targave arrinte të të zotët, të cilëve u dërgonte një letër, (bashkë me fotografitë) ku i këshillonte që të mos harronin edhe shtëpinë e Zotit. Ide vërtet gjeniale e priftit, pasi që nga ajo kohë kisha e tij gëlon nga besimtarët...



HOROSKOPI

- Dashi: Parashikohet një ditë disi e vështirë dhe pengesat sot do të jenë nga më të ndryshmet për ju, prandaj duhet të reagoni me shumë vendosmëri. Edhe erosi nuk është në nivelin e kërkuar.
Demi: Pas një momenti jo edhe aq të mirë është Merkuri në shenjë ai që nuk do t'ju "lerë vetëm", duke ju sjellë energji të reja. Nga ana tjetër Afërdita duket se ju mbysh me shumë pasione.
Binjakët: Duhet të tregoni kujdes, sepse me gjithë Merkuri është plotësisht në anën tuaj, është Marsi në shenjë ai që mund t'ju komprometojë disi fundjavës. Kujdes edhe raportet në planin sentimental.
Gaforja: Sot ylli juaj i mirë ka të ngjarë që të jetë Hëna, e cila së bashku me Afërditën dhe Marsin është në një orbitë shumë favorizuese gjatë fundjavës. Kujdes, sepse ndjenja e protagonizmit ju dëmtton.
Luani: Të lindurit e kësaj shenje sot duhet të tregohen të matur, pasi Urani dhe Saturni në kontrast me njëri-tjetrin mund t'ju bëjnë konfliktuale. Një raport i tendosur duhet përmirësuar me çdo kusht.
Virgjëresha: Duket se është një periudhë me shumë impenjime për ju, por, duke pasur edhe mbështetjen e Marsit, mundohuni të organizoheni më mirë, për të kaluar një fundjavë për ta mbajtur mend.
Peshorja: Zakonisht mënyra më e efikase për të çlenuar situata është ironia, një armë e mirë e juaja, por me të cilën duhet të tregoheni të matur e të mos e taproni. Fundjavë interesante në planin sentimental.
Akrepi: Pozicioni i ni i Merkurit në shenjë duket se e zbut ndjeshëm karakterin tuaj, prandaj pritët të jeni më të shtuar në debate, më të gatshëm ai i Sifitit. Fundjavë intensive e gjithnjë në lëvizje.
Shigjetari: Kalimii i Hënës në shenjë sot e në pjesën më të madhe të ditëve në vijim pritët të ketë me shumë aspekte pozitive për ju, sidomos gjatë fundjavës. Moment për t'u shfrytëzuar në planin afektiv.
Bricjapi: Duket se pozicioni i yjeve në orbitë do të jetë i harmonishëm, gjë që është e rëndësishme sidomos në planin sentimental e aq më shumë gjatë kësaj fundjavë. Mirë shëndeti.
Ujori: Të lindurit e kësaj shenje sot duhet të tregojnë kujdes, pasi kontrasti e Hënës, Marsit e Merkurit do të bëjë që të jeni shumë të ndjeshëm e të reagoni të acanuar. Fundjava pritët të jetë e qetë.
Peshqit: Kuadri yjor sot duket disi i errët nga hyrja në shenjë e Marsit dhe Uranit, por mund të jetë vetëm dikja e përkohshme. Një udhëtim i shkurtër në fundjavë do t'ju bënë vërtet shumë mirë.

SUPER FJALEKRYQ

Grid for the crossword puzzle with numbers 1-97.

HORIZONTAL

- 1. Eshhtë sallë force.
2. Eshhtë aftësi kondensatori.
10. Një grykësi Rabelais.
17. Një gjakësi në klasa.
22. Një anakoolik bjond.
23. Mbyllin një simbol.
25. Sapo fillojnë.
26. Gjysmë tatimi.
27. Mbeten në fund.
28. Jeton në kufij.
29. Sampras tenist.
30. Janë edhe ato të sigurimit.
33. Një sigël shahistësh.
35. Para de Janeiro-s.
36. Janë fatalistë.
41. Mund të jenë dielë.
42. Zanore tirane.
44. Eshhtë dokument me trashëgimtarë.
45. Janë katalizatorë të organizmit.
48. Në krye të komandës.
49. Mund të rrezohet me alibi.
50. Janë grupet e deputetëve.
52. Ndryshon çdo ditë.
54. Louis Armstrong.
55. Një gur i çmuar.
56. Ian që krijoi James Bond.
59. Tersi por jo ti.
62. Agjenci Civile Kombëtare.
64. Eshhtë balet me muzikë ritmike.
65. Turner këngëtare.
68. Gjysmë urbane.

- 69. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
71. Eshhtë godinë sporti.
73. Janë në modë.
74. Fillojnë jetën.
76. Janë si bomba.
79. Piaf që këndon Milord.
80. Mund të jenë shifjeje.
81. Diftong kuadri.
82. Këndohet në opera.
84. Lubonja aktore.
85. Ente Ekonomike Tiranë.
86. Sofia Ricci aktore.
87. Ente Autonome Ndërtimi.
89. Eshhtë edhe ai i luftës.
91. Krijuesi i Maigret.
93. Gjysmë jetime.

- 95. Eshhtë duke kundruar.
96. Inicialet e Daudet.
97. Përcaktohet ai i udhëtimit.

VERTIKAL

- 2. Kush është... nuk është i gjallë e aktiv.
3. Fillojnë lajmet.
4. Një mund të jetë autonom.
5. Një yll hollywoodian.
6. Eshhtë taksa.
7. Inicialet e Gere aktor.
8. Gjysma e arenës.
9. Janë pemë në... grykë.
10. Një tufë bagëtiësh.

- 11. Bëhen për zakon të tilla.
12. Me stop në box.
13. Gjysma aneksi.
14. Shkurrt për company.
15. Eshhtë ëmbshtëre e ditëlindjes.
16. George shkrintare.
18. Një film i Emir Kusturica-s.
19. Një filiz.
21. Kanë element për të kapur.
22. Laetitia modele dhe aktore.
24. Emri i Bismarck.
25. Në krye të sllaës.
30. Mbyllët me epilog.
31. Fillojnë profesionin.
32. Skuadër greke.
34. Piktur i njohur zviceran.

- 37. Ishulli i Björk.
38. Janë njerëzit e... shtëpisë.
39. Thuren me prapaska.
40. Një sigël maunesh.
41. I famshëm ai i Sifitit.
43. Tezat pa kufij.
44. Iglit të Lazio.
46. Bëhet duke ngritur një... pallat.
47. Janë lule.
49. Një fjalë e përshtatshme.
50. Eshhtë akuzuesi.
51. Fillojnë efektet.
53. Eshhtë vëshkje, zbehje.
55. Janë vitet.
57. Njohu Androkliun në arenë.
58. Graham i Njeriu ynë në Havanë.
60. Një mund të jetë fetar.
61. Eshhtë matës... uji.
63. Emri i Goldoni-t.
64. I pushtojnë alpinistët.
66. Numër i shkurtër.
67. Agjenci Ajrore Milaneze.
70. Eshhtë poezia.
72. Lagen pa zë.
75. Emri i Ramazzotti-t.
77. Pak nostalgjike.
78. Në këtë moment.
83. Pak iniciative.
88. Qendër në kaos.
89. Inicialet e Truffaut.
90. Inicialet e Adjani.
92. Ndezur në aparaturë.
94. Mbyllin një tender.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHEM

Grid for the previous day's crossword puzzle with letters filled in.

**LAJME  
NGA BOTA**

■ **Shkup, lironen 13 veta, bien akuzat për "islamikët"**  
Deri pasditë ka mbërritur në 13 numri i personave që janë liruar pas skadimit të afatit 48 orësh të paraburgimit për rastin e vrasjes së pesëfishtë në Smilkovac të Shkupit. Avokati mbrojtës Naser Raufi deklaroi se tashmë kanë mbetur në paraburgim vetëm 3 të akuzuarit e drejtpërdrejt për vrasjen e pesëfishtë si dhe 4 persona të tjerë që dyshohen për vepra bashkëveprimi, ndihmë dhe posedim armësh pa leje. Në mëngjes u liruan 3 veta pas skadimit të paraburgimit 48 orësh dhe 60 veçarja Feride Bilalli që dje u lirua, për shkak të problemeve shëndetësore.

■ **Alarmi i KE: Po rritet racizmi**  
Krizja ekonomike dhe shtimi i fjalimeve ksenofobike në media e publik, po kërcënon seriozisht Europën, e në veçanti, Bashkimin Europian. Kështu vlerëson instituti ngritur nga Komisioni Europian kundër racizmit dhe intolancës, ECRI në raportin vjetor të publikuar së fundmi. "Në Europë po rritet racizmi dhe fryma e intolancës ndaj të huajve, ndihmuar sa nga kriza ekonomike, ashtu dhe nga fjalimet e shtuara ksenofobike të personave publikë, e në veçanti të politikanëve."

■ **Al-Kaeda ndryshon taktikë: SHBA-së i vëmë flakën**  
Al-Kaeda i kërkoi ndjekësve të saj që t'i vendosin flakën pyjeve amerikane gjatë verës, si një metodë e re efikase terrori. Publikimi u bë në revistën e famëkeqe të terroristëve, "Frymëzimi", e cila shpërndonte artikullin e saj edhe me udhëzime vizuale për mënyrën se si mund të krijohet "bomba zjarri" e se si mund të përhapen vatrat e tij në një pyll. "Është e drejta juaj të ndizni një bombë zjarri", shkruhej në revistë në të cilën inkurajohej çdo terrorist që të zgjidhte këtë mënyrë të re terrori gjatë verës, në vendet joislamike ku jetojnë. Përsa i përket SHBA, artikulli kishte një dedikim të veçantë dhe përshkruante se vendi i mirë për të kryer një sulm të tillë është Montana, për shkak të hapësirës së gjerë që e rrethon dhe popullsisë në rritje të vazhdueshme.

■ **SHBA zbulon letrat e Bin Laden**  
Një përzgjedhje dokumentesh të sekuestruar gjatë sulmit të një njësie elite e marinës në banesën e Bin Ladenit në Pakistan, një vit më parë, u bënë publike ditën e enjte nga Ushtria Amerikane. Dokumentet u postuan në faqen e internetit të Akademisë Ushtrake të Luftës kundër terrorizmit. Midis fletëve gjenden prova të qarta të shqetësimit të liderit të Al-Kaedës në lidhje me faktin se shumë drejtues të organizatës ishin vrarë ose ishin të pasigurt në vendndodhjen e tyre. 175 faqe dokumente janë lëshuar në internet, pasi u gjetën në kompleksin në Abotabad, ku Bin Ladeni u vra pas operacionit të ndihmuar nga CIA (Agjencia Qendrore e Inteligjencës). Midis dokumenteve të papublikuara besohet se janë edhe dhjetëra komunikime të themeluesit të al-Kaedës me bashkëpunëtorët e tij dhe një ditar i shkruar me dorë.

■ **Debat i ashpër televiziv Sarkozy - Hollande**  
Kandidatët për president francez, Nicolas Sarkozy dhe kundërkandidati i tij, François Hollande, kanë këmbëyer akuzat të ashpër gjatë debatit të mbremëshëm televiziv, me ç'rast Sarkozy akuzonte Hollanden për gënjeshtra dhe shpifje. Debatit ishte transmetuar drejtpërdrejt në disa stacione televizive dhe arriti një shikueshmëri rekorde. Hollande pretendoi se nëse fiton në rundin e dytë do të jetë "president i drejtësisë". "Ne po kalojmë nëpër një krizë serioze", tha Hollande, duke premtuar krijimin e një politike, e cila bazohet në të drejtën fiskale dhe sociale. Hollande akuzoi Sarkozy për ndarjen e popullit francez, duke thënë se kriza ekonomike e përdor si arsye për të premtimet e papërbushura.

**VALË UHF**  
**NË PREFEKTURAT:**  
**TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER**



**DIGITALB**  
**KANALI 50**  
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

**Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:**

NE SHQIPERI		Berat		Kukesi		Reçi KGM		Lezhe	
Televizioni MRM	Oryteti Korçë	Fier	Elbasan	Oresh	Fier	S3	Tirane	Kraje	Lac
Intel Media	Fier	Pogradec	Lushnje	Maçelara	Diber	Ju-al	Manastiri	Fier	Elbasan
Intusai	Pogradec	Devoll	Prrerinas	Multivizion	Kavaje	Manastiri	Bashk	Elbasan	Fier
TVM Devoll	Devoll	Vlore	Tirane	Tata Junior	B.Curri	Manastiri	ARD&NET	Fier	
Vjosa	Devoll	Toshmaz	Elbasan	Dijvika	Lushnje	Manastiri			
Toshmaz	Devoll	Bradat	Elbasan	M&G	Elbasan	Manastiri			
Bradat	Devoll	Erzeni	Elbasan	Cafran	Berat	Manastiri			
Erzeni	Devoll	Luna	Elbasan	Kucova	Berat	Manastiri			
Luna	Devoll	Marihuho	Elbasan	Lapardhaja	Berat	Manastiri			
Marihuho	Devoll	Permeti	Elbasan	Brado	Berat	Manastiri			
Permeti	Devoll		Vlore	Onkumi	Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan	Asparag	Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore	Matë	Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll		Vlore		Berat	Manastiri			
	Devoll		Elbasan		Berat	Manastiri			
	Devoll								